

S'ka më
përgjime
ilegale



Bashkë për
Gazi Babën



Edhe
Mijalkovi pa
pasaportë



Nuk dëm-
tohen
qytetarët



Koha

www.koha.mk



Të ndryshojmë
për të
ndryshuar
fatin

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3184 • E premte 29 shtator 2017 15 DEN



As rajonin s'e konkurrojmë dot!


Shkup, 28 shtator - Maqedonia posedon shumë pak brende që janë të njohura jashtë kufijve të saj si në shtetet fqinje, ashtu edhe në tregun evropian. Ekonomistët thonë se brishtësia e ekonomisë vendore, rritja e dobët ekonomike, si dhe tregu i vogël i varur nga eksporti

ndikojnë në faktin që Maqedonia në më shumë se 20 vite pavarësi - krijoi vetëm disa dhjetarë brende që megjithatë me shumë vështirësi depërtojnë në tregjet e huaja. Vlerësohet se menaxherët në vend, kryesisht mendojnë dhe funksionojnë në suaza lokale dhe jo globale

dhe kënaqen me fitimin që e realizojnë në tregun vendor. Ekspertët e marketingut thonë se shkaqet kryesore pse brendet nga Maqedonia nuk njihen nga konsumatorët në rajon janë mungesa e investimit në promovimin e prodhimeve jashtë, mos-pozicionimi... **Faqe 4**

Kërkesë e botuesve dhe autorëve shqiptarë

MASH-i të lejojë dorëshkrimet në shqip



"Të konkurrosh me dorëshkrime në gjuhën maqedonase dhe pastaj t'i përkthesh të njëjtat në gjuhën shqip nuk është problem i vogël. Përveç se ka koston financiare, libri humb në cilësi si në aspektin metodologjik ashtu edhe përmbajtjesor, mbase humbën edhe më shumë", deklaron Driton Ajrullai nga SHB "Albas". Kjo, plotëson më tej ai, "i eliminon botuesit shqiptarë nga konkurrimi, pasi i ve në pozita të pabarabarta me botuesit maqedonas". Prandaj ai kërkon që dorëshkrimet të mund të jenë edhe në gjuhën shqipe. Këtë kërkesë ka edhe Shoqata e Pedagogëve të Muzikës **FAQE 3**

NË FOKUS

Pesë anarkitë sipas Fan Nolit



Noli është nga ato figura komplekse që rrallë mund t'i kuptosh drejtë, pasi gjithmonë ka diçka të fshehur brenda çdo fjale. Në gjithë fjalimet që Noli ka mbajtur, është vlerësuar shumë realiteti që ai shpreh dhe mënyra e mendimit dhe perceptimit të tij. Ndaj edhe sot do të flasim... **FAQE 8**

GLOBI

Miqësia me Izraelin mund t'u shkaktojë zi kurdëve **FAQE 15**

RAJON

Demarkacioni si "bumerang" për Qeverinë Haradinaj **FAQE 14**

SPECIALE

Suedia kërkon luftë me Putinin



FAQE 17

Më 17 tetor gjykimi, asnjë fjalë për hetimin ndërkombëtar



Shkup, 28 shtator - Seancat gjyqësore kundër 37 të akuzuarve shqiptarë për ngjarjet e Kumanovës të vitit 2015, zyrtarisht kanë përfunduar të enjten. Me vendim të Trupit gjyqësor të drejtuar nga gjykatësja Verka Petrovska, aktgjykimi për veprat "terrorizëm" dhe "organizatë terroriste", pritet të shpallet me

17 tetor. Caktimin e kësaj date, gjykatësja Petrovska e arsyetoi me numrin e madh të të akuzuarve, prezantimin e dëshmive dhe provave të ndryshme nga palët në proces, si dhe kjo datë është marrë parasysh nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila gjatë periudhës që vjen - do të ketë angazhime shtesë. Duke

e komentuar rrjedhën e procesit gjyqësor, avokati Naser Raufi tha se pala mbrojtëse në përgjithësi është pesimiste dhe nuk presim ndonjë aktgjykim korrekt dhe të drejtë. Këtë qëndrim, ai e mbështet në mënyrën se si është zhvilluar procesi gjyqësor për këtë rast, me çka Trupi gjyqësor nuk i ka marrë parasysh... **FAQE 5**



"Aftësitë teknike për përgjimin e komunikimeve do të jenë nën kontroll të fuqishëm të pavarur, duke përfshirë edhe kontroll gjyqësor", ka theksuar ministri Mançevski

Në Gazi Babë, shqiptarët me listë të përbashkët për këshilltarë

Shkup, 28 shtator - Shefi i Shtabit të Bashkimit Demokratik për Integrim në Gazi Babë, Ali Sadiku të enjten në një konferencë shtypi në selinë e partisë në Shkup, njoftoi se BDI në këto zgjedhje në Komunën e Gazi Babës garon me listë të përbashkët me partitë e tjera shqiptare për këshilltarë në këtë komunë. "Iniciativa për Lista të përbashkëta është e kamotshme

dhe e iniciuar asokohe nga kryetari i partisë Ali Ahmeti në vitin 2009 nëpër komuna ku qytetarët shqiptarë nuk janë shumice, si për shembull në Ohër, Manastir, Prespë, Veles dhe të tjera.

Kjo tentativë u përsërit edhe njëherë nga ana e kryetarit Ahmeti në vitin 2013 dhe pati sukses sporadik në ato zgjedhje, por përçarja e votës shqiptare në ato zgjed-

hje ndikoi në defaktorizimin e shqiptarëve. Fara e mbjellë në vitin 2009, doli në sipërfaqe dhe mbiu më vitin 2017, me ç'rast shqiptarët u bashkuan duke u afruar dhe përpiluar një listë të përbashkët, duke u bërë vendimtar, duke mos lejuar defaktorizimin e shqiptarëve, duke maksimizuar dhe përqendruar votën vetëm në një listë të përbashkët në komunën e Gazi Babës si dhe në

disa komuna të tjera, si Manastir dhe Ohër", tha Sadiku. Kjo fryme e bashkimit, shtoi, rrjedh edhe nga Deklarata e Përbashkët e partive shqiptare. "Unë ftoj shqiptarët në komunën e Gazi Babës që masivisht të rrethojnë numrin 5 për t'i bërë shqiptarët më të fortë, më të rëndësishëm dhe më dobiprurës për të mirën tonë të përbashkët", tha Sadiku në pres konferencë.

Mançevski paralajmëron mekanizma të fuqishme mbrojtëse

S'ka më përgjime ilegale

Shkup, 28 shtator - Qeveria do të vendosë mekanizma të fuqishëm mbrojtës që të pengohet përgjimi ilegal, ka porositur ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratë, Damjan Mançevski sot në promovimin e studimit "Drejt panoptikonit qytetar Barazi më të mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës për ndjekje të komunikimeve". Ministri Mançevski, qëndron në MSHIA, u përqendrua në problemin me përgjimin masiv të realizuar nga pushteti paraprak dhe angazhimeve të Qeverisë së re, asnjëherë më të mos përsëritet prishja e privatësisë së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. "Qeveria është e vetëdijshme për rëndësinë e madhe të normimit adekuat të çështjeve të lidhura me ndjekjen e komunikimeve. Në fakt nuk ka më se kush të jetë, duke pasur parasysh atë që ne ishim edhe



qëllimi kryesor i përgjimit. Edhe për këtë arsye, për mua paraqet kënaqësi e posaçme që edhe organizatat civile investojnë përp-

jekje të rëndësishme për tejkalim të sfidave dhe çështjeve të hapura të lidhura me ndjekjen e komunikimeve", ka

theksuar ministri Mançevski. Qeveria e re, ka shtuar, ka interes të posaçëm për zgjidhje adekuate të kësaj çështjeje. Këtë e demonstruam me faktin se në katër prioritetet të ndryshme nga Planit 3-6-9 - kuvend, reforma gjyqësore, reformë të shërbimeve zbuluese dhe të sigurisë dhe luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit janë përfshirë masa të cilët e adresojnë ndjekjen e komunikimeve, ka theksuar ministri. Duke i transmetuar angazhimet për vendosje të mekanizmave të fuqishëm mbrojtës të cilët do të pengojnë përgjim ilegal Mançevski ka paralajmëruar se masat në këtë drejtim do të implementohen si prioritet urgjent. "Aftësitë teknike për përgjimin e komunikimeve do të jenë nën kontroll të fuqishëm të pavarur, duke përfshirë edhe kontroll gjyqësor", ka theksuar ministri Mançevski.

Berlini zyrtar të ndihmojë në kontestin me Greqinë



Shkup, 28 shtator - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti ka realizuar të enjten në Tetovë takim me ambasadorin e ri gjerman në Maqedoni, Tomas Gerberih. Ambasadori gjerman, siç citohet në njoftim, shprehu mbështetjen e fuqishme gjermane për proceset reformuese në Maqedoni si dhe integrimin Euroatlantik të vendit. Ahmeti i uroi punë të mbarë ambasadorit Gerberih dhe theksoi që bashkëpunimi i ngushtë me autoritetet gjermane do të vijojë edhe në të ardhmen. Ahmeti e informoi ambasadorin Gerberih që fushata zgjedhore po zhvillo-

het qetë dhe që BDI do të angazhohet për proces të lirë zgjedhor dhe të pranueshëm për të gjithë. Sa i përket reformave, BDI mbetet tërësisht e përkushtuar që të vijojë procesin reformues me po të njëjtin vrull pas përfundimit të zgjedhjeve. Ahmeti foli për rolin e rëndësishëm të Gjermanisë në proceset integruese euroatlantike dhe ftoi Berlinin që ta intensifikojë ndihmën në drejtim të zgjidhjes së çështjes së emrit. Bashkëbiseduesit këmbëmbësues mendime edhe për ligjin për përdorimin e gjuhëve, fqinjësinë e mirë si dhe bashkëpunimin ekonomik.

Padi për personin që qëlloi tre persona në Kërçovë

Shkup, 28 shtator - Stacioni policor Kërçovë parashtriu padi penale kundër Abdul Abdulit (58) nga fshati Drogomisht i Epërm, Kërçovë, për shkak të ekzistimit të bazave të dyshimit për vepra të kryera penale "vrasje" dhe "përpunim i paautorizuar, mbajtje dhe tregtim me armë dhe materiale shpërthyes". Ai dje në Kërçovë, me pistoletë "Sig Sauer" të kalibrit nëntë milimetra ka shtënë ndaj personit Alit Abazi (40) nga fshati Sërban, Kërçovë, Destan Abdiu (58) nga Kërçova i cili është shef i shtabit zgjedhor të listës së këshilltarëve nga nisma qytetare dhe Shaban Dalipi (54) nga fshati Greshnicë, Kërçovë i cili ka qenë kalimtar i rastit. Ata me lëndime janë dërguar në Spitalin e përgjithshëm në Kërçovë, pas çka Alit Abazi dhe Destan Abdiu, për shkak të seriozitetit të lëndimeve janë dërguar në Qendrën urgjente në Shkup. I lënduari Shaban Dalipi pas ndihmës së ofruar në spitalin në Kërçovë, ishte lëshuar për mjekim shtëpiak. Prokurori publik dhe ekipi i Stacionit policor Kërçovë kryen ekspertizë në vendin e ngjarjes ku janë gjetur gëzhoja dhe mjete të tjera, të cilat janë marrë dhe dërguar për ekspertizë në MPB. Sipas njohurive të deritanishme, motivet nuk kanë qenë politike edhe pse i lënduari Alit Abazi është bartës i listës për këshilltarë nga nisma qytetare për këshillin e komunës së Kërçovës, por bëhet fjalë për keqkuptime të ndërsjellta për të cilat është zhvilluar procedurë gjyqësore.

Të rinjtë e 25 partive nënshkruan Deklaratë për zgjedhje të lira

Shkup, 28 shtator - Të rinjtë e 25 partive politike të enjten në Shkup në prag të mbajtjes së zgjedhjeve lokale nënshkruan Deklaratë për zgjedhje të lira dhe korrekte. Me Deklaratën ata u angazhuan për zbatimin e zgjedhjeve të lira dhe korrekte, organizim të fushatës dinjitoze dhe për uljen e urrejtjes në rrjetet sociale dhe në jetën e përditshme. Përfaqësuesit e të rinjve të partive politike shprehën kënaqësi që po rritet numri i të rinjve të cilët e nënshkruajnë Deklaratën dhe u

angazhuan se do t'u përmbahen parimeve të dokumentit. Të rinjtë nga partitë më të mëdha politike paralajmëruan betejë korrekte me respektimin e të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Nga të rinjtë socialdemokratë të Maqedonisë paralajmëruan se do të manifestojnë marrëdhënie korrekte dhe të drejtë ndaj të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, ndërsa nga Unioni i të rinjve të VMRO - DPMNE - së shfaqën shpresë se zgjedhjet e ardhshme do të jenë betejë me zgjidhje dhe

propozime për problemet e të rinjve, ndërsa jo betejë me thyerjen e shtabeve dhe shkatërrimin me material reklamues. Ky është nënshkrimi i parë i Deklaratës me rastin e zgjedhjeve lokale paraprakisht të rinjtë e partive politike dy herë nënshkruan deklarata para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2014 dhe 2016. Nënshkrimi i djeshëm i Deklaratës është në organizim të Institutit për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare - Ohër.





Ibrahimi: 12 vjet gënjeshtër për Çairit

Shkup, 28 shtator - Kandidati i Lëvizjes BESA për Komunën e Çairit, Zeqirija Ibrahim, ka vazhduar edhe të enjten me shpalljen, siç ka thënë ai, dëshimet e BDI-së në këtë komunë. "Ashtu siç ju paralajmëruam dje, sot po vazhdojmë përsëri të komunikojmë me ju për çështje që kanë të bëjnë me Çairin. Para se të flasim për temën e sotme, do të më lejoni ta falënderoj pushtetin komunal të Komunës së Çairit, sepse sapo ne e përfunduam konferencën e djeshme, ata na e shtuan edhe një argument se ne kemi të drejtë. Ata, meqë e shohin Komunën si organ të Partisë që e ka pushtetin komunal, edhe reagimet partiake i bëjnë në emër të institucionit të Komunës së Çairit. Kështu edhe dje reagimin ndaj nesh, ku nuk kishte asnjë përgjigje se pse kanë mashtruar dhe gënjyer për 12 vjet, e kishin bërë në emër të Komunës së Çairit, edhe pse reamimi kishte të bëjë jo me institucionin e Komunës, por me partinë që e ka pushtetin komunal. Prandaj dua t'i falënderoj që po na ndihmojnë në këtë fushatë. Të dashur qytetarë, kjo është Komuna e Çairit, që është e kapur peng nga Partia, të cilën ne do ta çlirojmë më 15 tetor", ka thënë Ibrahim. Ndërkaq sot, ka vijuar më tej Ibrahim, jemi këtu për diçka tjetër. "Pushketa aktual e Komunës së Çairit në fushatën e vitit 2013 pati premtuar se këtu, në parkingun e Teatrit dhe në hapësirën pas ambulancës, do të ndërtojnë garazh në kate. Dhe, kur jemi këtu ne përsëri i kemi dy pyetje: A i shihni diku ju këto parkingje në kate? Dhe, meqë përgjigjen tashmë e dimë të gjithë, pyetja tjetër është: Nëse dje kryetari i Komunës nuk e ka mbajtur premtimin, pse qytetarët sot duhet t'i besojnë kandidatit tjetër në po kësaj partie? Nëse një herë gënjen dhe e thyen premtimin, gjithë jetën mbetesh gënjeshtar, ndërsa nëse gënjen 12 vjet rresht dhe pa fund herë, kjo bëhet detyrë e vështirë për t'u llogaritur edhe për matematikanët më të mirë", ka akuzuar Ibrahim. Për fund, Ibrahim, premtoi se kaosin me parkingjet do ta zgjidh detyrimisht në katër vitet e ardhshme me planin e ri që do ta hartojë vetëm për parkingjet në Çair.

"Të konkurrosh me dorëshkrime në gjuhën maqedonase dhe pastaj t'i përkthesh të njëjtat në gjuhën shqip nuk është problem i vogël. Përveç se ka koston financiare, libri humb në cilësi si në aspektin metodologjik ashtu edhe përmbajtjesor, mbase humbën edhe më shumë", deklaroi Driton Ajrullai nga SHB "Albas". Kjo, plotëson më tej ai, "i eliminon botuesit shqiptarë nga konkurrimi, pasi i ve në pozita të pabarabarta me botuesit maqedonas". Prandaj ai kërkon që dorëshkrimet të mund të jenë edhe në gjuhën shqipe. **Këtë kërkesë ka edhe Shoqata e Pedagogëve të Muzikës**


Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 28 shtator - Problemi i teksteve shkollore në Maqedoni nuk ka të bëjë vetëm me mungesën e librave, cilësia e dobët e tyre, përmbajtjet skandalozë dhe shpesh herë nxitëse të urrejtjes ndëretnike dhe ndërfaqetare. Në fakt, të gjitha këto probleme janë rezultat i një problemi esencial dhe që ka të bëjë me eliminimin e botuesve dhe autorëve shqiptarë nga procesi i hartimit të testeve shkollore, apo e thënë pak më ndryshe me vënien e tyre në pozita të pabarabarta nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Prandaj, ata kërkojnë me ngulm që MASH të korrigjojë predispozitat ligjore, të cilat nuk lejojnë konkurrimin me dorëshkrime në gjuhën shqipe.

Që një autor apo botues shqiptarë të mund të konkurrojnë për botimin e një libri të caktuar, duhet që domosdo të paraqet në MASH dorëshkrimin e librit në gjuhën maqedonase. Dorëshkrimet në

Botuesit dhe autorët shqiptarë i kërkojnë MASH-it

Dorëshkrimet edhe në gjuhën shqipe



gjuhën shqipe, nuk janë valide, pasi Rregullorja përkatëse me të cilën MASH ka caktuar mënyrën e rregullave për botimin e teksteve shkollore përjashton çdo gjuhë tjetër jo maqedonase. Në Ligjin për botimin e teksteve shkollore nuk është e precizuar një gjë të tillë, por i lihen në dorë MASH-it që ta rregullojë këtë çështje përmes rregulloreve dhe formave tjera juridike. Dorëshkrimet, thotë Adem Imeri, duhet të jenë edhe në gjuhën shqipe. "E kemi biseduar këtu për çështje edhe gjatë një takimi që kishim me ministrin Renata Deskovska dhe kemi kërkuar prej saj që edhe kjo pikë të jetë pjesë e reformave që pritet të ndodhin së shpejti", plotëson Imeri, kryetari i Shoqatës së Pedagogëve të Muzikës. Për të mënjanuar skandalin me librat e muzikës, para 6 viteve SHPM dorëzoi në Ministri variantin e një libri për lëndën e muzikës, me qëllim që i njëjti të shërbejë si dorëshkrim për botimin e librave të kësaj lënde. Mirëpo, gjithçka mbeti në nivelin e premtimeve të MASH-it për gjetjen e mundësive si të zgjidhte ky problem. Institucionalisht problemi është i pazgjidhur ende. Shkollat me vetë iniciativë përdorin librat e muzikës që ka përpiluar

SHPM, por që nuk kanë një leje përdorimi të autorizuar nga MASH-i. Librat e kësaj të fundit nuk janë funksional, jo vetëm sepse injorojnë krejtësisht muzikën shqiptare, por edhe sepse poshtë pentagramave të këngëve maqedonase qëndrojnë tekste të përkthyer në gjuhën shqipe, por që nuk korrespondojnë muzikalisht notat e këngës.

Një javë më parë, MASH ka formuar grupin punues për ndryshimin e Ligjit për tekstet shkollore, meqë ka ngritur iniciativë për përgatitjen e një Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit aktual. Do të rregullohet ose jo çështja e gjuhës në të cilën mund të jenë dorëshkrimet e teksteve shkollore, kjo varet nga anëtarët e grupit punues, veçanërisht ata shqiptarë. Pra, janë këta të fundit të cilët kanë rastin të kërkojnë nga MASH që çështja e dorëshkrimeve të rregullohet Ligj dhe të mos lejojnë që kjo të varret nga rregulloret dhe normat tjera juridike, respektivisht nga vullneti i politikës. Driton Ajrullai, nga Shtëpia Botuese "Albas", thotë se rregullat e lojës aktualisht janë shumë të disfavorshme për botuesit shqiptarë. "Të konkurrosh me dorëshkrime në gjuhën maqedonase dhe pastaj t'i përk-

thesh të njëjtat në gjuhën shqip, nuk është problem i vogël. Përveç se ka koston financiare, libri humb në cilësi si në aspektin metodologjik, ashtu edhe përmbajtjesor, mbase humbën edhe më shumë", sqaron përgjegjësi për botimin e teksteve në Maqedoni. Kjo, plotëson më tej ai, "i eliminon botuesit shqiptarë nga konkurrimi, pasi i ve në pozita të pabarabarta me botuesit maqedonas". SHB "Albas" vepron në Tiranë, Prishtinë, Tetovë dhe Preshevë dhe njihet për botimet cilësore të teksteve shkollore. Mirëpo, prej të gjitha këtyre vendeve ku operojnë, Ajrullai thotë se përvojat më të këqija i kanë me Maqedoninë. Këtu, sipas tij, nuk ka kushte të barabarta konkurrimi për të gjithë botuesit e teksteve shkollore. Në Preshevë, për shembull, Ministria e Arsimit të Serbisë për librat që përdoren nga nxënësit shqiptarë, e lejon konkurrimin me dorëshkrime në gjuhën shqipe. "Vetëm recensimet e dorëshkrimit kërkohen të bëhen në gjuhën shtetërore, pra në gjuhën serbe, thotë ai. Sipas përfaqësuesit të SHB "Albas", Maqedonia shumë mirë mund ta ndjek shembullin e Serbisë. Por që të rregullohen kjo, gjërat duhet të rregullohen me Ligj.

BDI shpall ofertën në Komunën e Butelit

Ahmeti: Edhe një fitore në nivel kombëtar

Shkup, 28 shtator - Në vazhden e fushatës për zgjedhjet lokale të 15 tetorit, kandidatët listës për këshilltarë të Bashkimit Demokratik për Integrim kanë shpallur ofertën për këto zgjedhje në Komunën e Butelit. Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, në tubim, siç njofton Zyra për informim e BDI-së, ka vlerësuar rolin e BDI-së në mirëmenaxhimin e krizës politike në vend, duke rikujtuar se nëse BDI-ja do t'i braktiste institucionet nuk dihet se çfarë drejtimi do të merrnin zhvillimet. "Neve njerëzit na besuan për të drejtuar,

ne njerëzit na kanë besuar për të udhëhequr, për të marrë vendime të guximshme, qofshin ato me kosto dhe pasoja për vet Bashkimin Demokratik për Integrim" deklaroi Ahmeti duke shtuar se nuk ka dashur të bëjë akrobacione e të shes salltanate se është ai që shkatërron qeverinë. "Për të shkatërruar ishte lehtë, për të menaxhuar ishte rëndë, derisa futëm në proces edhe komunitetin ndërkombëtar dhe u bë Marrëveshja e Përzhinës", tha Ahmeti. Duke folur për mosnjerrjen e kandidatëve për disa komuna,



ai tha se BDI-ja kandidon aty ku është e sigurt se ka për të ngadhënjyer dhe nuk hy në lojëra që në fund nuk kanë fitues. "Veprimi jonë është i ar-

syeshëm, i logjikshëm dhe shumë pragmatik në politikë. Ne kandidojmë aty ku fitoren e kemi të sigurt dhe i gjithë potenciali ynë është vënë në shërbim të

fitores në nivel kombëtar", tha Ahmeti, duke përmendur me këtë rast Shkupin e Vjetër, Tetovën, Gostivarin. Krahas kësaj lideri i BDI-së shpjegoi mbështetjen që BDI-ja do t'i japë partnerit të koalicionit, LSDM-së, në Qytetin e Shkupit, në Butel, në Kumanovë, gjë që nuk do të mungojë as nga socialdemokratët maqedonas në komunat ku ata realisht nuk mund të fitojnë. Këtë bashkëpunim ai e vlerësoi si provë se BDI-ja siç ka thënë, nuk bën politikë me standard të dyfishtë - gjithçka tjetër do të ishte hipokrizi nëse

ndryshe deklarojnë e ndryshe veprojnë. Ai në tubimin e mbajtur me anëtarë e simpatizantë të partisë, bëri thirrje për mbarëvajtjen këtij procesi zgjedhor.

"Ne kemi me çka të dalim përpara njerëzve. Të prodhojmë qetësinë, t'ua kërkojmë njerëzve përkrahjen, sepse, të mos turpërohemi, vërtetë kemi bërë, kemi ndryshuar këtë vend. Ndryshe është! Dhe kush mund t'i çojë përpara këto procese, kush mund të ndërtojë më mire ardhmërinë përveç se ju këtu që jeni!" përfundoi lideri i BDI-së, Ali Ahmeti.



Kriza politike dëmtoi bankat

Shkup, 28 shtator - Bankat në kuartalin e parë të këtij viti kanë vërejtur aktivitet më të vogël për 1.6 për qind nën ndikimin e faktorëve të zakonshëm sezonal, aktivitet të ngadalësuar ekonomik, si dhe për shkak të rreziqeve prej ngjarjeve politike vendore të cilat ishin të pranishme. Këtë e konstatoi Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në seancën e së enjtes në të cilën u shqyrtua dhe miratua Raporti për rreziqet në sistemin bankar në kuartalin e parë të vitit 2017. Në këtë periudhë, siç kumtojnë nga BPRM, potenciali depozitar i bankave është zvogëluar para së gjithash nën ndikimin e zvogëlimit të depozitave korporative. Shkalla kryesore e interesit u zvogëluar gjithsej për 0,50 për qind pikë dhe u reduktua në 3,25 për qind që është niveli para eskalimit të gjendjes politike dhe spekulimeve në tregun devizor dhe depozitar nga fillimi i kuartalit të dytë të vitit 2016. Ndryshimet në lartësinë e shkallës kryesore të interesit janë ndjekur me ndryshime në lartësinë e shumës së ofruar të të dhënave të kontabilitetit. Në fund të kuartalit të parë të vitit 2017, pjesëmarrja në jofunksionalitetet në kreditë e përgjithshme shënoi zhvendosje të vogël dhe u ul në nivelin prej 6,4 për qind, kundrejt 6,6 për qind më 31 dhjetor 2016. Pjesëmarrja e jofunksionaliteteve në kreditë e përgjithshme të amvisërive është stabile, dhe lëviz rreth 2.5 për qind. Treguesit e solvencës dhe kapitalizimit të sistemit bankar shënojnë rritje të caktuar në kuartalin e parë të vitit 2017, që del më së shumti prej uljes së aktivitetit të përdoruar sipas rreziqeve të bankave edhe atë para së gjithash sipas rrezikut valutor. Rezultatet e testimit të stresit të zbatuara më 31 mars 2017 janë më të mira në krahasim me fundin e vitit 2016 dhe tregojnë për rezistencë të kënaqshme të bankave ndaj goditjeve të simuluar.

Vlerësohet se menaxherët në vend kryesisht mendojnë dhe funksionojnë në suaza lokale dhe jo globale, ndërsa kënaqen me fitimin që e realizojnë në tregun vendor

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 shtator - Maqedonia posedon shumë pak brende që janë të njohura jashtë kufijve të saj si në shtetet fqinje, ashtu edhe në tregun evropian. Ekonomistët thonë se brishtësia e ekonomisë vendore, rritja e dobët ekonomike, si dhe tregu i vogël i varur nga eksporti ndikojnë në faktin që Maqedonia në më shumë se 20 vite pavarësi - krijoi vetëm disa dhjetarë brende që megjithatë me shumë vështirësi depërtojnë në tregjet e huaja. Vlerësohet se menaxherët në vend, kryesisht mendojnë dhe funksionojnë në suaza lokale dhe jo globale dhe kënaqen me fitimin që e realizojnë në tregun vendor. Ekspertët e marketingut thonë se shkaqet kryesore pse brendet nga Maqedonia nuk njihen nga konsumatorët në rajon janë mungesa e investimit në promovimin e prodhimeve jashtë, mos-pozicionimi në marketet e mëdha dhe rrjetet e mëdha tregtare, gjegjësisht mungesa e investimeve me qëllim që prodhimet e Maqedonisë të kenë një imazh të njohur në rajon. Si faktor të tjerë janë edhe vogëlsia e tregut vendor apo numri i vogël i konsumatorëve vendor që nuk lejon rritjen e brendit në raport me tregun serb apo kroat për shembull, si dhe mos-prezenca me prodhimet tona në media e rajonit. Vlerësohet se krijimi i brendit në suaza rajonale dhe globale është një proces afatgjatë që kërkon investime të mëdha që në kushte në të cilat funksionon biznesi vendor paraqet një punë mjaft të vështirë.

Në shitoret e ndryshme në tregjet rajonale dhe evropiane,

Maqedonia dobët me brende tregtare

As rajonin s'e konkurrojmë dot!



pak dallohen brendet e njohura nga Maqedonia që nënkupton se prodhuesit vendor - më shumë janë të orientuar ndaj konsumatorit në vend. Faktin se edhe në dy dekadat e ekzistencës së Maqedonisë si shtet i pavarur janë krijuar vetëm disa dhjetëra marka apo brende nga Maqedonia të njohura edhe jashtë kufijve të saj që shiten jashtë, shpjegohet nga ana e ekonomistëve me interesimin e vogël të afaristëve të vendit që të zhvillojnë brendet e tyre vetanake. Nën brend nënkuptohet emri, shenja, simbol apo dizajni me qëllim të identifikimit të produkteve apo shërbimeve të një kompanie dhe diferencimit të tyre nga produktet dhe shërbimet e konkurrencës. Njohësit e marketingut thonë se prodhimi prodhohet në fabrikë, fushë apo kopsht, ndërsa brendi në kokën e konsumatorëve. Me fjalë të tjera, brendimi i prodhimit për eksport është transformimi i prodhimit në brend në një fo-

tografi në kokën e konsumatorit që me vete përcjell edhe premtimin se prodhimi do të plotësojë pritjet që ka konsumatori. "Kompanitë vendore nevojitet më shumë të orientohen në strategjitë e brendimit që të mund të kapin hapin në mos me kompanitë ndërkombëtare, atëherë së paku me kompanitë e rajonit. Sikur tek biznesi vendor mungon dëshira të investojnë në prodhimet e tyre me qëllim që ata të njihen në treg. Që të krijohet brend i suksesshëm nevojitet një tregim dhe asociim për çdo prodhim me qëllim që të hyn në vetëdijen e konsumatorëve", thotë konsulentja e biznesit, Lençe Sotirovska. Nga ana tjetër, ekspertët e marketingut thonë se brendingu i suksesshëm i prodhimeve ka për qëllim që me cilësinë e lartë të prodhimeve që në vazhdimësi i ofrohet konsumatorit, vendimi për blerje të merret që para vetë procesit të blerjes.

Vlerësohet se problemi kryesor të bizneset tona është

edhe orientimi i tyre të punojnë në treg të vogël dhe konkurrencë të vogël si dhe mungesa e fokusit të tyre që të eksportojmë më shumë ku pjesa më e madhe e kompanive pak investojnë në brendimin e prodhimeve. Në ndërkohë në shtet ekzistojnë edhe shembuj të kompanive të suksesshme që vitet e fundit kanë promovuar brende të reja në Maqedoni dhe jashtë saj, siç janë - për shembull kompania Tikvesh me verërat e saja, Alkaloidi me brendin Bekutan, apo brendi i ajvarit "Mamass" që synojnë në mënyrë strategjike dhe afatgjatë të gjejnë pozitën e tyre në treg dhe që tregojnë se investimet në marketing dhe inovacione çdo herë sjellin rezultate. Prezencën e dobët të brendeve vendore edhe në tregjet e rajonale e tregon edhe matja e fuqisë së brendit në hapësirat e ish Jugosllavisë. Në top listën e 25 brendeve, krahas atyre globale - renditen edhe brende nga Sllovenia, Kroacia apo Serbia, por jo edhe nga Maqedonia. Në vendin e parë, në shtetet e ish Jugosllavisë janë CoCa Cola, çokollatat Milka, ndërsa pasojnë Cedevita, Vegeta, Argeta, Smoki, Orbit, Cocta, Nivea, Jana, Colgate, Fanta, Chipsy, Paloma, Sprite, Plazma, Lenor, Pepsi, Ki-ki, NesCaffe, Jaffa Cakes, Snickers, Gillette, Airvaves, dhe jogurti Dukat. Renditja e brendeve vetëm për Maqedoninë tregon se i pari është brendi Argeta, ndërsa pas pastetës sllovene renditen Jogurti qumështores së Manastirit, Coca Cola, Colgate, Stobi Flips i Vitaminkës së Prilepit, Nescafe, Milka, Vegeta, Orbit, dhe Palloma.

GOOGLE KRYESON ME 110 MILIARDË DOLLARË

Sa i takon markave më të njohura botërore apo brendeve, Google këtë vit renditet në krye të klasifikimit që vlen afër 110 miliardë dollarë, duke lënë pas Apple, e cila tani mban vendin e dytë me vlerën prej 107 milionë dollarë. Në vend të tretë gjendet Amazon, në vendin e katërt kompania amerikane e telekomunikacionit ATT, ndërsa Microsoft zbriti në vendin e pestë. Sa i përket kompanisë Samsung, ajo është e pozicionuar në vendin e gjashtë. Në vendin e shtatë është Verizon i sektorit të telekomunikacionit, ndërsa në vendin e tetë kompania Walmart, gjiganti amerikan i tregtisë. Në vendin e dhjetë renditet banka kineze ICBC. Surpriza është kompania Facebook, që ka hyrë në "Top 10", duke u renditur në vend të nëntë, nga vendi i 17-të që ishte vitin e kaluar, tregon klasifikimi i Brand Finance Global.

Debat i GIPP për personat me pengesa

Përfshirje më e madhe e personave me pengesa

Shkup, 28 shtator - Shqyrtimi i mundësive për angazhim më të madh të personave me pengesa në jetën politike dhe mënyrat se si kjo të arrihet, janë temat të cilat të enjten i shqyrtuan pjesëmarrësit e punëtorisë, që në organizim të Grupit interpartiak parlamentar u mbajt në Kuvendin e Maqedonisë. Temat e punëtorisë, mes të tjerash, dolën edhe nga analiza e fundit që e bëri Misioni i OSBE-së në Maqedoni, rreth të cilit përgatiti edhe rekomandime të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e Kodit zgjedhor me konventën e të drejtave të personave me pengesa, vendosjen e masave afirmative si "sistem i kuotës" për përfshirje të përshpejtuar të këtyre personave në jetën politike dhe publike, vendosje e një eksperti të jashtëm në KSHZ i cili do të ishte person me pengesa, vendosje e klauzolës antidiskriminuese në ligjet për medime dhe shërbime audio dhe audiovizuale, rregullimi i alfabetit të Brajlit në procesin zgjedhor... "Punëtorja ka për qëllim t'i shqyrtojë mundësitë për angazhim politik të personave me pengesa, diçka që ndoshta në shoqërinë

tonë ka qenë e panjohur, por në këtë mënyrë dëshirojmë t'i themi opinionit se ekziston edhe ky grup njerëzish të cilët, nga, nuk e dimë për cilat shkaqe, nuk janë trajtuar në kuptim të angazhimit të tyre të mundshëm politik, ndërkaq si qytetarë i shfrytëzojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet lidhur me zgjedhje dhe të jenë të zgjedhur", tha kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi. Ky, shtoi, është fillim i ri, sepse, siç tha, që kur e ka ndër marrë detyrën ka thënë se Kuvendi do të jetë inkluziv për të gjitha grupet. Kryetarja e GIPP, Frosina Tashevsk

Remenski theksoi se është reale nevoja për debat rreth çështjes së pjesëmarrjes politike të personave me pengesa dhe se duhet të gjenden mënyra për t'u tejkaluar barrierat me të cilat përballen këta persona. "GIPP si grup lobues për përfaqësimin e të drejtave të personave me pengesa në periudhën e ardhshme ka për detyrë të punojë sipas kornizës, të cilën e vendosëm bashkarisht, për promovimin e çështjeve të interesit për këta persona. Në atë drejtim Kuvendi do të jetë vend dhe forum ku do të organizohen debate, ndërsa

grupet e deputetëve dhe GIPP do të jenë vizitues të vendeve ku për atë kanë nevojë këta persona", tha ajo. Në mposhtjen e pengesave, tha, posaçërisht me rëndësi është që partitë e ndryshme politike kanë qëndrim të njëjtë rreth këtyre çështjeve. Gonzalo De çezare, shef i sektorit për dimension njerëzor, Misioni i OSBE-së në Shkup potencoi se motoja "asgjë për ne pa ne" duhet të jetë parim udhëheqës i të gjitha aktiviteteve për parandalim të diskriminimit.

"Më vjen mirë që në këtë debat ka persona nga sektori qeveritar dhe joqeveritar në mënyrë që të bisedohet për barrierat me të cilat përballen personat me pengesa të cilët paraprakisht ishin identifikuar përmes analizës që e zbatuam këtë vit", tha ai. Elena Koçoska nga Polio Plus-lëvizje kundër handikapit, tha se GIPP kësaj radhe hap një çështje tjetër, e ajo është realizimi i të drejtave qytetare dhe politike të personave me pengesa. Punëtorja po mbahet në bashkëorganizim të kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi dhe Plio Plus-Lëvizjes kundër handikapit.



Përfundojnë seancat për rastin e Kumanovës

Më 17 tetor aktgjykimi, asnjë fjalë për hetimin ndërkombëtar

Të akuzuarit e "Grupit të Kumanovës", pjesa dërmuese e të cilëve shtetas të Kosovës, gjatë gjithë procesit gjyqësor i cili ka zgjatur pothuajse dy vite të plota, nuk kanë treguar se kush i ka thirrur që të vijnë në Maqedoni, mirëpo në të shumtën e rasteve - ata kanë përmendur emrat të politikanëve dhe funksionarëve të lartët shtetëror si persona më të cilët kanë pasur kontakte



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 28 shtator - Seancat gjyqësore kundër 37 të akuzuarve shqiptarë për ngjarjet e Kumanovës të vitit 2015, zyrtarisht kanë përfunduar të enjten. Me vendim të Trupit gjyqësor të drejtuar nga gjykatësja Verka Petrovska, aktgjykimi për veprat "terrorizëm" dhe "organizatë terroriste", pritet të shpallet me 17 tetor. Caktimin e kësaj date, gjykatësja Petrovska e arsyetoi me numrin e madh të të akuzuarve, prezantimin e dëshmitëve dhe provave të ndryshme nga palët në proces, si dhe kjo datë është marrë parasysh nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila gjatë periudhës që vjen - do të ketë angazhime shtesë. Duke e komentuar rrjedhën e procesit gjyqësor, avokati Naser Raufi tha se pala mbrojtëse në përgjithësi është pesimiste dhe nuk presim ndonjë aktgjykim korrekt dhe të drejtë. Këtë qëndrim, ai e mbështet në mënyrën se si është zhvilluar procesi gjyqësor për këtë rast, me çka Trupi gjyqësor

nuk i ka marrë parasysh propozimet sa i përket dëshmitarëve dhe provave që duhej të prezantohen. "Krahas grupit të Kumanovës, aktgjykimi për procesin gjyqësor kundër Sulejman Osmanit do të miratohet me 5 tetor. Por, një moment tejet i rëndësishëm në të gjithë këtë proces gjyqësor është refuzimi i dëshmitëve shtesë nga ana jonë, si për 'Grupin e Kumanovës', ashtu edhe për Sulejman Osmanin. Në rastin e parë, arsyetimi i Trupit gjyqësor ishte se dëshmitë shtesë të cilat i propozoi pala mbrojtëse refuzohen për shkak se të njëjtat është dashur të propozohen në fazat e mëhershme të këtij procesi gjyqësor. Përderisa, në fjalët përfundimtare në rastin e Sulejman Osmanit, të dhënat nga ana jonë Gjykata i shpalli të pavlefshme. Kjo mënyrë e veprimet është tregues i mjaftueshëm se Trupi gjyqësor nuk është i interesuar për zbardhjen e rastit. Unë jam i mendimit se në rast të pranimit të dëshmitëve tona, në të dy rastet për procesin e njëjtë gjyqësor, e gjithë lënda do të zbardhej dhe e vërteta do të

dilte në shesh", tha Raufi. Të akuzuarit e "Grupit të Kumanovës", pjesa dërmuese e të cilëve shtetas të Kosovës, gjatë gjithë procesit gjyqësor i cili ka zgjatur pothuajse dy vite të plota, nuk kanë treguar se kush i ka thirrur që të vijnë në Maqedoni, mirëpo në të shumtën e rasteve - ata kanë përmendur emrat të politikanëve dhe funksionarëve të lartët shtetëror si persona më të cilët kanë pasur kontakte. Arsyeja e ardhjes së tyre, siç tha avokati Raufi, qenë kryesisht për çështje patriotike, dhe në asnjë moment për përfitime materiale. Paralajmërimet e funksionarëve të lartë të shtetit se për rastin e "Kumanovës" do të ketë hetim ndërkombëtar, u është bashkangjitur edhe avokati Naser Raufi, sipas të cilit, vetëm përmes një procesi të tillë - do të zbardhet i gjithë rastin. Miratimi i aktgjykimit i cili pritet të ndodhë me 17 tetor, siç thotë ai, nuk nënkupton se ai është i plotfuqishëm. "Praktika e deritashme ka treguar se ka shumë procese të montuara gjyqësore për të cilët pritet të zhvillohen hetim ndërkombëtar.

Pengesa nuk është aktgjykimi. Neve na duhet publikimi i momenteve të rëndësishme të këtij rastit, të njëjtat nuk duhet të fshihen, gjegjësisht i gjithë ky proces duhet të jetë më transparent. Për mungesë të transparencës së këtij procesi gjyqësor, është i njoftuar edhe Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, pasi një pjesë e mirë e përfaqësuesve të forumeve ndërkombëtare nuk janë lejuar të marrin pjesë në seancë. Me hetimin ndërkombëtar patjetër të përfshihen edhe persona tjerë në aktakuzë, në këtë rast persona nga shërbimi sekret dhe të involvuar tjerë, të cilët kanë bërë delikte. Ky, në fakt është synimi jonë si palë mbrojtëse", tha Raufi. Ndryshe, në seancën e fundit të mbajtur të enjten - fjalë përfundimtare kanë pasur të akuzuarit Seadudin Abdullahi, Ibrahim Murtezani, Ebip Aliji dhe Besnik Bajrami, të gjithë këta të akuzuar për vepra penale "terrorizëm" dhe "organizatë terroriste", megjithatë jo si kryerës të sulmeve apo kundërshtimit të forcave policore, por si ndihmës, të cilët sipas Prokurorisë, kryesisht kanë qenë të angazhuar për "mbështetje logjistike". Këto akuzat të akuzuarit kategorikisht i refuzuan dhe thanë se Prokuroria gjatë gjithë kohës nuk ka arritur t'i vërtetojë këto akuzat. Nga incidenti i armatosur më 9 maj të vitit 2015 në Kumanovë, u vranë 8 pjesëtarë të forcave policore, 10 anëtarë të grupit, njëri prej të cilëve kishte kryer vetëvrasje, respektivisht në mesin e të vranëve kanë qenë edhe Mirsad Ndrecaj dhe Beg Rizaj, të cilësuar si organizatorët kryesor të këtyre ngjarjeve.

Kronikë

Vjedhje në Xhaminë e Reçicës

Natën mes të hënës dhe së martës, persona të panjohur, kanë kryer vjedhje të rëndë në Xhaminë e re në fshatin Reçicë e Madhe, që ndodhet përballë pompës së benzinës në dalje të këtij fshati. Pasi që me forcë kanë hapur dritaren prej alumini në hapësirat e bodrumit, kanë hyrë në Xhami, e kanë nxjerrë arken prej metali, e cila ka qenë e vendosur në murin e derës hyrëse. Në arkë ka pasur rreth 6000 denarë, mjete të vullnetarëve, destinimi i të cilave ka qenë për individët në nevojë. Me marrjen e arkës prej metali që ka qenë e rëndë rreth 15 kilogramë, ata e kanë lëshuar xhaminë duke mos u vërejtur nga askush. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe punohet në zbardhjen e plotë dhe gjetjen e hajnave, ndërsa policia disponon me të dhëna për identitetin e hajnave. Përndryshe kjo xhami është lëshuar për përdorim para disa muajve.

Gjenden 10 legjitimacione të hedhura

Të mërkurën rreth orës 13 në trotuarin afër rrethorrotullimit të ish Monopoli, pjesëtarë të policisë kanë gjetur një qese prej plastike, ku ka pasur 10 legjitimacione zyrtare nga Inspektoratit për bujqësi, pylltari dhe ujëra. Të njëjtat janë marrë, fotografuar dhe dërguar në Stacionin Policor në Tetovë. Janë marrë masa dhe aktivitetet për zbardhjen e plotë se kush dhe pse i kanë lënë ato në atë vend.

Aksident në Tetovë, një i lënduar

Në kryqëzimin e rrugëve të Ilindenit dhe KRK, në Tetovë, të mërkurën rreth orës 18.00 ka ndodhur një aksident trafiku ku kanë marrë pjesë veturë e tipit Ford Fiesta me targa të Tetovës, e drejtuar nga 35 vjeçari F.M nga Tetova dhe një mopedi me tri rrota Piaxho, me targa të Tetovës që e ka drejtuar 62 vjeçari R.H nga Tetova pa leje për qarkullim. Vozitësi i Mopedit ka marrë lëndime trupore dhe është dërguar për kurim në Spitalin Klinik të Tetovës ku edhe është mbajtur për shërim të mëtejshëm. Pas kryerjes së hetimeve, janë duke u zbardhur shkaqet për këtë aksident. Si arsye për këtë aksident ka qenë mos dhënia e përparësisë së kalimit, ndërsa dëmi është vlerësuar rreth 30 mijë denarë.

Një 12-vjeçar ther babain dhe vëllain e tij

Një nxënës i klasës së tetë (12-vjeçar) mëngjesin e së enjtes gjatë një zënke familjare e ka goditur me thikë babain dhe vëllain e tij. Nga MPB kumtuan se mëngjesin e sotëm rreth orës dy në Shkup një minoren i moshës 12 vjeçare gjatë një zënke familjare, e ka goditur me thikë babain e tij D.S. (37) dhe i ka shkakuar prerje në pjesën e përparme të parakrahut të majtë, ndërsa vëllain e tij të moshës 15 vjeçare e ka lënduar në pjesën e këllkut. Që të dy me automjet të Ndihmës së shpejtë janë dërguar në Qendrën urgjente - Shkup, ku u janë konstatuar lëndime trupore, ndërsa pas ndihmës së dhënë trupore janë lëshuar në kursim shtëpiak. SPB-Shkup ndërmerr masa për zbardhje të plotë dhe dokumentim të ngjarjes. (O.Xh)

Edhe Mijalkovi mbetet pa pasaportë

Shkup, 28 shtator - Këshilli penal i sektorit për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës Themelore Shkup 1, e refuzoi si të pabazë kërkesën e pezullimit e masave parandaluese të ish drejtorit të DSK-së Sasho Mijalokov, i cili është i akuzuar nga PSP në rastet "Target" dhe "Fortesa". "Këshilli penal i sektorit për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës Themelore Shkup 1, duke vepruar rreth propozimit të të akuzuarit S.M. të parashtruar përmes mbrojtësve të rij për pezullimin e masave parandaluese, në seancë jopublike, mori vendim me të cilin kërkesa refuzohet si e pabazë", kumtoi Gjykata Penale e Shkupit. Prej atje theksojnë se masa e parandalimit, konfiskimi i perkohshëm i dokumentit të udhëtimit për kalim të kufirit shtetëror dhe ndalesë për dhënie të dokumentit të udhëtimit apo dokument tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, dhe masa, obligim i të akuzuarit një herë në javë të paraqitet tek personi zyrtar kompetent në Gjykatë - mbesin në fuqi. Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të ankesës në afat prej tri ditëve në Gjykatën e Apelit - Shkup.

Sërish shtyhet gjykimi kundër Gruevskit



Shkup, 28 shtator - Për shkak të mungesës së dy prej 13-të të akuzuarve në rastin "Dhunë dhe shuplaka në komunën Qendër", seanca e djeshme gjyqësore është shtyrë për më 20 nëntor. Prokurorja e PSP-së, Fatime Fetaj për shkak të mungesës së paarsyeshme të njërit prej të akuzuarve kërkoi që ai në seancën e ardhshme të shoqërohet nga policia.

Në Gjykatën Penale të Shkupit të enjten ishin të pranishëm lideri i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, i cili është i akuzuar i parë, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakievski dhe deputetja e VMRO-DPMNE-së, Daniella Rangelova. Gjykatësja Tatjana Mihajlova në seancën gjyqësore, prokurorës Fetaj i dha parashtrës nga Gjykata e Apelit me të cilat sqaron pse në seancën e kaluar gjyqësore nuk ka qenë lëndë në Gjykatë. Sipas Fetajit ky është vetëm një tentim për arsyetim të gjykatës për zvarritje të panevojshme të procedurës. Para fillimit të gjyqësorisë, drejtori i ndërmarrjes publike NP Parkingje të komunës Qendër, Sasha Bogdanoviq tha se drejtësia është e ngadalshme, por e arritshme. "Thyerja skandaloze e hapësirave të Komunës Qendër dhe shuplakat e porositura për kryetarin e komunës Andrej Zhernovski nga kryeministri i atëhershëm Nikolla Gruevski kanë ndodhur në vitin 2013. 'Bombën' në të cilën Gruevski kërkoi shuplaka dhe protesta para Komunës Qendër e publikova në vitin 2015, ndërsa e ka dëgjuar tërë opinionin i Maqedonisë dhe më gjerë", tha Bogdanovski.



Kjo nuk është hera e parë që ndodh një gjë e këtillë kur qytetarëve të Tetovës, të cilët janë parkuar një ditë më parë t'iu vijjnë SMS një ditë me vonesë, duke shkaktuar huti në mesin e tyre

SMS e parkingut shqetësojnë qytetarët

Nuk dëmtohen qytetarët



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 28 shtator - Gjatë ditës së mërkurë qytetarë të shumtë janë ankuar se u kanë ardhur SMS porosi kthyes nga ana e Ndërmarrjes Publike "Parkingut i Qytetit" për parkim të realizuar një ditë më herët. Madje, në telefonat e culelarëve qytetarëve u kanë ardhur më shumë porosi që ka shkaktuar revoltë tek qytetarët se ndoshta u janë marrë para nga telefonat e tyre.

"Unë kam qenë i parkuar një ditë më herët, kam dërguar porosi për parkim dhe pastaj jam larguar. Nuk e di se si ka ndodhur, sepse unë një ditë më pas nuk kam qenë i parkuar askund në qytet. Duhet që autoritetet përgjegjëse të japin sqarime për këtë që ka ndodhur", thonë qytetarët e revoltuar.

Nga ana tjetër, drejtori i NPK-së Parkingut i Qytetit, Fejsal Behadini, është shprehur se bëhet fjalë për gabim në sistem dhe qytetarëve nuk u janë marrë para nga telefonat e tyre.

"Në lidhje me kthimin e SMS porosive nga ana e sistemit të NP Parkingut i Qytetit-Tetovë gjatë ditës së djeshme, konstatojmë se bëhet fjalë për kthim të informacionit për mbarim të sesionit të parkimit si pasojë e restartimit të servisit për kthim të informacionit për mbarim parkimi, si pasojë e ngarkesës së serverit dhe se e njëjta është vetëm informacion që është marrë në vonesë dhe e njëjta nuk ka impakt financiar te qytetarët", deklaroi Fejsal Behadini, drejtor.

Ai më tej ka sqaruar se pagesa bëhet në fillim të

parkimit dhe që në atë moment të merren paratë dhe jo në fund të parkimit.

"Kujtojmë që pagesa e sesionit të parkimit bëhet vetëm në momentin e dërgimit të SMS porosive, ku qytetarët vet e caktojnë kohëzgjatjen e sesionit të parkimit konform zonës e jo në momentin kur vjen porosia kthyes se parkimi ka mbaruar. Për më shumë informacione qytetarët mund të adresohen te Qendra e Ndërmarrjes me numër 044 511 111", tha drejtori i NPK-së Parkingut i Qytetit, Fejsal Behadini.

Kjo nuk është hera e parë që ndodh një gjë e këtillë kur qytetarëve të Tetovës, të cilët janë parkuar një ditë më parë t'iu vijjnë SMS një ditë me vonesë, duke shkaktuar huti në mesin e tyre. Ndërkaq, sipas raporteve të kësaj ndër-

Drejtori i NPK-së Parkingut i Qytetit, Fejsal Behadini, është shprehur se bëhet fjalë për gabim në sistem dhe qytetarëve nuk u janë marrë para nga telefonat e tyre. Ai më tej ka sqaruar se pagesa bëhet në fillim të parkimit dhe që në atë moment merren paratë dhe jo në fund të parkimit

marrje, të hyrat kryesore janë nga dërgimi i SMS porosive, nga shitja e biletave dhe nga shërbimi i merimangës.

"Kryesisht të hyrat e ndërmarrjes janë nga Telekom, apo dërgimi i SMS porosive për parkim, nga shitja e biletave për parkim si dhe nga shërbimi i merimangës për parkim të gabuar në qytet", theksoi ai.

Sipas drejtuesve të kësaj ndërmarrje për vitin 2016 gjithsej ndërmarrja ka një bilanc prej 200 mijë denarëve. "Vitin e kaluar kemi një bilanc pozitiv prej 200 mijë denarë dhe shpresojmë se me këtë ritëm të vazhdojmë edhe më tej. Për vitin 2017 është paraparë një buxhet prej 37 milionë denarë për këtë ndërmarrje", tha Fejsal Behadini, drejtor i kësaj ndërmarrje.

Në Tetovë në disa rrugë parkimi është me pagesë kurse çmimi është 20 denarë dhe 30 denarë një orë parkimi.

Dorëzohen çmimet për përkthyes letrarë për vitin 2017

Ahmet Selmanit çmimi "Grigor Përliçev"



Shkup, 28 shtator - Lidhja e përkthyesve letrarë e Maqedonisë sot në Shoqatën e shkrimtarëve të Maqedonisë ka ndarë nëntë çmime për përkthime letrare për vitin 2017.

Fitues të dy çmimeve për vepër jetësore, të cilat u ndahen përkthyesve të afirmuar, këtë vit janë Violeta Jagev - përkthye nga gjuha spanjolle (çmimi "Kiril Pejçinoviç") dhe Naum Kitanovski, përkthyes nga gjuha italiane (Karta "30 Shtatori").

Shtatë çmimet e tjera janë për përkthime të veprave në vitin kalendarik, respektivisht nga shtatori i vitit të kaluar deri në shtator të këtij viti, të cilat i nominonjë vetë shtëpitë botuese.

Maja Jovanovska e fitoi çmimin "Bozhidar Nastev", i cili i ndahet për përkthime nga grupi i gjuhëve romane, për përkthim nga frëngjishtja në maqedonisht të romanit "Ana Marija" nga autori Lisjen Bodar. Ahmet Selmani e fitoi çmimin për poezi "Grigor Përliçev" për përkthim nga shqipja në maqedonisht të librit poetik "Duke e prituri ëndrrën" nga Fatjona Geci, çmimin "Arkipeshkvi Gavril" e fitoi grupi i murgeshave nga manastiri Veljusa për përkthim kolektiv të librit "Liria e vërtetë, martirë të rinj rrëfyes (1942-1964). Çmimet për përkthime letrare janë ndarë në prag të Ditës botërore të përkthyesit 30 Shtator, e inicuar nga UNESCO.

Deklaratë kundër dhunës mbi punonjësit shëndetësorë

Shkup, 28 shtator - Deklarata kundër dhunës verbale dhe fizike mbi mjekët, stomatologët, farmaceutikët, infermieret, teknikët, obstetrikët dhe punonjës tjerë shëndetësorë sot nënshkruan ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari, kryetarja e Odës mjekësore të Maqedonisë, Kalina Grivcave Stardelova, kryetarit të Odës stomatologjike Vllado Popovski, përfaqësuesi i Odës farmaceutike Eroll Ali, si dhe

kryetarja e Shoqatës së infermiereve, teknikëve dhe obstetrikës së Maqedonisë, Velka Llukic. Në tekstin e Deklaratës thuhet se vetëm një mjedis i sigurt, në të cilin shtohen shërbimet shëndetësore garanton, mbrojtje shëndetësore profesionale dhe cilësore për pacientët dhe se punonjësit shëndetësorë si dhe të gjithë tjerët kanë të drejtë në mjedis të sigurt pune. "Dhuna ndaj punon-

jësve shëndetësorë duhet të kuptohet seriozisht nga ana e drejtuesve të të gjitha institucioneve shëndetësore dhe me të njëjtën duhet në mënyrë efikase të përballemi me ndihmën e policisë dhe të sistemit juridik. Incidentet e dhunës duhet të jenë të dokumentuara përmasë sistemit, në të cilin do të sigurohet nga ana e Qeverisë dhe institucioneve shëndetësore", qëndron në Deklaratë. Prapa Deklaratës,

siç theksuan nën nënshkrim, qëndrojnë mbi 20 mijë punonjës të mjekësisë në Maqedoni. Nënshkrimi i Deklaratës është në 25 vjetorin e themelimit të Odës ekonomike të Maqedonisë. Ajo është ratifikuar edhe nga anëtarët e ZEVA në të cilën janë të anëtarësuara odat nga Evropa Qendrore dhe Lindore, ndërsa Oda mjekësore e Maqedonisë e nënshkroi javën e kaluar në Kongresin në Lubjanë.

Dautogllu në UT

Turqit dhe shqiptarët janë vëllezër

Tetovë, 28 shtator - Ish kryeministri i Turqisë, Doctor Honoris Causa i Universitetit të Tetovës Ahmet Dautogllu, ka qëndruar për vizitë në Universitetin e Tetovës ku përpara studentëve të këtij Universiteti ka mbajtur një ligjëratë me temë: "Ardhmëria e (ç)rrregullimit kombëtar dhe global: Populizmi përjashtues kundrejt qeverisjes globale gjithëpërfshirëse".

Fillimisht përpara të pranishmëve fjalë rasti mbajti prorektori për bashkëpunim ndërkombëtarë, Arbër Çeliku, i cili në

fjalën e tij vlerësoi lartë figurën dhe personalitetin e ish kryeministrit të Turqisë, Ahmet Dautogllut.

Në fjalën e tij ish kryeministri Dautogllu tha se është nder dhe kënaqësi që është sërish këtu, në Tetovë në Universitetin e Tetovës ku veten e ndjej si në shtëpinë time. Gjatë ligjëratës së tij para studentëve Dautogllu, theksoi se të gjithë ne po kalojmë në një proces të vështirë dhe pikërisht për këtë që të gjithë ne do të duhet të mendojmë më thellë, se cila do të jetë e



ardhmja e rajonit dhe botës. Pas ligjëratës së mbajtur, ish kryeministri i Turqisë, Ahmet Dautogllu,

u pyet për përkrahjen e shtetit turk ndaj shqiptarëve dhe marrëdhëniet shqiptaro-turke.

"Kur flitet për marrëdhëniet shqiptaro-turke, njerëzit mendojnë se bëhet fjalë për dy palë. "Nuk është ashtu! Shqiptarët dhe turqit janë një. Nuk mund të ketë dy palë mes vëllezërve", shqiptarët nuk janë të vetëm, ata gjithmonë duhet ta dinë se pas vetes kanë edhe 8 milionë shqiptarë të tjerë që jetojnë në Turqi. "Shqiptarët jetojnë në gjashtë shtete. Kjo nuk është plotësisht e saktë. Llogaritni edhe 8 milionë shqiptarë që jetojnë në Turqi", tha Dautogllu. Pasi përfundoi ligjëratën në Universitetin

e Tetovës, Dautogllu nga drejtuesit e Universitetit të Tetovës për dhuratë pranoi një portret të ish rektorit, Fadil Sulejmani, për të vazhduar më pas vizitën e tij në Tetovë, duke vizituar Xhaminë e Pashës, ku edhe fali namazin e drekës. Vizita e ish kryeministrit të Turqisë në Universitetin e Tetovës rikonfirmon edhe njëherë bashkëpunimin e shkëlqyer që ka ngritur Universiteti i Tetovës me universitete të njohura ndërkombëtare, sidomos me universitete prestigjioze nga Turqia.

Ndërmarrja publike radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë publikon konkurs nga cikli i katërt kuartal për vitin 2017 për krijimin e kompozimeve të reja nga Ligji për mbështetje të produksionit për muzikë vendase.

Konkursi shpallet më 29 shtator 2017 dhe zgjatë 90 ditë.

Me qëllim të nxitjes së zhvillimit të muzikës argëtuese dhe popullore, Ndërmarrja publike radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë Shkup me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë ndërsa përmes konkursit çdo vit financon krijimin e 200 kompozimeve të reja vokale-instrumentale, nga të cilat 150 janë nga fusha e muzikës argëtuese dhe popullore dhe 50 nga kompozimet për fëmijë.

Me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë Ndërmarrja publike radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë – Shkup financon krijimin e kompozimeve të reja në kategoritë në vijim:

- 1) "talentë" – 10 kompozime në vjet;
- 2) "realizues i afirmuar" – 20 kompozime në vjet;
- 3) "realizues i theksuar" – 35 kompozime në vjet;
- 4) "realizues cilësor" – 37 kompozime në vjet;
- 5) "vjet" – 28 kompozime në vjet;
- 6) "kompozimet me të cilat afirmohen vlerat familjare në shoqëri ose familje me shumë fëmijë" – 10 kompozime në vjet;
- 7) "kompozime me të cilat afirmohet historia e Maqedonisë" – 10 kompozime në vjet dhe
- 8) "kompozime për fëmijë" 50 kompozime në vjet.

Gjatë zgjedhjes për financim të kompozimeve mbahet llogari për përfaqësimin përkatës dhe të drejtë të bashkësive të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

Konkurs për krijim të kompozimeve të reja

Të drejtë për pjesëmarrje në konkurs

Të drejtë për pjesëmarrje në konkurs të këtij ligji ka realizuesi – shtetas i Republikës së Maqedonisë, me kompozim të krijuar nga autorë shtetas të Republikës së Maqedonisë, ndërsa i cili nuk është realizuar më herët publikisht.

Realizuesi në konkurs dorëzon kërkesë e cila përmban të dhënat në vijim për:

- A) realizuesin:
- emri dhe mbiemri i realizuesit,
 - adresa dhe
 - telefoni/celulari/posta elektronike;
- B) autorët e kompozimit:
- emri dhe mbiemri i autorit të muzikës,
 - emri dhe mbiemri i autorit të tekstit dhe
 - emri dhe mbiemri i autorit të aranzhmanit;
- C) producent i zërit dhe për producentin e videos:
- emri dhe selia e producentit dhe
 - emri dhe mbiemri i personit përgjegjës në subjektin juridik;
- Ç) kompozimi:
- zhanri i muzikës për të cilën shrohet kërkesa (muzika popullore dhe argëtuese) dhe
 - kohëzgjatja e kompozimit dhe
- D) kategoria për të cilën shrohet kërkesa.

Të drejtë për pjesëmarrje në konkurs në kategorinë "kompozime për fëmijë" ka një prej autorëve të kompozimit me kompozim i cili nuk është realizuar më herët publikisht.

Pjesëmarrësi i konkursit (realizuesi, gjegjësisht autori) si shtojcë të kërkesës dorëzon edhe dokumentacionin në vijim:

- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë për autor të muzikës, autor të tekstit dhe autor të aranzhmanit (në original ose kopje të vërtetuar në noter);

- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë për interpretuesin (në original ose kopje të vërtetuar në noter),
- certifikatë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë për veprimtarinë e regjistruar për producentin e audios dhe producentin e videos (në original ose kopje të vërtetuar në noter),

- para kontratë të lidhur ose kontratë me autorin e muzikës, autorin e tekstit, autorin e aranzhmanit, producentin e audios dhe producentin e videos së kompozimit për të cilën shtron kërkesë në konkurs. Nëse realizuesi është autor i muzikës, gjegjësisht autor i tekstit, gjegjësisht autor i aranzhmanit, duhet të dorëzojë deklaratë se ai është autor i muzikës, gjegjësisht autor i tekstit, gjegjësisht autor i aranzhmanit,

- deklaratë nga autori i muzikës, autori i tekstit dhe autori i aranzhmanit se kompozimi i shtruar se nuk është publikuar më herët,

- kompozimi i shkruar në dy regjistra të pianos i shkruar me tekst harmonik dhe kopje identike të tekstit të shkruar në gjuhën maqedonase, me alfabet cirilik, gjegjësisht në gjuhën e bashkësive, si dhe demoincizim ose incizim final të kompozimit dhe

- për kategorinë "kompozime për fëmijë" duhet të dorëzohet edhe pëlqim me shkrim të më hershëm nga të gjithë anëtarët e ekipit autorial, gjegjësisht producentit të audios

- Deklaratë për besueshmëri të të dhënave (të vërtetuara në noter);

Realizuesi i cili konkurren në kategorinë "vje" në konkurs nuk dorëzon si shtojcë kompozim të shënuar në dy regjistra identik të pianos me tekst të shkruar harmonik dhe tre kopje identike të tekstit të shkruar në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik, gjegjësisht në gjuhën e bashkësive, si dhe demoincizim ose incizim final të kompozimit.

Një realizues mund të konkurrojë në konkurs në një kategori me numër të pakufizuar të kompozimeve.

Në konkurs nuk do të mbështeten kompozimet me tekste me të cilat promovohet gjuha e urrejtjes, shkelja e të drejtave të njeriut ose komplotohet përdorimi i drogës, alkoolit dhe bixhozit.

Për nevojat e vendosjes të komisionit realizuesi përveç dokumenteve të përmendura duhet të dorëzojë dokumente/të dhëna për plotësimin e kushtit të paraparë për kategorinë në të cilën aplikon si dhe dëshmi nga producenti i audios se e plotëson kushtin e paraparë në nenin 2 paragrafi 1 pika 6 nga ligji për mbështetje të produksionit për muzikë vendase.

Dokumentet jo të kompletuara dhe jo të plota nuk do të nënshtrohen shqyrtimit dhe vendimit të Komisionit.

Dokumentet e nevojshme për pjesëmarrje në konkurs të dorëzohen ose të dërgohen në adresën:

NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË

Bul. Goce Dellçev pn

1000 Shkup

(ME SHENJË) – "Pjesëmarrje në konkurs për krijim të kompozimeve të reja"

Në zarf theksohet kategoria për të cilën aplikohet.

(Për realizuesit të cilët do të dorëzojnë aplikacionet përmes arkivit të RTM, arkivi punon çdo ditë prej ora 8:00 deri në ora 16:00)

Më shumë informata për mënyrën e realizimit dhe financimit në Ligjin për mbështetje të produksionit muzikor të vendit në internet faqen e RTM www.mrt.com.mk



Republika e Maqedonisë
MINISTRIA E FINANCAVE
THIRRJE PUBLIKE

Të nderuar,

Ju informojmë që Ministria e financave konform përcaktimeve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për përkrahje të ekonomisë dhe mbajtjes së dialogut të vazhdueshëm me bashkësinë e biznesit në Republikën e Maqedonisë, organizon cikël të ri të takimeve me kompanitë dhe personat fizik të cilët kanë nevojë për ndihmë në procedurat e privatizimit të tokës ndërtimore në pronësi shtetërore. Në kuadër të këtij projekti, një numër i madh i kompanive me sukses e kanë mbaruar procedurën e privatizimit e me këtë vendi ku janë të vendosura kapacitet e tyre prodhuese dhe administrative tani është në pronësi të tyre.

Për këtë qëllim, u bëhet thirrje të gjithë personave fizik dhe juridik në Republikën e Maqedonisë që janë të interesuar dhe që kanë probleme të karakterit pronësoro-juridik, në periudhën prej 1 deri më 10 tetor të vitit 2017 të lajmërohen në Ministrinë e financave – Drejtoria për çështje pronësoro -juridike: tel. 02/3255-669 ose e-posta: maqdalena.babanovska@finance.gov.mk.

Me personat fizik dhe juridik që do të paraqiten do të realizohen takime në Drejtorinë për çështje pronësoro –juridike me qëllim të gjendjes së zgjidhjes së problemeve konkrete të karakterit pronësoro-juridik.

Me respekt,
Ministria e financave
Drejtoria për çështje pronësoro-juridike



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe
Planifikimit Hapësinor



Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për marrjen e A - lejes së integruar ekologjike për DPTU Buçim DOO – Radovish, Instalacioni për brejtjen e xeheve të bakrit dhe përfitimi i bakrit katodik.

Në përputhje me nenin 95 pika 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07,159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë nr. 11-12603/1 nga 31.12. 2013 për marrjen e A - lejes të integruar ekologjike.

Dorëzues i kërkesës: DPTU Buçim DOOEL – Radovish, Instalacioni për brejtjen e xeheve të bakrit dhe përfitimi i bakrit katodik.
rr. Sv. Spaso Radovishki pn, 2420 Radovish

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:

41°284430 N 22° 21570 E

Personi për kontakt: Sare Sarafiloski, ekolog
e-mail: s_sarafiloski2005@yahoo.com

Kategoria e instalacionit:

2. Prodhimi dhe përpunimi i metalite
2.5 a) Instalacione për prodhimin e metaleve me ngjyrë nga xehet, koncentratet ose lëndët e para minerale me procese metalurgjike, kimike ose me procese elektrolitike.
Kapaciteti i projektuar: 2800 t/vit

Lloji i aktivitetit:

Brejtja e xeheve të bakrit dhe përfitimi i bakrit katodik.
Kërkesa në formë të shtypur , do të jetë e ekspozuar , për shqyrtim për të interesuarit në **afat prej 15 ditëve** që nga dita e daljes së kësaj Shpallje në shtypin ditor, në lokalet e: Zyrës për komunikim me publikun pranë Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.
Kej Dimitar Vllahov nr. 4 , kati 1 (objekti i vjetër i Bankës Komerciale), 1000 Shkup.
Çdo ditë pune nga ora 10 – 16:00 dhe

Në hapësirat e **Komunës së Radovishit**, çdo ditë pune,
Në të njëjtën kohë kërkesa në formë elektronike do të jetë e vendosur edhe në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moepp.gov.mk

Të interesuarit informata më të detajuara në lidhje me kërkesën do të mund të marrin në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në tel. 076445 942 (e-mail n.aliti@moepp.gov.mk)


Të interesuarit në **afat prej 30 ditëve** që nga data e shpalljes së kërkesës, kanë të drejtë të parashtrijnë vërejtjet dhe komentet e tyre në formë të shkruar deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, bulevardi „ Goce Delçev „ nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10) ,1000 Shkup.



Vitet e arta të Shqipërisë

Kur transporti ajror ishte më i zhvilluar se ai rrugor

Në nëntor të vitit 1924 qeveria shqiptare nënshkruan një marrëveshje koncesioni 10 vjeçar me kompaninë gjermane "Lufthansa". Në bazë të kësaj marrëveshje u krijua shoqëria ajrore shqiptare me emrin "Adria Aero Lloyd"



Fillesat e aviacionit në Shqipëri janë të lidhura me organizimin ushtarak të vendit. Në ligjin e vitin 1920 për organizimin e forcave të armatosura përcaktohej se ushtria shqiptare ndahej në fuqi tokësore, detare dhe ajrore. Edhe pse fluturimet ajrore u përcaktuan me ligj si pjesë e forcave të armatosura, nuk mungojnë iniciativat për organizimin e transportit ajror civil. Në nëntor të vitit 1924 qeveria shqiptare nënshkruan një marrëveshje koncesioni 10 vjeçar me kompaninë gjermane "Lufthansa". Në bazë të kësaj marrëveshje u krijua shoqëria ajrore shqiptare me emrin "Adria Aero Lloyd". Nisja e zbatimit të kësaj marrëveshje

shoqërohet nga ndërtimi pak muaj më vonë i të fushës së parë në kryeqytet që do të përdorej për uljet dhe ngritjen e avionëve. Kjo fushë u ndërtua në zonën e Shallvareve, me sipërfaqe 400 me 200 metra dhe destinacionet e brendshme ishin Vlora e Shkodra.

3 vite pas nisjes së funksionimit, shoqëria "Adria Aero Lloyd" u ble prej zyrës së Aviacionit Civil të Trafikut të Ministrisë së Ajrit të Italisë. Kjo solli edhe zgjerimin e fluturimeve drejt qyteteve të tjera si Elbasani, Gjirokastra, Korça apo Peshkopia. Po ashtu, u hapën edhe linja ndërkombëtare me kryeqytetet më të rëndë-

sishme; Romën, Sofjen, Beogradin apo Podgoricën. Krahas zgjerimit të linjave të transportit ajror, në Tiranë nis të ndërtohet aeroporti në zonën e Laprakës.

Në fillim të viteve '30 rezultoi se në Shqipëri operonin rreth 40 avionë që përdoren për qëllime ushtarake por edhe për fluturime civile lokale dhe ndërkombëtare. Statistikat zyrtare të kësaj periudhe dëshmojnë një rritje progresive të numrit të fluturimeve civile, ku në vitin 1928 rezultojnë më shumë se 800 pasagjerë që kanë përdorur transportin ajror dhe në një periudhë 15 vjeçare numri i pasagjerëve arrinte në më shumë se 4 mijë.

Në vitet '30-'40 transporti ajror i brendshëm mori një hov të madh, lidhur kjo me faktin se u ndërtuan aerodrome thujtë në të gjitha qytetet kryesore. Në këtë periudhë, Shqipëria rezultoi si ndër vendet e rralla në botë që kishte më të zhvilluar transportin e brendshëm ajror sesa format e tjera të transportit.

Në raportin e Italisë për Shqipërinë në vitin 1940, jepen në mënyrë të detajuar linjat ajrore civile. Në kushtet e mangësive e vështirësive që paraqitej për transportin rrugor, tregtarët do të përdornin masivisht linjat ajrore të brendshme për të blerë e transportuar mallrat.

Linjat ajrore do të manaxhoheshin në këtë periudhë nga shoqëria italiane "Ala Littoria". Avionët që do të përdoren ishin për të gjithë qytetet me dy ose tre motorë, të markës Savoia-Marchetti dhe Breda, me kapacitet të vogël. Thujtë çdo ditë zhvilloheshin fluturime nga Tirana në qytete të tjera të vendit, ashtu sikurse edhe në qytetet e vendeve perëndimore. Interesant është fakti se fluturimet drejt qyteteve jashtë vendit nuk bëheshin vetëm nga Tirana por edhe nga qytete të vogla si Devolli, Peshkopia, Vlora apo Shkodra. Kjo lidhet me faktin se për linja të tilla kishte interes nga person-

eli Italian që punonte në kompanitë që shfrytëzonin pasuritë natyrore.

Transporti i pasagjerëve, i bagazheve dhe mallrave rregullohej nga direktiva e vitit 1933 për transportin ndërkombëtar dhe nga konventa e Varshavës e vitit 1929. Referuar këtyre rregullave, pasagjerët mund të transportonin bagazhe deri në 15 kilogramë. Për tejkalimin e kësaj peshe, paguanin një tarifë shtesë. Për fëmijët në moshën nën 3 vjeç duhej të paguhej 10 për qind e tarifës normale. Fëmijët e moshës 3 deri në 7 vjeç paguanin 50 për qind të tarifës normale.

Ndërkohë, linjat ajrore të kësaj periudhe ofronin edhe zbritje të çmimit në masën 50 për qind për senatorët, ministrat e shtetit e këshilltarët, sekretarët federalë, funksionarët e shtetit italian dhe shqiptar, prefektët, zyrtarët e forcave ushtarake italiane e shqiptare dhe familjet e tyre, gazetarët italianë, akademikët etj.

Po ashtu, kishte edhe zbritje të tjera të tarifës nga 30 në 10 për qind, në varësi të funksioneve të personave që udhëtonin. Në tarifën për fluturimet përfshihej edhe kostoja e sigurimit që arrinte në 100.000 lira italiane.

(SCAN)

Pesë anarkitë sipas Fan Nolit

(Pjesë nga fjalimi i mbajtur në Parlamentin e Shqipërisë në vitin 1924 por që tingëllon njësoj aktuale edhe sot)

Noli është nga ato figura komplekse që rrallë mund t'i kuptosh drejtë, pasi gjithmonë ka diçka të fshehur brenda çdo fjale. Në gjithë fjalimet që Noli ka mbajtur, është vlerësuar shumë realiteti që ai shpreh dhe mënyra e mendimit dhe perceptimit të tij.

Ndaj edhe sot do të flasim për një nga fjalimet e tij të mbajtur para Parlamentit të Shqipërisë në vitin 1924, ku tregon për pesë anarkitë që ka Shqipëria. Ja si shprehet ai:

"Në vendin tonë mbretëron konfuzioni i të pesë anarkive:

E PARA, ANARKIA FETARE: katër fe të ndryshme, që s'kanë zënë rrënjë në zemrën e një populli pagan.

E DYTA, ANARKIA SOCIALE: këtu s'ka as klasë bejlerësh, as klasë bujqësh, as klasë burxhoazie. Këtu bujku është më bej se beu, beu më bujk se bujku. Kini një shembull të bukur në Partinë Popullore, e cila mbahet sot në fuqi prej bejlerëve dhe oxhakët më të vjetër, kur anëtarët e kësaj partie lëvdohen që kanë shpëtuar prej bejlerëve.

E TRETA, ANARKIA MORALE: këtu qeni s'njeh të zotin; këtu karakteret lopësohen, qulloshen dhe ndërrojnë forma dita-ditën si në kaleidoskop. Këtu ambiciet janë pa fre e pa kufi. Këtu i padituri i di të gjitha dhe i pazoti është i zoti për të gjitha.

E KATËRTA, ANARKIA

PATRIOTIKE: këtu brenda në një ditë, si me magji, tradhëtori bëhet patriot dhe patrioti tradhëtor. Këtu shohim përpara syve tanë të kapardisen si patriot të mëdhenj, ata që kanë lëftuar për "harfet" e për flamurin e babës, që kanë djegur Shqipërinë e Mesme ose ata që janë puthur me andartët e i kanë ndihmuar për të shkreptuar anëmbanë Toskërinë; këtu, si më thoshte një mik, është më mirë të jetë njeriu tradhëtor e të shikojë interesin e tij e të jetë i sigurt që të nesërmen do të proklamohet patriot i madh.

E PESTA, ANARKIA IDEALEVE: këtu idealet janë të errëta, të shtrembëra e të mumifikuara të Fanarit e të Buharës përfiten e përleshën në një luftë për vdekje me idealet e gjalla, elegante dhe të ndritshme të Perëndimit; na mungojnë

vetëm idealet e antropofagëve. Po për të zënë vendin e tyre kemi kolltukofagët, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten me plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpushë, që mund t'i copëtosh, po jo t'i çqitësh nga trupi që kafshojnë e thëthijnë. Herodoti na tregon se në betejën navale të Selaminës, një athenian kapi një anije persiane me dorën e djathtë e s'e lëshonte gjersa ia prenë; ahëre e kapi me dorën e dorën e mëngjër; ia prenë edhe këtë; ahëre e kapi me dhëmbë dhe s'e lëshoi gjersa ia prenë kokën. Sikur të ngjallej Herodoti përsëri do të shikonte që kolltukofagët tanë janë më të fortë se ky trim legjendar i vjetërsisë greke. Që t'i çqitësh këta tanët nga kolltuku duhet t'u preç jo vetëm duart e kokën, po dhe këmbët e trupin..."





Ky ishull i vogël mban brenda vetes një objekt të madh. Në bregun e tij perëndimor ndodhet shpella e Kishës, e cila për formën e veçantë dhe të çuditshme, u quajt vend i shenjtë. Aty është ndërtuar një kishë e vjetër në shek. XIV

Anisa DEMIRAJ

Ndër pikat kryesore turistike në Shqipëri është edhe Liqeni i Prespës së Madhe, i cili vlerësohet për bukurinë natyrore që ka. Por është një vend akoma më i veçantë që ndodhet në mes të këtij liqeni të mrekullueshëm, ishulli Maligrad ose siç quhet ndryshe edhe ishulli i gjarpërinjve.

Ky ishull i vogël mban brenda vetes një objekt të madh. Në bregun e tij perëndimor ndodhet shpella e Kishës, e cila për formën e veçantë dhe të çuditshme, u quajt vend i shenjtë. Aty është ndërtuar një kishë e vjetër në shek. XIV.

Ajo është kisha e Shën Mërisë. Kisha është një nga monumentet më me vlerë të trashëgimisë kulturore. Në këtë ishull janë gjetur edhe objekte arkeologjike si tjegulla, kollona e kapitele që i përkasin një kishë paleokristiane, që mendohet të ketë qenë në pjesën e sipërme të liqenit.

Sipër këtij ishulli, ndodhen edhe rrënojat e vilës verore të Car Simeonit të shekullit XI. Kisha e Shën Mërisë është një themelimi i vjetër dhe ka shërbyer si qendër shpirtërore për prijësit shqiptarë. Mbishkrimet që gjenden në këtë kishë i përkasin periudhave të ndryshme të lidhura me historinë e këtij monumendi.

Kisha është krejt e veçantë, me cikle ikonografike dhe mbishkrime historike të viteve 1345 dhe 1369. Në murin perëndimor ka afreska të princërve Kezar Novakut, afreska të gruas së tij Kalia, dhe femrave Maria dhe Amirali.



20 vjet më vonë më 1389, princi Amirali Novaku ka lënë një mbishkrim në Kishën e Ristozit, pranë Korçës. Ikonografia kështu në shekullin e XIV paraqet figura laike dhe historike.

Pikturat e Maligradit i takojnë stilit të ri ikonografik të quajtur "stili paleolog", një rilindje artistike të ikonografisë bizantine. Këto piktura janë studiuar, por jo në mënyrë shteruese. Më tërthoqën vëmendjen disa skena, që dalin jashtë programit rigoroz ikonografik.

Për herë të parë zbulova se në gjoksin e disa figurave të shenjtoreve dhe profetëve kishte grumbuj fytyrash pa aurole në gjokset e tyre. Këto nuk e kam parë në asnjë kishë deri më sot. Jo larg kishës në faqen shkëm-

Atraksione turistike

Ishulli mistik i gjarpërinjve në mes të Prespës së Madhe



bore pashë pikturat në shkëmb, bërë me ngjyrë të kuqe, me anë të oksidit të hekurit.

Pikturat janë thjesht vizatime antropomorfe, në një stil ekspresiv, primitive, vendosur pa rregull, në mënyrë të çrregullt. Në

një faqe guri është pikturuar një figurë femërore: Shën Maria, e cila në dorën e djathtë mban një shkop mbi majën e të cilit është një fryt shege.

Pranë është figura e Krishtit fëmijë dhe një figurë burri me aureolë dhe

me mjekër. Një skemë tjetër tregon një figurë kalorësi mbi një kalë skematik në lëvizje, bien në sy edhe figura e një kryqi me dy boshte horizontale në boshtin vertikal, që mbaron me figurën e një peme të jetës.

Mbi kryqin është figura e Krishtit fëmijë. Dallohen edhe disa gërma si TE, mbase të emrit THEUS=ZOT. Ka një numër portretesh, si edhe disa figura kryqesh të brendashkruar nëpër rrrathë. Pashë afro 12 figu-



ra, por që e pamundur të ngriheshe më lart në shkëmbin e pikturuar.

Duket qartë që kjo faqe shkëmbore ka qenë e shenjtëruar si një tempull i hapur në natyrë, e shumë më vonë pranë u ngrit kisha. Pse ka ndodhur ky shenjtërim tek piktoret në shkëmb? Çfarë ka ndodhur? Stili primitive i skenave, me koka të mëdha e trupa të vegjël tregojnë origjinën e ikonografisë së krishterë.

Këto piktura ngajnë me afresket e katakombeve të shekujve IV-V të erës sonë. Ky zbulim është tepër i rëndësishëm dhe unikal në Shqipëri. Këto piktura primitive në shkëmb duhet të jenë para zyrtarizimit të fesë së krishterë nga Konstandini i Madh. Figura mashkullore me mjekër pranë Shën Marisë me Krishtin fëmijë duhet të përfaqësojnë një martir të krishterë, ndoshta martizuar në këtë ishull.

Sipas kronikës, më 22 maj 1016, princi i Dioklesës Gjon Vladimiri u vra nga cari Vladislav në një ishull të Prespës. Besoj pikërisht në Maligrad. Kjo shpjegon pse në shekullin e XIV, shenjtërimi i vendit bëhet më i rëndësishëm.

Kishte disa shpella, disa dru mani shekullore, fiq dhe trëndafila të egër. Mbi ishull janë gjurmët e një ndërtimi, kurse në anën veriore pashë një mur si edhe tulla bizantine të shekullit të VI. Maligrad do të thotë "qytet i vogël". Por, në shekuj, ishulli ka qenë përgjithsisht i pabanuar, si edhe sot.

Zbulimi i pikturave paleokristiane të shkëmbinjtë e Maligradit është një ngjarje e madhe dhe e papritur historike dhe e artit. Shqipërisë i shtohet kështu një motiv i ri i lashtësisë dhe fillimit të Mesjetës. Ky zbulim është i një rëndësie në rrafsh evropian.

Ishulli ka gjatësi rreth 800 metra e gjerësi rreth 200 metra dhe rrethohet nga shpate shumë të pjerrët, me përjashtim të pjesës perëndimore të tij. Në këtë ishull ka bimësi natyrore barishtore dhe shumë pak shkurre, shpella e zgavra karstike.

Prej kohësh, banorët e zonës së Prespës shkojnë aty me varka për të kryer shërbesa e rite fetare. Ishulli nuk është i banuar, por popullohet në sezonin veror nga turistët e shumtë kurioz të historisë dhe kulturës vendase. Mund të vizitohet duke ndjekur itinerarin Korçë - Zvezdë - Liqenas.



Dr. Blerim REKA

Ballkani i ndarë: nga lufta e ftohtë në paqe të nxehtë

Në vitet e fundit marrëdhëniet midis Perëndimit dhe Rusisë janë të tendosura, në veçanti pas aneksimit të Krimesë nga ana e Rusisë, luftës në Ukrainën Lindore dhe së fundi me vendosjen e pranisë së përhershme ushtarake ruse në Siri. Gjetja e bazës së përbashkët për të bashkëpunuar në mes të Perëndimit dhe Rusisë po bëhet e vështirë, në situatën e marrëdhënies të tyre më të ashpra dypalëshe, veçanërisht pas sanksioneve të reja amerikane kundër Rusisë në fillim të gushtit dhe vazhdimin të atyre të BE-së në fillim të shtatorit të këtij viti. Megjithatë dikush do ta quante situatën aktuale si: 'Lufta e re e ftohtë', do të ishte më e arsyeshme që ky konflikt i ripërtërirë gjeopolitik i interesit do të mund të quhej Paqe e nxehtë.

Në kontekstin më të gjerë gjeopolitik, situata tregon gjithnjë e më shumë kthimin e frymës së luftës së ftohtë. Në vitin 2017, të dyja kampet e ish-luftës së ftohtë vazhduan luftën e tyre nëpërmjet stërvitjeve ushtarake në Evropë. Stërvitja

Gjetja e bazës së përbashkët për të bashkëpunuar në mes të Perëndimit dhe Rusisë po bëhet e vështirë, në situatën e marrëdhënies të tyre më të ashpra dypalëshe, veçanërisht pas sanksioneve të reja amerikane kundër Rusisë në fillim të gushtit dhe vazhdimin të atyre të BE-së në fillim të shtatorit të këtij viti

e NATO-s në korrik 2017 mbledhi 25 000 ushtarë në: Hungari, Rumani dhe Bullgari; për të mos përmendur një stërvitje në Krivolak (Maqedoni) ku morën pjesë edhe ushtarë nga disa vende të Ballkanit Perëndimor. Në anën tjetër, Rusia, në shtator, u përgjigj me një stërvitje "Zapad" me 100 000 ushtarë, më e madhja që nga fundi i luftës së ftohtë.

Këto përplasje globale mes Uashingtonit dhe Moskës kishin efektet e saj edhe në Ballkanin Perëndimor. Strategjia e Putinit

për ndarjen e BE-së u zgjerua edhe në Ballkanin Perëndimor, duke e bërë ndarjen midis vendeve të Ballkanit në mënyrë strategjike në dy pjesë:

1. Një: vendet pro perëndimore "Ballkani i Adriatikut", (me: Shqipërinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë); dhe të tjerë

2. Vendet pro-Rusi Danubi Ballkanik, (me: Serbinë dhe Republikën Serbe).

Bosnjë e Hercegovina mbetet në një bllokim gjeostrategjik për shkak të vetos të Presidencës Federale të Serbisë në fushën e punëve të jashtme, të cilat përfshijnë vendimin për t'u bashkuar me NATO-n apo jo.

Kjo ndarje u pa edhe nga qytetarët e tyre. Mbështetja publike për NATO-n ndryshon nga vendi në vend në Ballkanin Perëndimor. Mbështetja më e madhe për NATO-n u shënuar në Kosovë (90 %) dhe në Shqipëri (rreth 80 %); dhe më e ulëta në Serbi (3 %).

Zhvillimet dramatike para dhe gjatë zgjedhjeve

në Malin e Zi në vitin 2016 dhe së fundmi në 2017 në Maqedoni, na tregojnë sa përfshirje ruse në pengimin e këtyre vendeve nga integrimi euroatlantik ishte lojë e rrezikshme.

MPJ-ja ruse e ministrit Lavrov që nga viti 2014 po përsërit që "pranimi i vendeve të Ballkanit në NATO është një provokim për Rusinë". Ambasadori rus në BE, Chizov, shkoi me tej duke thënë se: "për Maqedoninë BE-ja dhe NATO-ja nuk janë e vetmja alternativë". Për këtë arsye, në vizitën e tij të parë në Ballkan, më 2 gusht 2017, zëvendëspresidenti i ShBA-së, Mike Pence, paralajmëroi publikisht për ndikimin rus në rajon dhe kërkoi vazhdimin e zbatimit të "Kartës ShBA-Adriatik" (2003) me të gjitha vendet e Ballkanit. Zëvendëspresidenti amerikan Pence tha: "Këtu në Ballkanin Perëndimor, Rusia ka punuar për ta destabilizuar rajonin, për t'i minuar demokracitë dhe për t'u ndarë ju".

Në Kongresin amerikan, në fillim të vitit 2017, u nis një iniciativë

legjislative në Senatën amerikan, i cili kërkoi kthimin e pranisë amerikane në rajon, me qëllim që ta parandalojë ndikimin rus. Prania më aktive e NATO-s në Ballkanin Perëndimor ishte për shkak të pranisë më aktive rajonale të Rusisë. Pas aneksimit të Osetisë Jugore dhe Abkhazisë nga Gjeorgjia (2008); dhe Krimesë (2014) nga Ukraina; Rusia në dekadën e fundit gjithashtu depërtoi në Ballkan. Përmes Serbisë, Rusia në Nish themloi "Qendrën humanitare" dhe përgatiti një tjetër sish në Vojvodinë. ShBA-ja paralajmëroi Beogradin të mos japë status diplomatik për këtë bazë ushtarake ruse. Përveç kësaj, në vitet e fundit Rusia dhe Serbia organizuan së bashku stërvitje ushtarake dhe Rusia shiti armë ushtarake dhe aeroplanë ushtarakë në Serbi, MIG-at e së cilës planifikohet të mbërrijnë në Beograd deri në fund të këtij viti.

Përpjekja e "grushtit të shtetit" në Malin e Zi në vitin 2016, dhe nata e përgjakshme në Parla-

mentin e Maqedonisë më 27 prill 2017, u zgjeruan së fundmi në përfshirjen e thellë të Rusisë në rajon. MPJ ruse e Sergej Lavrovit në vitet: 2015-2017, vazhdimi i përsëritjes së qëndrimit zyrtar të Moskës "kundër pranimin të vendeve të Ballkanit në NATO", e cila ishte e shqetësuar për liderët e BE-së dhe të ShBA-së. Kjo doktrinë e re "neutrale" e Rusisë kundër zgjerimit të NATO-s në Ballkan u kritikua nga udhëheqësit kryesorë të komunitetit euroatlantik. Siç e përmendi kancelaria Merkel, me të drejtë në Samitin e Triestes: "Stabiliteti politik në rajon do të thotë stabilitet politik për ne gjithashtu".

Liderët e BE-së zbuluan më në fund se: integrimi i Ballkanit Perëndimor në BE është një investim strategjik në paqe, demokraci, prosperitet, siguri dhe stabilitet të Evropës në tërësi. Për këtë arsye, NATO-ja duhet të jetë më e pranishme në rajon dhe rajoni duhet të integrohet në Aleancën e Atlantikut të Veriut. NATO-ja duhet t'i mbajë dyert e saj të hapura për vendet e Ballkanit, gjithashtu rajoni duhet të transformohet në mënyrë demokratike, duke formuar qeveri të përgjegjshme dhe duke shmangur përfshirjen strategjike "të huaj" vetëm në politikën e brendshme dhe në një kontekst më të gjerë të sigurisë rajonale.

(epoka e re)

Testi më i vështirë i Gjermanisë që pas vitit 1949



Constanze STELZENMÜLLER

Gjermania, vendi im: është një ditë e trishtë për ty, për mua dhe për demokratët në të gjithë Perëndimin. Në zgjedhjet të Gjermanisë, partia radikale e krahut të djathtë, AfD hyri për herë të parë në legjislaturën federale pas më shumë se gjysmë shekulli. Theme-luar në vitin 2013, AfD nuk arriti të kapërcente pragun në zgjedhjet e atij viti. Por tashmë ka marrë 13 për qind të votës, duke u bërë forca e tretë më e madhe në Bundestag. Palët qeverisëse të koalicionit të madh, kristian-demokratët e kancelares Merkel dhe social-demokratët e sfiduesit të saj, Martin Shulc u ndëshkuan të dyja brutalisht: Merkel përballet me rezul-

Ky është testi më i vështirë për demokracinë gjermane në brezin tim, ndoshta edhe në historinë e republikës së pas-luftës. Do të kërkojë përpjekje të mëdha, por unë besoj se institucionet dhe shoqëria jonë civile janë të fuqishme mjaftueshëm

tatin më të keq personal prej 33 për qind; partia simotër bavareze e CDU-së, CSU-ja dhe SPD-së morën rezultatit më të keq ndonjëherë që prej vitit 1949. Partitë e vogla, ndërkohe, përfituan të gjitha: liberalët u rikthyen pas një zbrapsje katërvjeçare dhe të Gjellbrit sikundër edhe partia e Majtë morën 9 për qind. Pjesëmarrja e votuesve, 77 për qind, ishte shumë më e lartë se katër vjet më parë - por kjo nuk ndihmoi partitë demokratike.

Kjo është një pauzë në historinë gjermane të pas-luftës. Në mandatin e saj të katërt, Merkel e dobësuar nuk do të ketë

zgjidhje tjetër përveçse të farkëtore me dhimbje një koalicion të paprecedent, prej trepalësh, midis CDU-së së saj, liberalëve dhe të Gjellbërve, pasi SPD e ka përjashtuar një koalicion të madh. Liberalët e kanë bërë të qartë se duan një politikë më kufizuese ndaj emigracionit dhe janë skeptikë ndaj integritetit të BE-së - një goditje edhe për presidentin e ri të Francës, Emmanuel Macron, i cili i kishte vendosur shpresat në rinovimin e partnershipit Paris-Berlin për të fuqizuar BE-në. Lideri i të Gjellbërve do të përballet me segmentin e majtë të partisë që më mirë të torturohet sesa të pranojë kompromis. Kështu që negociatat e formimit të qeverisë do zgjasin deri në dhjetor - me një Gjermani të kthyer nga vetja e plot konflikte që nuk do jetë pothuajse fare e pranishme në debatet ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, ky rezultat cakton skenën për betejën e pasardhësit të Merkelit në parti, një betejë e ashpër pushteti midis

kampit të saj të modernistëve të moderuar dhe atyre në parti që kërkojnë një drejtim shumë më konservativ. Kjo do të errësojë debatin politik gjerman, do të polarizojë vendin dhe me gjasa do të ndryshojë mjedisin politik brenda kësaj partie, përgjithnjë. E ardhmja e demokracisë sociale në Europë është më në dyshim se kurrë.

Vota e djeshme në vendin që për muaj mendohej se ishte barrikadë ndaj valës populiste, do të shihet si inkurajim për lëvizjet populiste që u dukën se e humbën tërheqjen në zgjedhjet e këtij viti në Holandë dhe në Francë, ashtu sikundër edhe nga "alt-right" në Shtetet e Bashkuara. Kremlini, propaganda zyrtare dhe jo-zyrtare e të cilit promovoi AfD-në, me gjasa është i gëzuar. Nuk duhet të kemi dyshime - AfD nuk është alternativë për asnjë demokrat. Është një parti që mbështetet tek trazirat dhe shkatërrimi. Ajo kërkon të ndajë konsensusin centrist të pas-luftës së vendit tim, an-

gazhimin e pasluftës për të mbajtur përgjegjësi për Luftën e Dytë Botërore dhe Holokaustin, dhe pajtimin me viktimat. Programi i saj është nacionalist, ksenofob, kundër integritetit evropian, kundër NATO-s, Perëndimit, muslimanëve dhe dukshëm pro-rus. Nuk arrij të mendoj sesi ndihen hebrenjtë, muslimanët dhe emigrantët sot në Gjermani.

E megjithatë, është e rëndësishme të shohim në shkaqet e sakta përse njerëzit votuan AfD-në. Gjermania nuk ka pasur sulme madhore terroriste, lulëzon në punësim të plotë dhe nga surpluset ekonomike, ndërsa fluksi i emigrantëve është dobësuar. Por, më shumë se dy të tretat e të anketuarve në exit-poll thanë se ishin të shqetësuar për terrorizmin, krimin dhe emigracionin, duke treguar se mbetet shqetësim i madh integrimi i më shumë se 1 milion refugjatëve që me gjasa do të qëndrojnë në Gjermani. Përkundër kësaj shifre, dy të tretat e votuesve të AfD

thanë se e kishin hedhur votën si akt proteste më shumë sesa për bindje. Kjo, flet trishtueshëm, për paftësinë e koalicionit të madh dhe të Merkelit për të qetësuar shqetësimin e gjermanëve të zakonshëm në lidhje me aftësinë e institucioneve dhe shoqërisë civile për ta përballuar këtë sfidë historike. AfD tërhoqi 1.2 milionë vota të reja, gjysmë milioni nga SPD dhe gati një milion nga CDU-ja. Pa dyshim, ky është testi më i vështirë për demokracinë gjermane në brezin tim, ndoshta edhe në historinë e republikës së pas-luftës. Do të kërkojë përpjekje të mëdha, por unë besoj se institucionet dhe shoqëria jonë civile janë të fuqishme mjaftueshëm. Ne i detyrohemi vetes për këtë, fqinjëve dhe aleatëve dhe gjithë demokratëve në mbarë botën.

(Constanze Stelzenmüller është zyrtare e lartë në Institutin Brookings dhe kontributore në faqen e opinionëve të gazetës "The Washington Post".)



Stanislaw STRASBURGER

Bota dhe BE nuk ishin aq në fokus të fushatës zgjedhore në Gjermani, sidomos tek fushata e Angela Merkelit. Krahasimi me votimet presidenciale në Francë, dhe temat e Macron të zhgënjën. Sikur partitë në Gjermani, donin që votuesit të besonin, se Gjermania mbetet provinciale. Kjo megjithëse, „kombi“ të cilin i referohen politikanët, me marshimin e globalizimit asnjë proces global nuk arrin ta zgjidhë në thelb vetëm. Ndryshe në vendlindjen time, Poloni.

Mediat polake u përqendruan në raportimin mbi fushatën zgjedhore në Gjermani kryesisht tek temat e politikës së jashtme. Interesi për zgjedhjet në Gjermani është i madh. Kështu radioja publike gjermane për herë të parë në votime, do të transmetojë drejtpërdrejt në dielën në mbrëmje për votimet. Por për çfarë interesohen votuesit polakë?

Europa ime: Ne rrotullohem në vend

Fushata zgjedhore në Gjermani u cilësua si pa nerv, pasi fituesja dihej. E megjithatë këto votime do të kenë pasoja të mëdha, si për Gjermaninë ashtu edhe për botën

Çështje të hapura

Qeveria nacional-konservatore e PiS në Varshavë ka ashpërsuar kursin kundrejt Berlinit nga viti 2015. Shumë vëzhgues shohin më shumë një politikë të diktuar nga koniunkturaturat e brendshme, se një strategji që synon sukses ndërkombëtar. Por në fakt sukcesi i opinionin polak, tregon, se shumë njerëz shohin arsye të caktuara për një strategji të tillë.

Ka një sërë çështjesh konkrete në marrëdhëniet gjermano-polake, temat europiane e botërore që duket se kanë nevojë të shpjegohen e sqarohen ende. Pala polake ndjehet

shpesh e pakuptuar. Këtu bën pjesë shembulli i marrëdhënies me Rusinë. Shumë polakë kanë frikë, pas zhvillimeve në konfliktin e Ukrainës. Kështu propozimi i Martin Schulz për tërheqje të armëve atomike amerikane nga Gjermania hasi madje në refuzimin edhe të qarqeve liberaleve të majta polake. Po i njëjti qëndrim mbahet për refuzimin e SPD-s dhe (Të Gjellbërve) për mosarritjen e buxhetit ushtarak.

Shembuj të tjerë: Ndryshimi i klimës, kthesa në motorët e automjeteve, gazsjellësi Nord Stream 2, marrëdhënia e përgjithshme BE-SHBA, pa harruar çështjen e refugjatëve. Pas këtyre aspekteve fshihet ajo që njihet si psikologji sociale.

Barra e së shkuarës

Fundverën e këtij viti Varshava ishte mbushur me pllakate që transportonin pamje drastike si „Gjermanët kanë vrrarë miliona polakë dhe kanë shkatërruar vendin tonë. Gjermanë, për këtë ju

duhet të paguani!“ Të formuluar në anglisht, posterat të krijonin përshtypjen, se e gjithë bota duhet të informohet për vuajtjen e polakëve dhe se fajtorët duheshin përmendur me emër. Spote të tilla gjendeshin në mediat sociale dhe fushata televizive.

Megjithë përpjekjet duket se përballja gjermano-polake me të shkuarën, me tmerret e Luftës së II Botërore të Gjermanisë hitleriane, ka dështuar në masë të madhe. Kujtimet për kampet e përqendrimin dhe shfarosjen, terrori i përditshëm dhe frika që ndjen shumë banorë polakë, janë një barrë e rëndë për shumë njerëz edhe sot. Kohët e fundit kësaj i shtohet edhe një ndjesi e mungesës së rikompensimit, kjo shihet në posterat që kërkojnë reparacione. Edhe pse e shkuara e pazbardhur, po keqpërdoret në mënyrë të manipuluar për politikën aktuale të kujtesës të qeverisë në Varshavë, kjo nuk do të thotë, se nuk ekziston

barra e së shkuarës, që sot godet.

Shteti nacional nuk është zgjidhja

Në një atmosferë të tillë i ndjekin njerëzit votimet në Gjermani. Frika nga AfD dhe lëvizjet e protestave të „të zemëruarve“, si edhe mungesa e besimit tek Martin Schulz dhe e gjithë SPD-ja, shpesh Angela Merkel shihet si zgjidhja më e mirë. Në një intervistë, ministri i Jashtëm polak, Witold Waszczykowski, u shpreh se BE është një „institution... që u jep vendeve anëtare instrumente të ndryshme për të realizuar interesat e tyre kombëtare dhe programet e tyre.“

E ja ku bëhet i qartë paradoksi: Të gjitha interesat „polake“ ndaj zgjedhjeve në Gjermani janë të një natyre globale. Si të tilla ato nuk mund të zgjidhen në mënyrë të veçuar. Në të njëjtën kohë mbështetja për një periudhë të re me Merkelin tregon një qëndrim vendnumëro në struktura e

qëndrime provinciale, thënë ndryshe të ngecura në mendimin nacional-politik.

Si mund të zgjidhet ky paradoks? Si europian i bindur, besoj, se duhet tejkaluar trashëgimia kombëtare, dhe shtetet nacionale si aktorë kryesorë të politikës europiane të zëvendësohen me institucionet supranacionale. Por për sa kohë nuk ka forca që angazhohen për këtë rrugë alternative, dhe të bindin votuesit, ne rrotullohem në vend. Madje në një qark të rrezikshëm, ku tensionet mes shteteve kombëtare në Europë vetëm mund të thellohen. Më shumë se kaq: Ka frikë, se tensionet nuk do mbeten vetëm në nivelin politik-diplomatik, por do të përfshijnë në orbitën e tyre shumë njerëz.

(Stanislaw Strasburger ka lindur në Varshavë, jeton në Berlin e Varshavë. Ai është shkrimtar dhe menaxher kulture. Vepra të tij janë „Fiksimi Liban“ dhe „Tregtari i historive“.)



Urtak HAMITI

(Jo)humaniteti i serbëve dhe i rusëve në Kosovë

Është një film i shkëlqyeshëm dhe tronditës nga regjisori i famshëm polak Andrzej Wajda, quhet „Katyn“ dhe ka qenë i nominuar për çmimin „Oskar“ në vitin 2008, por edhe ka fituar mbi 80 shpërblime të tjera. Motivi i filmit është ekzekutimi i mbi 20.000 oficerëve dhe intelektualëve polakë në vitin 1940 në pyjet e Rosisë Perëndimore pasi ishin arrestuar/mbledhur pas okupimit të Polonisë nga forcat ruse në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Ngjarja përcjell jetën e familjarëve të oficerëve dhe intelektualëve për vite derisa presin të kuptojnë se çka ka ndodhur me më të dashurit e tyre, ndërsa pamjet grafike të ekzekutimit janë krejt në fund të filmit. Në mënyrë të ndryshme, gati të gjithë familjarët vdesin. Nga pushteti pro rus që instalohet në Poloninë e pasluftës, nga kryengritja ndaj tij, nga pikëllimi. Pra, ndonëse gjenocidi/krimi është i përgjithshëm dhimbja dhe humbja janë individuale. Tema themelore e filmit është se një popull ndaj të cilit ushtrohet gjenocidi i organizuar për t'ia zhdukur më të mirët dhe më të mençurit e ka vështirë të ringrihet dhe të ringjallet.

Në Kosovë ka ndodhur

Babai i regjisorit Andrzej Wajda, Jakub Wajda, ishte njëri nga oficerët e pushkatuar në pyjet e Katinit. Wajda, në një prononcim pak para vdekjes për gazetën „Guardian“, kishte thënë se filmin e kishte bërë për të mos harruar, jo për t'u hakmarrë dhe për të treguar se humaniteti diku nuk ekziston

pothuajse e njëjta gjë, nëse jo edhe më keq sepse në vitet 1998 dhe 1999 serbët kanë vrrarë jo vetëm oficerët dhe intelektualët në mënyrë të organizuar, por edhe fëmijët. Dhe jo që nuk janë penduar dhe nuk kanë kërkuar falje, por kanë shpërndarë dhe vazhdojnë të shpërndajnë dekorata për këtë që kanë bërë. Pra, nuk jemi të vetmit që kemi përjetuar një gjenocid dhe, ndoshta, kjo ndjenjë është edhe një ngushëllim. Në Kosovë ishin së bashku atëherë edhe serbët, edhe rusët.

Tash së fundmi serbët dhe rusët përsëri janë vendosur së bashku të kthehen nën petkun e një iniciative humanitare. Drejtuesit e Zyrës për



Kosovën në Beograd njoftuan opinionin publik se kanë nënshkruar një marrëveshje me një OJQ që quhet „Misioni humanitar rus“ për të ndihmuar popullin serb në Kosovë. Një vështrim i veprimtarisë së kësaj organizate dhe strukturës së saj tregon se nuk janë fare joqeveritare, por edhe një degë më shumë e veprimtarisë politike të Rosisë në Serbi dhe në Ballkan, nga shumë të tilla që në vitet e fundit janë themeluar edhe në Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi. Lidhja e kësaj organizate me Ambasadën e Rosisë në Beograd është e drejtpërdrejtë dhe financimi bëhet

nga fondet që financojnë edhe „Qendrën Humanitare Serbo-Ruse“, e cila gjendet në Nish.

Kjo qëndër është veçanërisht e rëndësishme sepse ka qenë kontroverze që nga themelimi i saj në vitin 2012 pas marrëveshjes në mes të ministrit të Jashtëm të Serbisë Ivica Dačić dhe ministrit të Mbrojtjes së Rosisë Sergej Shoigu. Në këtë qëndër veprojnë një numër i shtetasve rusë dhe serbë. Statusin e saj e ka kontestuar Departamenti i Shtetit të SHBA-së, përkatësisht Hoyt Brian Yee, i ngarkuar me çështjet e Evropës dhe të Euro-Azisë, dhe Ambasada e SHBA-së në

Beograd, nga ambasadori Kyle Scot, sepse kanë dyshime të bazuara se veprimtaria e saj është e mbledhjes së informatave dhe e veprimtarive të ndryshme subversive. Thënë më thjesht, dyshimin e kanë se është qëndër spiunazhi e jo humanitare. Këtë e bazojnë edhe në faktin se Rusia këmbëngul që shtetasve të saj që punojnë në Qendër në Nish t'u njihet statusi dhe imuniteti diplomatik. Serbia këtë ende nuk e ka bërë sepse vazhdon të luajë politikën e dyfishtë të bashkëpunimit edhe me SHBA-në, edhe me Rusinë. Mirëpo, synimi i Serbisë duket se është të fusë në Kosovë iniciativa e grupimeve qeveritare dhe joqeveritare ruse për të komplikuar edhe më shumë situatën dhe për të pamundësuar jetën e shtetit të Kosovës dhe të shqiptarëve tani me një dimension të ri - duke bërë presion tek aleatët e tyre SHBA-së.

Kjo dëshmon se serbët, po edhe rusët, nuk e kanë ndërmend t'i ndërrojnë planet e tyre të para njëzet vjetëve dhe se për të mbrojtur popullin e Kosovës institucionet e saj, por edhe faktorët e tjerë joqeveritarë shqiptarë


duhet të jenë vigjilentë, koshientë dhe në radhë të parë veprues. Nuk mjaftojnë përkujtimet e aleatëve të udhëhequr nga SHBA-ja se qëllimet e serbëve dhe të rusëve nuk janë humanitare, por politike dhe janë përpjekje për të minuar progresin e arritur në Kosovë. Ata këtë e dinë. Nuk mjaftojnë as përkujtimet për shqiptarët e vrrarë nga serbët si formë e viktimitizimit të përditshëm mbrojtës. Nevojitet ringritje e shqiptarëve të Kosovës për të krijuar mekanizmat mbrojtës ushtarakë dhe diplomatikë për të mos lejuar rrezikun për popullin dhe për shtetin. Nevojitet rishikim i raporteve në mes të popujve, rishikim i asaj se deri kur ka arritur Kosova prejse është çliruar dhe pavarësuar, i asaj se çka ka fituar nga dialogu me serbët e Beogradit dhe rivlerësim i vetë shqiptarëve se a janë të mbrojtur sa duhet dhe sa është e rrezikuar e ardhmja e tyre dhe e shtetit të tyre - Kosovës.

Dhe në fund, babai i regjisorit Andrzej Wajda, Jakub Wajda, ishte njëri nga oficerët e pushkatuar në pyjet e Katinit. Wajda, në një prononcim pak para vdekjes për gazetën „Guardian“, kishte thënë se filmin e kishte bërë për të mos harruar, jo për t'u hakmarrë dhe për të treguar se humaniteti diku nuk ekziston. Filmi „Katyn“ kurrë nuk është shfaqur në kinematë e Rosisë. Polakët kurrë nuk e kanë harruar krimin e Katinit edhe me të gjitha kërkimfaljet e rusëve.

(zëri)

XHELADIN MURATI, PROFESOR

DUHET TË NDRYSHOJMË PËR TË NDRYSHUAR FATIN



Është vështirë të flasim në pak rreshta për kontributin tim në formimin dhe arsimimin e mësuesve, si kuadër themelor për arsimin fillor. Megjithatë, është kënaqësi kur e shoh armatën e mësuesve të cilët me përkushtim punojnë në ngritjen e dijes, vetëdijes dhe vlerave të mirëfillta edukative-arsimore dhe japin kontributin e tyre në ndërtimin e gjeneratave që do të jenë bartëse të zhvillimeve demokratike

Koha Delvina KËRLUKU

Xheladin Murati u lind në Xhepçisht të Tetovës, jeton në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në Tetovë. Shkollën e mesme në Shkup, normalen "Zef Lush Marku". Studjoi pedagogjinë në filozofikun e Shkupit, magjistroi në pedagogji në filozofikun e Beogradit (1978) dhe doktoroi në filozofikun e Prishtinës (1984). Punoi si profesor në gjimnazin e Tetovës dhe ishte zëvendësrektor i tij, ishte profesor në Akademinë Pedagogjike në Shkup ku ligjëroi lëndën Metodika e matematikës kl.I-IV dhe Metodika e dituri shoqërisë, drejtor i Entit Pedagogjik të Tetovës (prej ku e shkarkon komiteti i LKM-së me motivacion se ka vepruar nga pozitat e nacionalizmit shqiptar, irredentizmit dhe separatizmit) dhe dhunshëm punoi në Qendrën për Punë Sociale në Tetovë. Në zgjedhjet e para parlamentare pluraliste, në dy mandate zgjidhet deputet në Parlamentin e Maqedonisë dhe nënkryetar i Parlamentit (1991-1994, 1994-1998), në 1992 zgjidhet docent në Fakultetin Filozofik të Shkupit për lëndën Hyrje në pedagogji, më 1995 me themelimin e Fakultetit Pedagogjik të Shkupit zgjidhet profesor inordinar e më pas ordinar për lëndët Pedagogji e përgjithshme, Metodologji e kërkimit shkencor dhe Didaktikë. Me themelimin e UEJL-së (2001) në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit ka ligjëruar lëndët Teknika e komunikimit, Metodologji e mësimdhënies dhe Ndryshimi i arsimtarit dhe ndryshimet në shkollë (në studimet deridiplomike) ndërsa në studimet pasuniversitare ligjëroi lëndët Sigurimi i cilësisë në arsim dhe Metodologji e kërkimit shkencor. Në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës ligjëroi lëndët

Tendencat evropiane në arsim dhe Teoritë bashkëkohore në edukim (në studimet pasuniversitare). Është anëtarë i shumë shoqatave. Ka botuar 33 vepra nga të cilat 28 janë nga fusha e pedagogjisë, metodologjisë e didaktikës. Ka mbi 276 njësi bibliografike nëpër revista, gazeta e përmbledhje dhe ka marr pjesë në mbi 92 konferenca shkencore, kongrese e simpoziume. Për Xheladin Muratin janë botuar dy studime. I pari, monografi me titull "Profesor, politikan dhe studiues pedagogjike" (2009), me autor mr. Ismet Jonuzi Krosi, dhe i dyti, studim me titull "Krijimtaria, kontributi dhe vlerat pedagogjike të profesor Xheladin Muratit" (2017) me autore mr. Ixhrije Aziri.

KOHA: I nderuar z Murati, jeni një ndër profesorët që keni dhënë mësim mbi metodologjinë e arsimit dhe keni nxjerrë gjenerata mësuesish. Çfarë flet ky kontribut me dekada të tërë?

MURATI: Unë kam ligjëruar më shumë lëndë, por tri ishin themeloret: Pedagogjia e përgjithshme, Didaktika dhe Metodologjia e kërkimit shkencor. Është vështirë të flasim në pak rreshta për kontributin tim në formimin dhe arsimimin e mësuesve, si kuadër themelor për arsimin fillor. Megjithatë, është kënaqësi kur e shoh armatën e mësuesve të cilët me përkushtim punojnë në ngritjen e dijes, vetëdijes dhe vlerave të mirëfillta edukative-arsimore dhe japin kontributin e tyre në ndërtimin e gjeneratave që do të jenë bartëse të zhvillimeve demokratike.

KOHA: Keni qenë pjesë e Parlamentit të Maqedonisë. Cili ishte zëri juaj, atëbotë?

MURATI: Gjenerata ime e deputetëve në parlamentin e Maqedonisë dhe unë bashkë me to, kanë qenë partizanët e

demokracisë. Viti 1991 ishte kthesë radikale e zhvillimit të shoqërisë tonë nga sistemi monist në atë pluralist. Megjithatë, demokracia jo vetëm ngadalë por me shumë vështirësi depërton në shoqërinë tonë. Sot e kësaj dite plot 27 vjet flasim për tranzicion e kurrësesi ta tejkalojmë atë. Zëri ynë në legjislaturën e parë parlamentare ka qenë vërtetë zë demokracie, zë i dijes, zë i vlerave, zë i qasjeve ndaj problemeve me të cilat përballej popullata shqiptare prej viteve. Por, ai zë nuk haste në mirëkuptim tek pala maqedonase, mbase ato mendonin se ua prishim apo ua vjedhim shtetin. Ne nuk kemi pasur qëllim të tillë. Kam bindjen se ai zë, zëri i 23 deputetëve të PPD-së sot e kësaj dite tingëllon në veshët e qytetarit. Deputetët që ia hapën rrugën demokracisë në Maqedoni, këta të PPD-së nuk ishin mendjemdhënij dhe as injorant, kishin energji dhe forcë pozitive për të ndryshuar gjendjen. Ata thjesht ishin modest dhe të sinqertë. Konstelacioni i forcave politike në kornizën gjeostrategjike ishin pengesë për realizimin e strategjisë tonë kombëtare.

KOHA: Është i padiskutueshëm popullariteti juaj si në skenën politike ashtu edhe në atë shkencore profesionale. Si e ndërlidhet politikën me pedagogjinë?

MURATI: Është çështje për diskutim. Politika nuk ka qenë fillimisht fushë e ime veprimi. Angazhimet e mia si student në shkolla verore që organizonte universiteti hapi dritare për këtë. Megjithatë, instalimi i demokracisë, them demokracisë së vonuar në shoqërinë tonë hapi shtigje dhe rrugë për pjesëmarrje aktive me politikën. Por, duhet të them se procesin mësimor si politikan nuk e kam lënë anësh, kam qenë paralelisht politikan dhe ligjërues në uni-

versitet. Kjo ishte një ndërlidhje funksionale sepse pedagogjia ka si objekt edukimin e njeriut, kurse politika njeriun e ka protagonist të saj dhe pikërisht për këtë njeriu duhet të edukohet të merret me politikë. Sepse politika do njerëz me tru, jo njerëz me tru hu. Fushëveprimi politik nuk më pengoi të merrem me krijimtari, me studime, me botime librash, me student etj.

KOHA: Megjithatë, a do të ishte Xheladin Murati ai që është sot po të mos ishte politikan?

MURATI: Me siguri po. Nuk pashë hajr prej politikës, nuk dija të gënjej, të mashtroj, të premtoj gjëra të pamundshme, nuk merresha me tendera, atëherë kotë me politikë. Megjithatë isha pjesë e politikës dhe e profesionit tim. Politika është sot për nesër. Pedagogjia është e përhershme. Isha pjesë e të parës, në të dytën mbetem përgjithmonë. Trendet dhe dinamika zhvillimore imponojnë ndryshimin shumë të shpejt të jetës dhe ne duhet të ndryshojmë për të ndryshuar fatin.

KOHA: Mësuesit kanë përgjegjësinë për të edukuar brezin e ardhshëm; ata luajnë rol kryesor në procesin e mësimdhënies dhe në arritjet e nxënësve. Po sot ata kanë role dhe përgjegjësi të shumta: mësimdhënës, administratorë, vëzhgues, këshilltarë, etj? Cili duhet të jetë roli i mësuesit?

MURATI: Është një fakt i pamohuar se roli i mësuesit sot ka ndryshuar shumë nga më parë. Ai realizon detyra e role të shumta sekondare, të cilat e largojnë nga misioni themelor: edukim dhe arsimim të nxënësit. Ai në fakt, siç konstatoim edhe ju merret me shumë me administratë se sa me punë mësimore. Kjo gjendje duhet ndryshuar dhe mësuesi të jetë edukator, këshilldhënës, tran-

smetues i dijeve, bashkëpunëtor, moderator i mësimi, drejtues metodik, vlerësues, kultivues i vlerave etj. Ai bashkë me nxënësit ndanë ndjenjën dhe emocione, gëzime dhe trishtime, suksese dhe dështime. Prandaj meriton të respektohet, por duhet të ndryshoj për të ndryshuar jeta. Profesionin e mësuesisë kërkon pikësëpari shumë pasion dhe përkushtim. Por gjithaq kërkon edhe siç përmenda më lart, një prirje të natyrshme për punën e edukimit, ai është art për formimin e vlerave njerëzore tek brezi i ri. Mësuesi duhet të ketë autoritet dhe nuk duhet harruar se pa punën e tyre të çmuar, të aftë për të transmetuar dijet nuk mund të ketë komb të kulturuar e të arsimuar. Përgjegjësia në profesionin e mësuesisë është shumë e rëndësishme dhe arsyet janë të shumta duke u nis prej faktit se një mësues ka përgjegjësi në rend të parë për gjenerata nxënësish. Arsyeja tjetër është se mësuesia është profesion rezultatet e së cilës reflektojnë dhe lënë gjurmë në shoqëri dhe mësuesi duhet t'i ketë parasysh këto përgjegjësi para se të filloj të punoj.

KOHA: Maqedonia deri më tani ka marrë pjesë në shumë matje ndërkombëtare, me të cilat përcaktohet se ku është arsimiti në vendin tonë dhe si është procesi arsimor kundrejt shteteve të tjera, të cilat kanë arritur më të mëdha si dhe cilët janë faktorët, të cilët ndikojnë mbi arritjen e nxënësve. Rezultatet e nxënësve të këtyre hulumtimeve në Maqedoni janë nën mesatare. A na duhet ndryshime sistematike në procesin arsimor përme ndryshimit të ligjeve dhe akteve nënligjore?

MURATI: Vlerësoj se suksesi apo produktiviteti i dobët i nxënësve në Maqedoni paraqet një problem shumëdimensional dhe që kushtëzohet nga më shumë faktor. Motivimi i nxënësve, motivimi i arsimtarëve, mungesa e njohurive dhe aftësive të mjaftueshme menaxhuese, mosharmonizimi i shkathtësive të nxënësve që dalin nga kurrikulat dhe sistemi arsimor, mungesa e modernizimit të procesit të njohjes mësimore, mospërgatitja e mjaftueshme e nxënësve për testim ndërkombëtar, qasja tjetërfare e testit si metodologjik, didaktik e logjikë, dallimet në qasjet mësimore tek ne dhe shtetet e tjera, logjika tjetërfare e punës mësimore tek ne dhe jashtë vendit janë ndër faktorët kryesor që shkollat e Maqedonisë i rendisin të fundit në testimin ndërkombëtar PISA. Testi PISA është instrument për matjen e diturive dhe mundëson të shihet niveli arsimor nëpër shkolla. Ai shërben si indikator për cilësinë, barazinë dhe efikasitetin e sistemit arsimor. Përbajtjet e testit PISA fokusohen në tri elemente: në shkencë, lexim dhe matematikë. Pjesëmarrja në teste ndërkombëtare kërkon një qasje tjetër dhe fokusim konkret në përbajtje, metodologji dhe logjikën e punës mësimore. Dëgjoni se faji për suksesin e dobët nuk mund të kërkohet vetëm te arsimtarët por edhe te organizimi i sistemit arsimor.

KOHA: Studimi për cilësinë e arsimit do të jetë çelësi në sferën ku duhet të ketë përmirësim në zhvillimin e programeve shkollore, motivim, mësim dhe bashkëpunim në avancim?

MURATI: Cilësia në arsim është temë e kamotshme, por në

kushtet aktuale ka marrë dimensione të theksuara dhe kjo është mirë. Sepse cilësia e bën diferencën specifike të një shkolle, të një arsimtari, të një sistemi arsimor. Sot, për fat të keq tonin cilësia mungon, mungon shumë. Njerëz me fakultete e diploma ka shumë, dije pak. Koncepti diplomë pa dije duhet sa më shpejt të largohet sepse krijohet njerëz analfabet funksional. Cilësia ka dimensione dhe aspekte të shumta, për shembull cilësia e teksteve shkollore, cilësia e programeve mësimore, cilësia e mësimdhënies dhe teknologjive mësimore. Këto shtrojnë nevojën dhe arsyen për një reformë radikale në të gjitha aspektet. Por për këtë duhet një kusht, reformën ta realizojnë njerëz që dinë, njerëz profesionist e me kompetenca, jo njerëz partiak që nuk kanë as aftësi, as njohuri as edhe koncept se ç'duhet bërë. Është e sigurt, se nuk ka ecje përpara pa vlerën bazë e të qëndrueshme të arsimit ndaj të gjitha ndryshimeve, arsimit na jep identitetin si bazë e tërësisë së vlerave që garantojnë zhvillimin dhe perspektivën individuale dhe shoqërore.

KOHA:Një pjesë e nxënësve duan tekste, të cilat janë shkruar në gjuhë të kuptueshme, ndërsa një pjesë e tyre i perceptojnë se nuk janë shumë të qarta, se u janë stërngrakur me fakte ose se kanë shumë pak informacione. Cila është këshilla juaj, për planet mësimore?

MURATI: Praktika shkollore vërtetoi faktin se tekstet shkollore të nxënësve e kanë humbur vlerën. Ato nuk janë në funksion të mësimin dhe të zhvillimit të nxënësve sepse nuk janë në përputhje me kërkesat e programeve mësimore dhe së dyti, janë larg informacioneve konkrete e domethënëse. Në tekstet shkollore që nga klasa e parë ka përmbajtje të papërshtatshme, ka informacione të gabuara, madje edhe fyese, ka përmbajtje kundërthënëse. Të gjitha këto e bëjnë tekstin jociësor, jo funksional dhe të pasuksesshëm. Teknologjia e hartimit të teksteve kërkon njerëz me dije, me kompetenca pedagogjike e profesionale jo njerëz me politikë. Për momentin Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka ndërmarrë hapat e nevojshëm në ndryshimin e legjislacionit për hartimin e teksteve dhe bën përpjekje që të krijoj kushte për krijimin e teksteve cilësore dhe funksionale. Por për këtë duhet të krijoj mekanizma institucional e profesional të departizuar dhe të depolitizuar, përndryshe do të vendnumërojmë.

KOHA: Nëse do të bëni një dallim mes arsimit sot dhe të djeshëm, çfarë flasin këto dy periudha?

MURATI: Arsimit sot ka tendencë të jetë modern, të bashkëkohësohet, të futë qasje tjetër ndaj jetës, zhvillimit. Por këtu ndeshemi me zbatimin e projekteve që merren nga jashtë dhe zbatohen pa analiza të duhura që na largojnë nga realiteti. Arsimit dje ka qenë konzistent, cilësor, me premisa klasike. Është mësuar me programe të zgjeruara e të thella të cilat kanë ofruar dije e njohuri shumëdimensionale, me dominim të historicizmit, enciklopedizmit. Mendoj se dallimin në arsim duhet ta bën koha dhe cilësia. Programet duhet të mbështeten në disa faktor: në moshën e nxënësve, në kapacitetin intelektual dhe punues të nxënësit, në aftësitë zhvillimore, përndryshe bëhet gabim i dyfishtë kur nxënësi ngarkohet me përmbajtje mësimore, me lëndë mësimore, me orë mësimore. Strëngarkesa duhet të mënjanohet me studime.

KOHA: Nëse kthehemi në fëmijërinë tuaj, çfarë flet fëmijëria juaj, shkolla, mësuesit, shokët dhe shoqet?

MURATI: Fëmijëri me halle e derde, por kemi qenë modern, kemi shkruar me pantallona të grisura, e nëna i qepte. Tani mendoj se i paskemi paraprij modës. Shkolla ishte në Xhepcisht e mësuesi im i parë ka qenë Shefqet Vela dhe Nazmi Musliu. Klasat e larta të fillores i kam kryer në Tetovë në shkollën "Liria" të sodit. Isha nxënës i shkollës elitare të mësuesisë normalja e Shkupit "Zef Lush Marku" ku na dhanë mësim mësimdhënës të njohur që na shërbyen si model për punë mësimore, siç janë: Xhevat Gega e Mojsi Lutfiu, gjuhë shqipe, Abedin Krasniqi gjeografi, Rexhep Bajrami histori, Avni Zllatku kimi, Eshref Saraqini biologji, Marika Popova pedagogji dhe psikologji, Abdullah Ukshini metodikë, Spase Kunovski art figurativ, Syreja Imami dhe Nadire Krasniqi muzikë. Normalja na krijoi shumë shoqëri e miqasi. Po i përmendi disa nga shokët: Shaip Hajdari, Daut Karemani, Drita Ameti, Perihane Imami, Shpresa Lutfiu, Selami Vinca, Hasan Borova, Adem Bajrami, Qeram Telqiu, Irfan Marku, Safet Abazi, Besnik Spahiu dhe shumë të tjerë

KOHA: Më pastaj studimet, me çfarë përkushtim e djersë?

MURATI: Pas një viti si mësues, vazhdova studimet e pedagogjisë në Filozofikun e Shkupit. Studimet i kreu për 3

vjet (1969). Kam mbresa të fuqishme nga kolegët dhe profesorët dr. Vladimir Spasiq i metodikës, dr.Risto Gjorgjevski i psikologjisë, prof. Anatolij Damjanovski i didaktikës, prof. Lupço Koproovski i pedagogjisë së përgjithshme. Studimet pasuniversitare i kam kryer në Universitetin e Beogradit me profesor eminent dr. Nikolla Potkonjak i metodologjisë së kërkimit, dr. Jovan Gjorgjeviq i sistemeve dhe drejtimeve pedagogjike, dr. Vladeta Teshiq i historisë së pedagogjisë. Titullin magjistër e mora me mbrojtjen e temës "Shkaqet e ndryshimit të suksesit të nxënësit e klasave të para të shkollave të mesme në krahasim me suksesin nga shkollat fillore" (1978). Doktoraturën e kam kryer në Universitetin e Prishtinës me mbrojtjen e disertacionit "Pikëpamjet edukative - arsimore të Naim Frashërit dhe kontributi i tij në historinë e pedagogjisë kombëtare" (1984). Kam ndërrin të përmend profesorët e merituar që më lanë mbresa të mëdha dr. Jashar Rexhepagiq - mentor, dr. Fehmi Agani, dr. Hasan Mekuli, dr. Nijazi Azizi.

KOHA: Ju keni shpalosur shumë dilema të problemeve të arsimit, këtu bëhet fjalë për mësimdhënësit?

MURATI: Mësuesi, arsimtari është padyshim një artist i cili duhet të gjejë domethënien e edukimit të nxënësit, të njeriut, të fëmijës që rritet e zhvillohet. Në këtë kontekst ai ka nevojë gjithmonë të mësoj, ta përsos dijen dhe veprimin e tij pedagogjik. Prandaj ai i nënshtrohet reformave dhe ndryshimeve permanente, sepse duhet të ec në hap me kohën. Unë jam kundër angazhimeve formale të mësuesit me ngarkesa shtesë të cilat nuk janë në funksion të përparimit të mësimin. Mësuesi, arsimtari duhet të jetë personalitet dinamik, i pavarur, i zgjuar dhe me guxim, të ketë aftësi për organizim, udhëheqje dhe menaxhim me mësimdhënien, të jetë kreativ dhe me vetiniciativë, të ketë shkathtësi për planifikim dhe parashikim si dhe të ketë shumë ide dhe inovacione. Të gjitha këto e bëjnë ai të punon me përkushtim, përgjegjësi dhe kompetenca.

KOHA: Ju ishit pjesë e ekipeve për reforma në arsim. Çka ndodhi me to?

MURATI: Reforma e arsimit është proces i vazhdueshëm, por strategjia e reformave tek ne nuk shkon sipas ecurive shkencore. Ne fillimisht bëjmë reforma, mandej kthehemi i analizojmë dhe vlerësojmë gabimet. Metodologjia na mëson se fillimisht duhet të bëjmë analiza të

problemeve dhe aspekteve që prek reforma e mandej ta reformojmë arsimin. Kështu krijohet sistem stabil arsimor. Sistemi arsimor në Maqedoni ka pësuar ndryshime cilësore por jo të mjaftueshme, ka nevojë për ndryshime në favor të cilësisë, efikasitetit dhe modernizimit. Në fakt, une isha pjesë e ekipit për hartimin e strategjisë së arsimit në kohën e ministrit Gale Galev (2000). Dokumenti u hartua, por ministri u ndërrua dhe dokumenti u harrua. Ekipin që e formoi ministri Azis Pollozhani hartoi një dokument të gjerë e gjithëpërfshirës si "Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015" (2005), mbeti si dokument pa analiza se a u arrit diçka ose jo. Isha po ashtu pjesë e ekipit të ministrit Sulejman Rushiti për hartimin e konceptit mbi arsimin fillor nëntëvjeçar (2007) dhe ky projekt realizohet, por prej konceptit themelor kanë pësuar shumë ndryshime, të cilat reflektojnë në angazhimin e tepërt të nxënësve me lëndë mësimore, me orë mësimore si dhe e arsimtarëve me aktivitete të ndryshme.

KOHA: Hipotetike: Mund të bëni ndryshime. Çfarë reforma do të kishit bërë në sistemin arsimor?

MURATI: Reforma e arsimit në Maqedoni është një sfidë moderne e vështirë dhe e vetmja shpresë që gjërat të marrin të mbarën. Esenca dhe tendenca e reformës arsimore është orientimi i arsimit drejt afirmimit të vlerave bashkëkohore, proceseve moderne, inovacioneve dhe braktisjen e vlerave të vjetruara, gjithmonë në emër të së ardhmes. Arsimit dhe shkolla të përshtatet me ndryshimet dhe arsimi të jetë i specializuar, të aftësoj individin për jetë e profesion. Korniza e reformës, mendoj se duhet të përfshij disa segmente e aspekte, ndër të cilat po i veçoj: ndërtim të sistemit arsimor stabil dhe konzistent, funksional me mision konkret e adaptibil me nevojat shoqërore, në qendër të sistemit të jetë nxënësi dhe kurrikula. Kurrikula është shtylla dhe baza e çdo reforme sepse nga kjo varet çka presim prej nxënësit, sa duhet të jetë i ngarkuar, çfarë lëndësh të mësohen e të ngjashme, mësimdhënja të mbështet në teknologji dhe metodologji bashkëkohore, në shkollë të kthehet edukata, të sigurohet cilësia në arsim si element që bën diferencimin e vlerës, institucionet arsimore të ndërtojnë kapacitete pune mbi bazë të dijes, të dimensionohet numri i universiteteve publike dhe private - ato të funksionojnë mbi bazë të vlerave dhe nevojave, të rish-

qyrtohen vlerësimet interne dhe ekstere si dhe ato ndërkombëtare, shkollimi i mesëm të profilizohet sipas nevojave të tregut të punës, të forcohet roli i Byrosë për zhvillimin e arsimit me kompetenca pedagogjike zhvillimore dhe të quhet Ent për zhvillimin e arsimit, Inspektorati arsimor të merret me problemet ligjore e administrative jo me ato pedagogjike të shkollës, të modernizohet sistemi i vlerësimit të diturive të nxënësve dhe të përdoren mjete motivuese, të ndërtohet një institucion që do të merret me hartimin e kurrikulave si element më i rëndësishëm arsimor, zhvillimi profesional i arsimtarit të ridimensionohet, pozita dhe statusi social - ekonomik i arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional të ngrihet në nivelin e duhur e të merituar. Gjithashtu reforma duhet të zgjidhet edhe një problem me shumë interes. Në fakt kemi ngecje të madhe lidhur me mësimin teorik që duhet të shumë të mbështetet me praktikë më të madhe, dhe ky raport duhet të jetë proporcional me nivelin e aftësive dhe shkathtësive që u nevojiten nxënësve, studentëve në jetën praktike.

KOHA: Si ka evoluar puna juaj deri sot kur keni krijuar një brend tashmë të njohur për të gjithë?

MURATI: Përveç sfidave në risi, kreativitet dhe krijimtari puna ime është shquar për sfida menaxheriale. Kam qenë gjithmonë i dhënë pas kushteve optimale të punës kudo që kam punuar, si profesor, zëvendës drejtor gjimnazi, drejtor i Entit pedagogjik, profesor universitar e të ngjashme. Gjithnjë jam angazhuar për standarde të larta dhe punë profesionale kompetente. Frymëzimi im më i madh është vetë jeta, fakti që jam gjallë. Jeta është intriguese për trurin tim. Idetë i përdori sipas dëshirës sepse ato e bëjnë trurin të motivuar maksimalisht. Krijimtarinë shkencore-profesionale e kam përdorë si mjet komunikimi dhe thyerje barrierash.

KOHA: Dhe për fund një pyetje më të përgjithshme. Kaosi shoqëror e politik në shoqërinë tonë, por jo vetëm, janë gjithnjë tema diskutimi, cili është, sipas mendimit tuaj, roli i intelektualit në këtë aspekt?

MURATI: Roli i intelektualit në ndërtimin e shoqërisë, politikës dhe paqes është çështje dhe obligim themelor i tij. Në këtë proces të ndërlikuar, ai ndeshet me shqetësimin e dekadencës morale të të gjitha profilet dhe shtresat e njerëzve si te ata mistike dhe laikë, pacifist dhe militaristë, konservatorë dhe progresistë, realist dhe ëndërrimtarë, vetmitarë dhe të shoqërueshëm, egoist dhe altruistë, ekzistencialistë dhe pragmatistë, optimist dhe pesimistë e të ngjashëm.

Prandaj, intelektualit i vërtetë është në luftë të përhershme dhe, motivim për të qenë më mirë, për t'u ngjitur më lartë dhe për t'u ballafaquar me sfidat jetësore, ato shoqërore-politike dhe individuale. Ai, me pushtetin e dijes e kupton drejt zhvillimin e fenomeneve shoqërore dhe ligjshmëritë e zhvillimit. Si i tillë me sukses përballat me ndryshimet dhe tejkalimin e krizave shoqërore-politike me mjete e rrugë demokratike, pa dhunë e urretje. Intelektuali do ta luan rolin e tij të vërtetë nëse është objektiv, korrekt dhe i sinqertë, pa anime politike e partiake.





NATO e shqetësuar rreth planit për ushtrinë e Kosovës



NATO ka shprehur shqetësimin rreth propozimit për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura pa ndryshime kushtetuese dhe beson se lëvizje të tilla të njëanshme nuk janë të dobishme. Kështu shkruan e përditshmja serbe "Večernje Novosti", transmeton Klan Kosova. "Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu ia përcolli këtë mesazh direkt autoriteteve të Kosovës, ai gjithashtu iu bëri thirrje autoriteteve të Kosovës të qëndrojnë në kontakt të ngushtë me Beogradin. Pozicioni i NATO-s mbi këtë çështje nuk ka ndryshuar", thuhet në një përgjigje të zyrtarëve të NATO-s në Bruksel për këtë gazetë në pyetjen se cili është qëndrimi i Aleancës rreth planeve të Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi për ta transformuar FSK-në në Ushtri.

Demarkacioni si "bumerang" për Qeverinë Haradinaj

Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli u ka thënë zyrtarëve në Podgoricë se tash për ratifikimin i marrëveshjeve ekzistuese për shënjimin vijës kufitare është i pamundur për shkak të rrethanave politike dhe përbërjes së re të Kuvendit. Në këso rrethana, njohësit e zhvillimeve politike në Prishtinë thonë se Kosovës nuk i mbetet rrugë tjetër përveç ta respektojë marrëveshjen dypalëshe që është nënshkruar mes komisioneve të shteteve përkatëse



Kosovës po i pakësohen opsionet në lidhje me Demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, thonë analistët politikë. Sipas tyre, qëndrimi i përsëritur i Podgoricës se për Malin e Zi, Demarkacioni është çështje e mbyllur, i ka dhënë mesazhe të qarta Qeverisë së Kosovës se ratifikimi i Marrëveshjes aktuale, të nënshkruar qysh në gusht të vitit 2015, mbetet zgjidhja më e mirë. Por, ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli u ka thënë zyrtarëve në Podgoricë se tash për ratifikimin i marrëveshjeve ekzistuese për shënjimin vijës kufitare është i pamundur për shkak të rrethanave politike dhe përbërjes së re të Kuvendit. Në këso rrethana,

njohësit e zhvillimeve politike në Prishtinë thonë se Kosovës nuk i mbetet rrugë tjetër përveç ta respektojë marrëveshjen dypalëshe që është nënshkruar mes komisioneve të shteteve përkatëse. Politologu Ramush Tahiri, tha për Radion Evropë e Lirë se zhbërja e Marrëveshjes aktuale apo edhe dërgimi i saj në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit është e pamundur, pasi që pala malaziasë nuk do që të përfshihet në çështje. "Marrëveshja nuk mund të rinegociohet sepse nuk ka asnjë fakt të ri dhe nuk ka asnjë vërejtje të komisionit shtetëror. Kosova e ka bërë ndërrimin e komisionit që është në të drejtën e Kryeministrit. Por, Kosova, nuk mund t'i ndryshojë kriteret

e rinegocimit pa pasur pasojë dhe pa e ditur rezultatin", thotë Tahiri.

Tahiri thotë se Kosova, në këtë rast Qeveria e saj, duhet të sillet si subjekt i përgjegjshëm dhe të respektojë marrëveshjet ndërkombëtare dhe të mos ketë sjellje si parti politike. "Vetëm nga fakti se është ndryshuar partia politike në pushtet, prej të cilës vjen Kryeministri, nuk dërgohet çështja në arbitrazh. Këto janë çështje profesionale që Qeveria duhet t'i dijë. Pa pasur objekt kundërshtimi nuk dërgohet çështja në arbitrazh. Unë thjesht mendoj se Kosova po hynë në një rrugë pa krye, për shkak të synimeve politike dhe por i humb konditat shtetërore dhe respektin institucional dhe duhet të respektohen kriteret ligjore

dhe kushtetuese", tha Tahiri. Arbitrazhi ndërkombëtar për shënjimin e vijës kufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, sipas analistëve, mund të vijë në shprehje nëse institucionet e Kosovës dëshojnë përfundimisht që ta ratifikojnë në Kuvend Marrëveshjen për demarkacionin. Analisti Artan Muhaxhiri, thotë se Qeveria e re duhet të gjejë një zgjidhje të shpejtë për të dalë nga bllokimi i çështjes së Demarkacionit. "Opsioni më real mund të jetë edhe arbitrazhi, por nëse paraprakisht sigurohen të gjitha prerogativat ligjore dhe politike që një proces i tillë nuk do të jetë i dëmshëm për qytetarët e Kosovës dhe për agjendën evropiane të Kosovës", thotë ai. Muhaxhiri thotë se kryeministri

duhet të gjejë një zgjidhje reale e jo populiste dhe me kokëfortësi. "Zoti Haradinaj duhet të ballafaqohet me realitetin dhe ta kërkojë një zgjidhje e cila është realiste dhe praktike. Pra, nuk duhet të mbetet peng i qëndrimeve populiste deri sa ishte në opozitë, pasi është e kuptueshme se ato kanë qenë më të sforcuara se sa është dashur", tha Muhaxhiri. Ndryshe, komisioni i sapoemëruar shtetëror për shënjimin e vijës kufitare është në pritje të udhëzimeve dhe kompetencave nga Qeveria e Kosovës, në lidhje me çështjen e Demarkacionit me Malin e Zi. Kryesuesi i këtij komisioni, Shpejtim Bulliqi ka deklaruar për Radio Evropë e Lirë se komisioni i ri, si punë të parë do ta ketë shqyrtimin e Marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, por edhe do t'i analizojë të gjitha raportet që janë bërë deri më tash nga komisioni paraprak. Marrëveshja për demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi është nënshkruar në gusht të vitit 2015 në Vjenë. Kuvendi i Malit të Zi e ka ratifikuar këtë marrëveshje, ndërsa atë e ka kundërshtuar opozita e mëparshme në Kosovë, përfshirë edhe Ramush Haradinajn, i cili tash është kryeministër i Kosovës. Komisioni Evropian i ka vënë kusht Kosovës për liberalizimin e vizave, pikërisht ratifikimin Marrëveshjes për Demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

Tkurren lindjet, shtimi i shqiptarëve bie me 32.6%

Numri i lindjeve për tremujorin e dytë 2017, është 6.234, duke shënuar një rënie me 15,4 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Numri më i ulët i lindjeve regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, 83 lindje, me një rënie prej 36,6 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016



Shtesa natyrore e popullsisë për tremujorin e dytë 2017, pasqyron një rënie me 32,6 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016, sipas të dhënave të INSTAT. Gjatë tremujorit të dytë 2017, numri i lindjeve tejkaloi me 1.563 numrin e vdekjeve. Në tremujorin e dytë 2017, shtesa natyrore e

popullsisë për 12 qarqet e Shqipërisë, regjistron normën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 936 numrin e vdekjeve. Me shtesë natyrore të lartë paraqitet qarku i Durrësit me 216

lindje më shumë se vdekje, pasuar nga qarku i Dibrës me 199 lindje më shumë se vdekje. Në tremujorin e dytë 2017, shtesa natyrore regjistron vlerë negative vetëm në tre qarqe (Gjirokastrë, Vlorë

dhe Korçë). Vlera më e ulët është regjistruar në qarkun e Gjirokastrës dhe Vlorës, ku numri i vdekjeve tejkalon me 110 numrin e lindjeve.

- LINDJET. Numri i lindjeve për tremujorin e

dytë 2017, është 6.234, duke shënuar një rënie me 15,4 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Numri më i ulët i lindjeve regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, 83 lindje, me një rënie prej 36,6 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 2.013 lindje, të cilat shënojnë rënie me 8,8 % në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Të gjitha qarqet e vendit të lindjeve në tremujorin e dytë 2017, krahasuar me tremujorin e dytë 2016. Rënia më të madhe të numrit të lindjeve gjatë kësaj periudhe e paraqet qarku i Gjirokastrës me 36,6 % dhe qarku i Vlorës me 30,3 %.

- VDEKJET. Numri i vdekjeve për tremujorin e dytë 2017 rezultoi 4.671,

duke shënuar një rënie prej 7,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2016. Numri më i madh i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.077 vdekje, me një rënie prej 8,7 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Numri i vdekjeve është ulur pothuajse në çdo qark gjatë kësaj periudhe, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Përfundimisht bën qarku i Fierit ku numri i vdekjeve është rritur me 3,8 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Rënia më e madhe është regjistruar në qarkun e Lezhës me 25,5 %. Në tremujorin e dytë 2017, gjithashtu, me rënie më të madhe se 10,0 % të numrit të vdekjeve, paraqitet qarku i Dibrës me 13,2 % dhe qarku i Shkodrës me 12,8 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2016.



Izraeli po ashtu u dha mbështetje ushtarake kurdëve, përfshirë edhe trajnues, armatime anti-ajrore dhe një spital ushtarak, sipas të dhënave të Mosadit, në vitet 1970. Për Izraelin, mbështetja e Kurdistanit është një strategji afatgjatë dhe e vjetër e politikës së jashtme. Që prej kohës së kryeministrit të parë izraelit, David Ben-Gurion, vendi ka ndjekur atë që e quan "doktrinë periferike"

Kurdët thonë se nuk kanë miq përveç maleve. Tani ata kanë Izraelin, dhe kjo mund t'u sjellë zi... Flamujt izraelitë blu dhe të bardhë janë shndërruar në një pamje të zakonshme në kryeqytetin rajonal kurd, Irbil. Disa kurdë i valëvisin ata në makinat e tyre. Të tjerë i mbanin me entuziazëm në tubimet masive përpara referendumit të së hënës për pavarësi. Izraeli është bërë një avokat i zëshëm i pavarësisë kurde në referendum, dhe në një rajon ku flamujt izraelitë më së shumti shihen tek shkelen e digjen, imazhet e valëvitjes së tyre krijojnë përshtypje. Këta flamuj kanë furnizuar me argumente kundërshtarët e referendumit, të cilët thonë se ka një komplot izraelit për të ndarë Irakun. Proverba e vjetër kurde - që thotë se kurdët "nuk kanë miq përveç maleve" - u duk e përshtatshme përpara referendumit kur edhe miqtë e vjetër të Kurdistanit e kundërshtuan atë. Turqia, Irani dhe Iraku morën masa ndëshkuese. Shtetet

Miqësia me Izraelin mund t'u shkaktojë zi kurdëve



e Bashkuara apeluan shtyrjen e referendumit, që disa kurdë e kritikuan si një tradhti. Izraeli, megjithatë, shprehu mbështetje entuziaste. Historikisht Izraeli ka pasur lidhje të përzemërta me kurdët, në një rajon përgjithësisht armiqësor. Politikanët izraelitë thonë se ndjejnë një farë afërsie të natyrshme me kurdët, duke parë ngjashmëri të përpjekjet e tyre për të pasur një atdhe, përkundër gjithë gjasave kundër. Referendumi, megjithatë, ka hedhur dritë të re në këtë marrëdhënie, ose të paktën disa kurdë duken se po tregojnë ndjeshmëri ndaj kësaj ndjenje. Javën e ka-

luar, një burrë që po hyn-te në një tubim fushate në parkun qendror të Irbilit u ndalua nga policia që i konfiskoi një flamur izraelit që ai mbante. Oficeri i policisë e mbështolli me kujdes flamurin dhe e vendosi në makinën e tij. Pasi dha mbështetje publike në fillim të muajit, kryeministri Benjamin Netanjahu më pas instruktioi ministrit e vet të shmangnin komentet për referendumin. Në ditët e fundit para votimit, Barzani hodhi poshtë akuzat se referendumi do të krijonte një "Izrael të dytë" duke i quajtur ato "qesharake". Ky koment pasoi atë të ish-kryeministrit irakian, Nouri al-Ma-

liki, i cili tha se rajoni kurd do të bëhej një shtet sate-lit i Izraelit në Irakun ve-rrior. "Nuk do të pranojnë asnjë ndërhyrje izraelite në rajon, duarkryq", tha kle-riku shiit, Moqtada al-Sadr përmes një deklarate. Ga-zetat turke, ndërkohe, janë mbushur me teori konspi-rative që vënë në dukje se Barzani ka rënë dakord të riatdhesojë me qindra mijë hebrej në rajon. Marrëdhënia e Izraelit me kurdët ka rrënjë të thella. Hebrejtë e Kurdistanit e gjurmojnë trashëgiminë e tyre tek anëtarët e tribusë izraelite të Benjaminit, i cili arriti në zonë në shekullin e 8 përpara erës sonë. Sot, ka më shumë se 200 mijë

hebrej kurdë në Izrael. Në atë që pasoi e që në Irak njihet si "Farhud" - dhuna dhe plaçkitjet ndaj popull-sisë hebreje të vendit - kurdët luajtën rol kyç për të ndihmuar hebrejtë të arratisen në dekadat e më-vonshme. Familjet hebreje kanë rrëfyer sesi Masoud Barzani, tashmë presiden-ti i qeverisë rajonale të Kur-distanit, i kishte ndihmuar personalisht të largohen fshehtas përmes maleve. Izraeli po ashtu u dha mbështetje ushtarake kurdëve, përfshirë edhe trajnues, armatime anti-aj-rore dhe një spital ushta-rak, sipas të dhënave të Mosadit, në vitet 1970. Për Izraelin, mbështetja e Kur-distanit është një strategji afatgjatë dhe e vjetër e po-litikës së jashtme. Që prej kohës së kryeministrit të parë izraelit, David Ben-Gurion, vendi ka ndjekur atë që e quan "doktrinë pe-riferike". Izoluar në një rajon armiqsh, pas pavarë-simit në vitin 1948, Izraeli u përpoq të formojë alean-ca me popullsitë jo-arabe dhe minoritetet në Lindjen e Mesme. Fillimisht, kjo strategji përfshinte Iranin, por pas revolucionit Isla-mik të vitit 1979, Teherani i preu lidhjet me Izraelin. Tani, është Irani që Izraeli kërkon të përballojë.

"Ndërsa shtetet me kombë-si arabe po largohen, ne duhet të gjejmë aleatë, aleatë të qëndrueshëm", tha Gideon Saar, ish-mini-stër i Brendshëm ndërsa apelonte kryeministrin Ne-tanjahu të lobonte më shumë për çështjen kurde në takimet e tij me presi-dentin Trump. "Mund të shihet sesa shumë po inve-ston Irani në forca armiqë-sore në kufijtë tanë, kësh-tu që të kemi miq, për Izraelin, në rajon është ek-stremisht e rëndësishme", tha Saar, i cili u takua me një këshilltar të Barzanit kur lideri kurd vizitoi Iz-raelin në fillim të vitit dhe publikoi qëllimin për të mbajtur një referendum për pavarësinë. Izraeli po ashtu, ka mbajtur lidhje ekonomike me Kurdistana-n, duke blerë naftën kur-de pavarësisht kundërshti-meve nga qeveria qendrore e Irakut në Bagdad. Pak përpara votimit në referen-dum, një grup i vogël he-brenjsh kurdë u mblodhën në Jeruzalem për të tre-guar solidaritet me Kurdi-stanin, duke mbajtur fla-muj e duke kërcyer me daulle. "Ne duam t'i themi botës se kurdët në Izrael mbështesin kurdët në Kur-distan që kërkojnë shtet të pavarur", thanë përfaqë-sues të tyre. Por, ashtu si izraelitët, kurdët u dukën të izoluar në rajon ndërsa shkuan në votime. Iraku dhe Turqia kanë lënë të kuptohet se parashikojnë edhe veprime ushtarake. Turqia ka kërcënuar të ndërpresë rrugët e naftës së Kurdistanit, ndërsa shtervitje ushtarake të mëdha janë zhvilluar në kufijtë e rajonit. Ndërsa Irani ka ndaluar fluturi-met. (The Washington Post)

Nëse shpërthen luftë nukleare, ky është vendi më i sigurt në botë

Cili do të ishte vendi më i sigurt në botë nëse një luftë botërore nukleare do të shpërthente? Rusët duket se janë të bindur se Lufta e Tretë Botërore mund të ndodhë në çdo kohë, dhe për këtë, atje ka shumë kompani që kanë filluar të ndërtojnë bunkerë të mbushur me të gjitha gjërat esenciale që nevojiten për të mbijetuar. Megjithatë, ata të cilët mund të sigurojnë një bunker të tillë janë vetëm të pasurit. Sipas Quora, shumë përdorues pajtohen se Rusia dhe shumë vende evropiane së bashku me vendet amerikane, do të kthehen në një zonë radioaktive. Skenari do të ishte diçka e ngjashme me filmin 'World War Z', përveç zombieve dhe më shumë shkatërrim. Shumë përdorues të Quora drejtuan gishtin kah Zelanda e Re si një vend ideal për të jetuar pasi që është mjaftueshëm larg dhe është e vështirë që ndonjë ndikim nuklear të arrijë atë - kështu që askush nuk do të luftojë për të pasi që nuk ka rëndësi strategjike. Sipas Peter Baskerville, i cili është një mësues dhe një nga shkrimtarët më të mirë në Quora, Zelanda e Re është një nga vendet më të mira për të jetuar edhe në rast të ndonjë konflikti botëror nuklear. Sipas gazetës Guradian, Ishulli i Pashkëve është një nga vendet më të sigurta gjithashtu, edhe pse ndodhet në Paqësorin Jugor. Gjithashtu, sipas Guardian edhe Antarkti-da është një nga vendet më të sigurta në rast të ndonjë konflikti nuklear.

SHBA ul kufirin maksimal për pranimin e refugjatëve

Qeveria amerikane do të lejojë vitin e ardhshëm vetëm 45,000 refugjatë që të hyjnë në SHBA. Kjo është shifra më e ulët që nga hyrja në fuqi e një ligji mbi pranimin e refugjatëve 37 vjet më parë. Uashingtoni zyrtar paraqiti i paraqiti një propozim kongresit, sipas së cilit parashikohet që në vitin e ardhshëm fiskal në SHBA të lejohet të pranohet vetëm një maksimum refugjatësh, respektivisht 19.000 nga Afrika, 5.000 nga Azia Lindore, 2.000 nga Evropa dhe Azia Qendrore, 1.500 nga Amerika Latine dhe Karai-bet, dhe 17.500 nga Lindja e Mesme dhe Azia Jugore. Viti fiskal 2018 nis nga tetori 2017 deri në shtator 2018. "Siguria e popullsisë sonë



amerikane është shqetësimi ynë i parë", tha një zyrtar i qeverisë amerikane. Ne duhet të sigurohemi që tek ne të vijnë vetëm ata njerëz që nuk përbëjnë rrezik për sigurinë e vendit tonë". Në SHBA është e zakonshme që qeveria vendos një kufi maksimal vjetor për pranimin e refugjatëve. Kufiri më i ulët i

dekadave të fundit u vendos nga Presidenti Ronald Reagan në vitin 1986 dhe ishte 67.000 vetë. Gjatë kohës së ish-presidentit Barak Obama, në vitin 2016 kufiri ishte 110.000 refugjatë. Gjatë këtij viti, Shtetet e Bashkuara kanë pranuar deri tani rreth 54.000 refugjatë. Në vitin 2016 shifra

ishte 85.000. Për krahasim në Gjermani kanë kërkuar azil nga janari deri në gusht 2017 rreth 150.000 vetë. Kufizimi i qartë i numrit të refugjatëve në Shtetet e Bashkuara lidhet me politikën rigorozë ndaj emigrantëve të presidentit Donald Trump, të cilën ai e justifikon me mbrojtjen ndaj terrorizmit. Që nga qershori i këtij viti SHBA-ja ka vendosur ndërprerjen e plotë të pranimit të refugjatët. Por dekreti përkatës i presidentit Trump vlen për 120 ditë dhe përfundon më 24 tetor. Deri tani nuk është e qartë nëse qeveria amerikane dëshiron ta zgjasë këtë vendim të përkohshëm për disa javë ose për disa muaj të tjerë.

Schauble, kryetar i ri i parlamentit gjerman

Grupi parlamentar i CDU / CSU në Bundestagun gjerman do të propozojë për postin e kryetarit të parlamentit gjerman për legjislaturën e 19-të Wolfgang Schauble. Kështu u shpreh Volker Kauder, kryetar i këtij grupi parlamentar. "Ne jemi të kënaqur që Wolfgang Schäuble është shprehur i gatshëm të kandidojë për këtë detyrë". Njoftohet se

këtë gjë Schaubles ia kanë kërkuar kancelarja Angela Merkel dhe Volker Kauder, sepse për shkak të hyrjes së AfD-së në Bundestag, kjo detyrë do të ketë rëndësi më të madhe sesa zakonisht. Schauble është deputeti me vitet më të shumta si anëtar i parlamentit: ai është deputet për 45 vjetësh. Partia liberale FDP e konsideron përzgjedhjen e Schaubles për këtë detyrë të re, si sin-

jal për koalicionin "Xhamajka". Kryetari i kësaj partie Christian Lindner është shprehur që gjatë fushatës elektorale se synon postin e ministrit të Financave. Për këtë ai tha se i ka siguruar Kauderit mbështetje për kandidaturën e Wolfgang Schaubles. Edhe SPD-ja është dakord me kandidaturën e Wolfgang Schaubles. Drejtuesi i sapozgjedhur ekzekutiv i

grupit parlamentar të kësaj partie, Carsten Schneider, deklaroi se grupi parlamentar i SPD-së do ta mbështesë Schauble. Krerët e CDU/CSU-së thanë se prej përvojës së parlamenteve të landeve në të cilat është e përfaqësuar AfD-ja ato e dinë se kjo parti përdor me mjeshtëri mundësitë për të thyer tabutë e punës dhe të rregullave dhe për të tërhequr vëmendje mediatike.



Një pragmatiste e ftohtë dhe me një mendje prej shkencëtareje analitike, Merkel ka zhvilluar një stil lidhshipi që ka merituar foljen e vet: "Merkeln". Kjo do të thotë të fillosh rrugën, përpara se të marrësh një vendim të fortë

Etiketimi i Merkelit si udhëheqësja e re e botës së lirë mund të jetë i kuptueshëm në epokën e Brexit dhe Trump, por nuk arrin të marrë parasysh gjërat më pak të mëdha që kanë ndodhur në kohën e saj

Unioni kristian-demokrat në Gjermani nxori armët e rënda këtë javë, në prag të zgjedhjeve të së dielës: një fotografi bardhë e zi e Angela Merkelit kur ishte fëmijë, dhe shënimi: "Për një Gjermani ku cilido mund të bëhet ç'të dojë". Duke marrë parasysh që vajza në fotografi u rrit në Gjermaninë Lindore komuniste, për t'u bërë më pas një prej udhëheqësve më të fuqishme të botës, mesazhi është i vetëkuptueshëm. Gruaja e njohur si "Mutti", që do të thotë "Mami", për shkak të stilit të saj të palëkundur dhe pamjen prej "mami i di të gjitha", duket se i fton njerëzit të projektojnë mbi të, idetë e tyre për atë që ata mendojnë se është Merkel. Megjithatë, Merkel mbetet përjetësisht e vështirë për t'u zbërthyer. Për disa është një heroinë liberale, falë qasjes së saj ndaj krizës së refugjatëve apo sjelljes kundrejt udhëheqësve botërorë, si Donald Trump apo Vladimir Putin. Por nga ana tjetër, ajo është kundër martesave të homoseksualëve dhe ka miratuar një ndalim të burkës në të kaluarën. Kontradiktat janë bërë përrreth Merkelit.

Që nga koha e hershme, si vajza e pastorit protestant në Gjermaninë Lindore, ajo tani është kreu ekonomisë më të fortë të Evropës. Por ajo ende jeton në një apartament të thjeshtë në Berlinin qendror dhe vishet me të njëjtat rroba të zhubrosura, në pushimet vjetore kur del të bëjë ecje në mal. Ajo është një politikane që nuk ka hijeshi në podium, por sipas gazetarit të "Der Spiegel" Dirk Kurbjuveit, i cili e ka shoqëruar Merkelin në shumë udhëtime, në privatësi ajo mund të jetë e gëzueshme, e rrethuar me njerëz, e madje i lejon vetes të shpërthejë në të qeshura. "Të qenit e nënvlerësuar, gjithmonë e ka ndihmuar", thotë Tanit Koch, kryeredaktor i gazetës më të madhe të Gjermanisë, Bild. Shumë e kanë nënvlerësuar, për të keqen e tyre. Si për shembull, ish-kancelari Helmut Kohl, i cili e bëri Merkelin, vajzën e re dhe të turpshme, ministere të tij për gratë dhe të rinjtë në vitin 1991. Kohl e quante "vajza ime", por më vonë e quajti "vrasësja ime", pasi Merkel i dha fund karrierës së tij në vitin 1999, duke e denoncuar publikisht në një televizion kombëtar, pasi Kohl ishte kapur në një skandal të financimit të partisë.

Më pas ishte Vladimir Putini, i cili solli Labradorin e tij të madh e të zi në një takim me kancelarne, e cila është e tmerruar nga qentë. "Unë e kuptoj pse ai duhet ta bëjë këtë - për të provuar se është burrë", i tha

Një grua plot kontradikta përgatitet për mandatin e katërt

NË FILLIM KOHLI E QUANTE "VAJZA IME", NË FUND "VRASËSJA IME"



Merkeli më pas një grupi gazetarësh. "Ai ka frikë nga dobësia e tij". E lindur në korrik të vitit 1954, Merkel do të merrte doktoratën në kimi kuantike, para se të hynte në politikë në fillim të viteve 1990, pas rënies së Murit të Berlinit. Shumë kohë para se t'i duhej të ballafaqohej me të gjithë pushtetshmit e sotëm të botës, ajo do të zotëronte arenën politike shoviniste të Gjermanisë. Uniforma e saj e kostumeve serioze dhe këpucëve normale ka lindur kur ishte ministre e mjedisit: Merkel thoshte se njerëzit shihnin shumë këpucët e saj, në vend që të dëgjonin atë - kështu që ajo i hoqi veshjet nga ekucioni. Jeta familjare e Merkelit me bashkëshortin e saj të dytë, Joachim Sauer, është gjithashtu tmerrsisht private dhe është paraqitur në mënyrë të tillë, që të mos meritojë ndonjë vëmendje. Sauer, me të cilin ajo u martua në vitin 1998, është profesor i kimisë fizike dhe teorike që punon në Universitetin Humboldt në Berlin. Merkelit i pëlqen të gatuajë në shtëpi dhe nganjëherë "hidhet" në supermarketet lokale të Berlinit. Vendasit e lënë të qetë, tregtarët zakonisht refuzojnë të thonë se çfarë ka blerë.

Kancelarja liberale. Apo jo?

Mediat perëndimore shpesh e paraqesin Merkelin në rolin e liberales që anon majtas, edhe pse partia e saj CDU është një

parti e qendrës së djathtë. Vendimi i saj që Gjermania të pranonte mbi 1 milion refugjatë në kulmin e krizës së emigrantëve në vitin 2015, ndihmoi që shumë njerëz ta konsideronin një heroinë liberale. Shumë besuan se ishimi duke parë një Merkel të re, më emocionale, që do të dilte në pah për vlerat e saj humanitare. Ajo madje u propozua për një Çmim Nobël për Paqen, edhe pse prapa deryve të mbyllura thuhet se u lehtësua që nuk e fitoi. Kështu që mund të duket kontradiktore që në vitin 2010, ajo deklaroi se multikulturalizmi në Gjermani kishte "dështuar krejtësisht". Ajo gjithashtu refuzon ta identifikojë veten e saj, si feministe dhe votoi kundër martesës brenda të njëjtit seks këtë vit, sepse për të ajo ishte jokushtetuese.

Krizja e refugjatëve ishte e vetmja kohë që Merkel rrezikoi mirëqenien e saj politike, por sërish, i duhej ta bënte. Mijëra refugjatë të kthyer në kufirin gjerman do të kishin qenë një katastrofë politike për të. Që atëherë, përballë një vërshimi kritikash, ajo ka thënë se një fluks i tillë kurrë nuk mund të lejohet të ndodhë përsëri. Dhe po ndërmerr hapa për t'u siguruar që nuk do të ndodhë. Vitin e kaluar ajo orientoi një marrëveshje midis BE dhe Turqisë, në të cilën Turqia do të merrte miliardë në ndihma, në këmbim të frenimit të migrantëve

që kalojnë detin drejt Greqisë. Grupet e të drejtave të njeriut e sulmuan marrëveshjen si joetike, duke thënë se Turqia po i detyronte sirianët të kalonin kufirin në vendin e tyre të rrezikshëm. Por për Merkelin, politikisht, kjo marrëveshje, së bashku me mbylljen e "itinerarit të Ballkanit" në Evropë, gjithashtu qetësoi një rebelim të madh në radhët e partisë së saj, që pothuaj rrezikoi ta rrëzonte kancelaren.

Mbretëresha e kthesave 180 gradë

Një pragmatiste e ftohtë dhe me një mendje prej shkencëtareje analitike, Merkel ka zhvilluar një stil lidhshipi që ka merituar foljen e vet: "Merkeln". Kjo do të thotë të fillosh rrugën, përpara se të marrësh një vendim të fortë. Por kjo qasje e pritjes për të parë, dhe aftësia e mprehtë për të nuhatur humorin e kombit, i ka bërë punë gjatë 12 viteve të fundit. Në një intervistë të fundit në podium në një aktivitet të Handelsblatt, Merkel tha: "Asnjëherë mos u mundoni të ndryshoni mendjen e partnerit tuaj negociues ... por gjeni dhe shfrytëzoni hapësirën e luhatjeve, brenda mendimeve të tyre".

"Durimi është sekreti i suksesit të Merkelit," sipas Ralph Bollmann, autor i "Gjermanët, Angela Merkel dhe ne". "Ajo është shumë më e durueshme se çdo

politikan tjetër në Gjermani, në Evropë, në botë". Ajo ka një zakon që ua heq rivalëve nga duart, butonin e çështjeve të nxehta. Gjatë kësaj fushate zgjedhore, ajo rrëmbeu martesën e homoseksualëve nga Social Demokratët, rivalët e saj më të afërt, duke deklaruar papritur se duhet të hidhet në një votim parlamentar të ndërgjegjes dhe më pas i mbajti fort pas vetes konservatorët, duke votuar kundër saj. Kancelaria komplekse është një mjeshtre në përmbysjen e drejtimit. Ajo ka bërë një numër të madh kthesash të forta gjatë 12 vjetëve të saj në krye të qeverisë, ndoshta një arsye thelbësore për kontrollin e fortë të pushtetit. Ajo ishte pro energjisë bërthamore dhe pastaj papritmas, pas katastrofës nukleare të Fukushima, vendosi që Gjermania duhet të eliminojë energjinë bërthamore deri në vitin 2022. Ajo u kundërvu ndaj hedhjes së më shumë parave të shpëtimt për Greqinë, pastaj vendosi që Greqisë duhet t'i jepen më shumë para. Ajo tha se pushtimi i Irakut ishte i pashmangshëm në vitin 2003, por në vitin 2016 tha se ajo "nuk e mbështeste luftën në Irak".

"Një lëmsh me kontradikta është një mënyrë për ta përshkruar, krejtësisht pa parime, do të ishte një mënyrë tjetër", tha për Quartz Hans Kundnani, studiues në Fondin Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara. Ai e sheh pikëpamjen e Merkelit si udhëheqëse e botës së lirë, si pjesë e një tendence më të gjerë drejt "personalizimit të politikës ndërkombëtare", që nga zgjedhja e Trumpit.

Etiketimi i Merkelit si udhëheqësja e re e botës së lirë mund të jetë i kuptueshëm në epokën e Brexit dhe Trump, por nuk arrin të marrë parasysh gjërat më pak të mëdha që kanë ndodhur në kohën e saj. Skandali i emetimeve të Volksvagen, më i madhi në historinë e kohëve të fundit të korporatës gjermane, nuk u zbulua nga

mbikëqyrësit gjermanë, por nga SHBA. Zbulimet e fundit që jo vetëm Volksvagen, por të gjithë gjigantët kryesorë të automobilave të Gjermanisë kishin "ndrequr" emetimet e veturave të tyre, përsëri ka tërhequr vëmendjen, se sa e afuar është qeveria e saj, me industrinë e automobilave në vend. Po kështu, në temën e mjedisit, Merkel është quajtur "kancelaria e klimës" për mënyrën se si e ka udhëhequr tranzicionin e Gjermanisë drejt energjive të rinovueshme, "Energievunde". Megjithatë, vendi nuk do të arrijë objektivin e vet për të ulur emetimet e gazrave serrë me 40% deri në vitin 2020, falë kryesisht mbështetjes së saj të madhe ndaj linjtit dhe një industrie makinash që ka qenë qëllimisht e ngadaltë dhe arrogante, në zhvillimin e makinave elektrike.

Përsëri nuk e dimë se kush është ajo

Fjala "enigma" duket se është e duhura për të përshkruar Merkelin. Por po kështu do të ishin edhe fjalët makiaveliste, pragmatiste, e paparashikueshme. "Gjëja më e jashtëzakonshme për Merkelin është se ... nuk e dimë aspak se cila është ajo. Ajo është tërësisht e paqartë", thotë Kundnani. "Ajo ka një numër të vogël njerëzish rreth vetes, të cilëve u beson ... dhe kur këta njerëz flasin për mediat, ata ju tregojnë se çfarë duan që ju të mendoni për Merkelin, jo atë që ajo mendon".

Sa për atë që Merkel dëshiron, ëndrrat e saj? "Unë besoj se ëndrra e saj personale u bë realitet me rënien e Murit të Berlinit, që ka të bëjë me lirinë", thotë Kardeks Josef Janing, drejtor i Këshillit Evropian të Marrëdhënieve Brexit dhe Trump, por nuk arrin të marrë parasysh gjërat më pak të mëdha që kanë ndodhur në kohën e saj. Skandali i emetimeve të Volksvagen, më i madhi në historinë e kohëve të fundit të korporatës gjermane, nuk u zbulua nga

("Quartz - bota.al)





"Sindromi" i ri i Stokholmit

Suedia kërkon luftë me Putinin

Një nga skenarët e stërvitje i lë pak vend imagjinatës: një vend mik, i quajtur "Vendi A" (por ne mund ta quajmë Lituania, Estonia dhe Letonia), është i zënë në morskë; në veri dhe në jug të kufijve të vet, një komb armiqësor i quajtur "Vendi B" (por ne mund ta quajmë Rusia) kërcënon integritetin territorial të tij. Me shpërthimin e krizës dhe rrezikun që ndihma e mundshme ushtarake të mund të arrijnë në "Vendin A" nga territoret suedeze, "Vendi B" përpiqet që të pushtojë së pari ishullin e Gotland dhe territoret në jug të Stokholmit, për të siguruar superioritet në zonën baltike

Përgjatë kufijve lindorë të Evropës, ka vite të tërë që ziejnë provat ushtarake dhe shqetësimi: stërvitjet ndjekin një ritëm të qëndrueshëm rritjeje në të dy anët e kufirit. E fundit, e quajtur "Zapad 2017" (do të thotë "perëndim", sa për të sqaruar menjëherë qëllimet) sapo ka përfunduar në territoret perëndimore të Bjellorusisë dhe Rusisë dhe ka përfshirë rreth 12,000 ushtarë, 370 automjete të blinduara të llojeve të ndryshme, 150 pjesë të artilerisë dhe 40 avionë dhe helikopterë. Ky "zgjim" i Moskës, veçanërisht në kuadrin e krizës ukrainase për Donbass dhe "shtrëngimit të duarve" në Krime, shqetëson jo pak vendet në kufi me Rusinë, dhe jo vetëm ato të NATO-s, e cila, po bën edhe ajo të vetën për të përkeqësuar shqetësimet e rusëve në lidhje me mbrojtjen e kufijve të saj. Suedia, historikisht neutrale që nga Lufta e Parë Botërore dhe më pas, e pashtruar në asnjë aleancë gjatë Luftës së Ftohtë, kohët e fundit ka ndryshuar doktrinën e saj ushtarake, duke përditësuar planet e "neutralitetit të armatosur" gjatë së kaluarës së afërt. Tashmë që nga shtatori i vitit që kaloi, Stokholmi ka rivendosur një prani ushtarake të qëndrueshme në ishullin e Gotlandit, që gjendet pothuajse në qendër të Detit Baltik, përballë Letonisë. Ishulli ka qenë tërësisht "demilitarizuar", në vitin 2005 me tërheqjen e forcave detare, tokësore dhe ajrore, të cilat deri atëherë ishin stacionuar aty, pasi konsiderohej strategjik prej Suedisë, por jo vetëm: pozita e tij gjeografike e bën një objekt veçanërisht të lakmuar, për ata që do të donin të



kontrollonin lundrimet në Detin Baltik, dhe kështu të hynin në Gjirin e Finlandës dhe në Gjirin e Botnias, i cili gjithashtu "mbikëqyret" nga ishulli finlandez i Ålandit.

Por Gotland bëhet një trampolinë (ose siguron mbulim) për një sulm të mundshëm amfib nga "pas", për vendet e Baltikut: ish-ministri i Mbrojtjes i Estonisë, Rebas Hain, ka ide të qarta rreth kësaj, duke theksuar se ishulli është kthyer në qendër të interesave strategjike të vendeve që lagen nga Baltiku, për arsytet e lartpërmendura. Tashmë në vitin 2010, shumë kohë para se të ndodhte përkallëzimi i vogël ushtarak që po ndodh kohët e fundit përgjatë kufirit lindor, Gjenerali suedez Karlis Neretnieks, e kishte parashikuar kthimin e rolit qendror dhe strategjik të Gotland për të gjithë aktorët ushtarakë dhe politikë, që ndodhen në rajonin qendror dhe jugor të Baltikut: kontrolli i Gotland siguron kontroll të të gjithë hapësirës ajrore të rajonit, si dhe nismave strategjike detare. Në skenarin më të keq të mundshëm, ishulli do të ishte në qendër të një përpjekje ruse, për të nxjerrë Nato-n



"Aurora 2017", ky është emri i stërvitjes, filloi më 11 shtator dhe do të përfundojë më 29 dhe ka si objekt kryesor përmirësimin e ndërveprimit mes degëve të ndryshme të forcave të armatosura, në një kontekst të "Mbrojtjes totale" të territorit (në Stokholm është përfshirë edhe popullata civile, përveç Rezervave)

jashtë loje në zonë (një lloj përsëritjeje, por me flamur rus, e operacionit Vesperung të vitit 1940), pasi nëse kjo e fundit do të kontrollonte ishullin dhe dislokonte forca të mjaftueshme në një kohë të shkurtër, ai do të bëhej një

mjet efikas për të siguruar superioritetin ajror dhe detar të Moskës në Baltik.

Bazuar në këto konsiderata, Suedia më pas ndryshoi rrugën e doktrinës së saj ushtarake, e cila parashikonte një "çarmatim" të ngadalshëm pas



zues, në optikën ruse.

Natyrisht, kjo zgjedhje diplomatike, bazuar në perceptimin që Stokholmi ka për rrezikun rus ndaj kufijve të vet, ka çuar në një linjë të qartë mbrojtëse: armiku tani është Moskë. Këto ditë, në fakt, Suedia po zhvillon stërvitjen më të madhe ushtarake në 20 vite, ku përfshihen rreth 19,000 oficerë (rreth gjysma e forcës), një e katërta e të cilëve i përkasin Gardës Kombëtare.

"Aurora 2017", ky është emri i stërvitjes, filloi më 11 shtator dhe do të përfundojë më 29 dhe ka si objekt kryesor përmirësimin e ndërveprimit mes degëve të ndryshme të forcave të armatosura, në një kontekst të "Mbrojtjes totale" të territorit (në Stokholm është përfshirë edhe popullata civile, përveç Rezervave).

Një qëllim i dytë, por po aq i rëndësishëm, ishte të jepet një mesazh ndërkombëtar rreth vullnetit të Suedisë për të mbrojtur kufijtë e vet, me çdo kusht. Për më tepër, një nga skenarët e stërvitje i lë pak vend imagjinatës: një vend mik, i quajtur "Vendi A" (por ne mund ta quajmë Lituania, Estonia dhe Letonia), është i zënë në morskë; në veri dhe në jug të kufijve të vet, një komb armiqësor i quajtur "Vendi B" (por ne mund ta quajmë Rusia) kërcënon integritetin territorial të tij. Me shpërthimin e krizës dhe rrezikun që ndihma e mundshme ushtarake të mund të arrijnë në "Vendin A" nga territoret suedeze, "Vendi B" përpiqet që të pushtojë së pari ishullin e Gotland dhe territoret në jug të Stokholmit, për të siguruar superioritet në zonën baltike. Përgjigja suedeze për një mundësi të tillë, atëherë konsiston në një operacion në shkallë të gjerë kundër një sulmi të mundshëm ajror drejtuar edhe ndaj territorit metropolitan suedeze. Në stërvitje po marrin pjesë gjithashtu vende të tjera, që kanë siguruar njerëz dhe mjete. Në veçanti, Finlanda ka dërguar 300 ushtarë, Franca 120 dhe një total prej 200 janë ata nga Danimarka, Norvegjia, Lituania dhe Estonia, por, siç ndodh shpesh, më e shumta është forca amerikane, me rreth 1.400 meshkuj. Shtetet e Bashkuara përveç ushtarëve kanë dhënë edhe një "sistem baterish Patriot, ndoshta në versionin e PAC-3 me aftësi ABM, vetëm për të simuluar mbulimin e raketave në rast të sulmit rus nga SRBM, të pranishme në Kaliningrad (lloji "Iskander-M"), të cilat janë një komponent kyç i strategjisë së Moskës, për zonat e Baltikut dhe Evropës Lindore.

Por, vërtetë Suedia ka ndërmend të heqë dorë nga neutraliteti i saj i armatosur? Në fakt, duket se Stokholmi, prej disa vitesh, ka hyrë me fuqi të plotë në NATO: në vitin 2014 e ka braktisur statusin e "vendit jo të reshtuar" për të firmosur një marrëveshje bashkëpunimi ushtarak me Aleancën; marrëveshje që siguron mundësinë e NATO-s për të vendosur trupat e saj në territorin suedez edhe në kohë paqeje, si dhe në rast të një krize ndërkombëtare, dhe ndoshta ky është faktori i vërtetë destabilizues,



Para 27 vjetëve, pikërisht më 12 nëntor 1987, koha qe e bukur. Ndërsa i mbulonin arkivolin me dhe, dielli përdriste si ditë të kremte copërat e baltës përpara se të binin mbi të. Ai po futej kështu nën dhe "veshur me diell, mbathur me hanë"

Në shiritin e kohës

Një penë e fuqishme që shkroi për Lasgushin

E bija e Poradecit sjell këto rreshta të shkruara nga Kadare për të atin: E kisha dashur përherë Lasgush Poradecin, me një dashuri të veçantë, që kishte gjithmonë brenda saj një brengë, një qortim. Por, edhe dashuria për të, edhe brenga edhe qortimi ishin të një përmase të veçantë, përtej të zakonshmes, gati-gati misterioze

Bardha NERGJONI

Vetëm një penë e shkëlqyer mund të përshkruajë në këtë mënyrë një poet të madh. Ismail Kadare i ka përcjellë kaq fuqishëm përjetimet e tij për Lasgush Poradecin sa të shtosh më shumë apo të heqësh do të ishte mëkat. E bija e Poradecit sjell këto rreshta të shkruara nga Kadare për të atin: "E kisha dashur përherë Lasgush Poradecin, me një dashuri të veçantë, që kishte gjithmonë brenda saj një brengë, një qortim. Por, edhe dashuria për të, edhe brenga edhe qortimi ishin të një përmase të veçantë, përtej të zakonshmes, gati-gati misterioze."

Po aq sa për vjershat e tij të bukura, ndoshta më shumë se për ato, kisha mall për kohën që kishte vdekur bashkë me të. Një kohë gjithashtu e papërcaktueshme lehtë (as kohë e mbretërisë, as e republikës, as e paraçlirimit), jo, një kohë tjetër, që mund të ishte brenda të triave, e mund të mos ishte



askund. Më shumë se atë vetë, doja tek ai ëndrën mallëngjyese për diçka të tretur. Të pakthyesmen. Të pamundurën. Prej vitesh ishte dhe s'ishte. E kishin mënjeluar, mungonte në të gjitha ceremonitë. Dhe ndoshta pikërisht midis ceremonisë, pranimit të festës, niste qortimi për të. Por, edhe ai vetë, si çdo gjë tjetër që lidhej me të, ishte e tjetërfartë, e përgjithshme, flu, më tepër qortim ikonash...

...Para 27 vjetëve, pikërisht më 12 nëntor 1987, koha qe e bukur. Ndërsa i mbulonin arkivolin me dhe, dielli përdriste si ditë të kremte copërat e baltës përpara se të binin mbi të. Ai po futej kështu nën dhe "veshur me diell, mbathur me hanë".

Në vjeshtë shtërgjet duhet të dukeshin që këtu, tek nise-

shin për larg. "Fluturoi dhe shtërg i fundit madhështor me shpirt të gjorë". Më erdhi të thosha: ku do të nises, shtërg i madh, dhe ku do të na lesh në të gjorëve?

"Në ferr do të zbres të shndrit veç për të vdekurit". Është kërcënimi i diellit të "Iliada", është kërcënimi i poetit vetë. Vetëm truri i zemëruar i tij mund të pjellë një kujë të tillë. Është kundërshtimi i parë i madhërishtë në art. E vështirë që pranë vargut homerik të rendisësh një varg tjetër. Megjithatë, dy strofa nga poezia shqipe afrohen të druajtura në kujtesë. Janë vargje të trishtuara, lirike, të Lasgush Poradecit, të cilat, ndoshta ngjajnë të largëta, kanë një gjen të përbashkët me diellkanosjen homerike. Poradeci i ka shkruar në pleqërinë e tij, kur e ndi-


ente veten të përmbysur "si shkëmb përtoke"

Përmbys shoh shkruabin
Ca iskra pa shuar
Ca yj që s'humbin
Nga jetë e mbaruar.
Përmbys, o jetë
Mi fal stolitë...

Vargu më i bukur i rënies së njeriut..


Aty nuk ka, i mjeri unë si isha, si u katandisa, aq më pak jam plak, por zemrën e kam të re, etj. Kjo është rënie me shkronjë të madhe. Ka diçka titanike kjo vjershë jo në kahen e forcës por të pafuqisë. Përmbys, titani i rënë, por që as ankohehet e as përndizet nga rënia, midis shkruamajës së jetës së vet, si një vetë Galilei, gjurmon "Yjet që s'humbin". Kështu përmbys jeta "ia fal stolitë"...

Botime të reja
Daut Dauti:
SYRI I KEQ



Daut Dauti opinionit shqiptar pos që i është i njohur si publicist, ai njihet edhe si poet dhe prozator. Së fundi, në botim të Shtëpisë botuese "Shkup", ai na vjen me përmbledhjen poetike të titulluar "Syri i keq". Për dallim prej përmbledhjeve të mëparshme, Dauti kësaj radhe na vjen, siç thotë edhe vetë ai, me një bashkëdyzim të poezive të viteve të rinisë, përkatësisht të periudhës kur ai ishte nxënës i shkollës së mesme dhe student në vitet e para të studimeve. Një kombinim interesant i dy kohëve, të cilat dominohen me motive të ndryshme, me ndjenja të sinqerta, por që vijnë si një album i fotografive, i cili album sa herë që të shfletohet, të ngjallë vetëm kujtime. Pra, bëhet fjalë për një përmbledhje të poezive që gjithsesi vlen të lexohen.

Fatos
Rushiti:
KURORË



Fatos Rushiti, një nga krijuesit e plejadës së re, na vjen me një botim të ri të titulluar "Kurorë". Në fakt, bëhet fjalë për një përmbledhje interesante, e cila dëshmon, se për dallim prej veprave të mëparshme, autori ka bërë një hap para, duke na sjellë vargje që burojnë nga çastet e fiksuara të kujtimit të dhembshtëm, të cilat vijnë në formën e së bukurës. Fatosi si hero lirik, na çon drejt asaj bote, të cilën secila nga na e bart në vete, por nuk e emëron zëshëm. Është një përmbledhje ndryshe nga ato që janë botuar viteve të fundit, së paku në nënqiellin tonë. Përmbledhja "Kurorë" vjen si botim i Klubit të Shkrimtarëve "Jehona e Karadaku" nga Kumanova.

Libri i urryer amerikan që frymëzoi Hitlerin...

Ai mund të jetë trakti më i rrezikshëm shkencor i shkruar ndonjëherë. Dhe ajo që pasoi botimin e librit që Führeri e quajti 'Bibla e tij' është një pasqyrë pasqyre e titujve të sotëm

Në vitin 1916, Madison Grant, një konservacionist dhe avokat i qytetit të Nju Jorkut, botoi "Vdekja e racës së madhe". Ishte një zgjerim i teorieve popullore eugjenike të propozuara së pari nga Francis Galton, një shkencëtar britanik dhe gjysmë kushëri i Charles Darvinit. Galton besonte se mbarështimi selektiv nuk duhet të kufizohet tek kafshët. Ai argumentonte se nëse ne mund të krijojmë kuaj më të shpejtë, atëherë duhet të jemi në gjendje të krijojmë edhe njerëz më të mirë. Ai pretendonte se tipare si



inteligjenca, besnikëria, trimëria dhe ndershmëria ishin gjithashtu të trashëgueshme.

Në librin "Vdekja e racës së madhe", Grant i çoi teoritë e Galtonit një hap më tej. Duke përdorur lëvizjet e popullsisë, karakteristikat e fytyrës dhe pseudoshkencën, Grant argumentoi se tiparet e padëshirura përcilleshin jo vetëm nga një anëtar i familjes në një

tjetër, por edhe brenda përkatësive të caktuara etnike dhe grupe fetare.

Amerika, argumentonte ai, ishte duke kryer "vetëvrasje racore". Nuk ishin më emigrantët që vinin nga pjesët "e dëshirueshme" të Evropës veriperëndimore, si Ishujt Britanikë, Skandinavia dhe Gjermania. Ata vinin nga vendet më të vogla në Evropën Jugore dhe

Lindore. Botuar së pari në pranverën e vitit 1916, libri u ribotua në 1922, 1923, 1924, 1926, 1930, 1932 dhe 1936, duke shitur më shumë se një milion kopje - ndoshta, një nga traktet më të njohura shkencore në histori.

Në vitin 1917-një vit pasi Grant botoi librin e tij-Kongresi miratoi një ligj që ndalonte "të gjithë idiotët, budallenjtë, personat e dobët, epileptikët, personat e çmendur, [dhe] personat me inferioritet psikopatik kushtetues" që të hynin në SHBA.

Gjatë diskutimeve, një kongresmen lexoi direkt paragrafë nga "Vdekja e racës së madhe". Si pasojë, rreth 1.500 emigrantëve në vit iu mohua hyrja. Një eugjenist i zjarrtë i shkroi një letër Grantit duke i kërkuar atij të ndërtonte një Mur të Madh: "A mund të ndërtojmë një mur mjaft të lartë në këtë vend, në mënyrë që t'i mbajmë jashtë këto raca?". A ju kujton ndokënd sot?



Kosova në kërkim të përzgjedhësit

Kroacia, Bosnja e Hercegovina e Maqedonia janë tri pistat kryesore



Shtëpia e Futbollit ka thënë se kryetari i saj, Fadil Vokrri, tashmë po mundohet ta gjejë një trajner të huaj për "Dardanët", shkruan gazeta "Zëri", transmeton gazeta KOHA. "Natyrishit se nuk është e lehtë, sidomos për FFK-në, kur dihen mundësitë buxhetore. Qëllimi i kryetarit Vokrri është ta gjejë një trajner të mirë dhe të lirë, të përballueshëm për buxhetin e FFK-së", ka theksuar Shtëpia e Futbollit.

Mësohet se Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina e Maqedonia janë tri pistat kryesore të kërkimit të një përzgjedhësi të ri për Kosovën, ndërsa për më

larg. Gjermania është vendi ku FFK-ja e sheh mundësinë më të mirë të gjetjes së pasardhësit të Bunjakit.

Mirëpo, një lajm interesant ka buruar nga mediat e Sllovenisë, të cilat kanë theksuar se Srećko Katanec është një kandidat potencial për postin e përzgjedhësit të Kosovës. Ish-futbollisti i Olimprijas, Dinamos së Zagrebit, Partizanit të Beogradit, Shtutgartit dhe Sampdorias, prej vitit 2013 është përzgjedhës i Sllovenisë. Më herët ai i ka udhëhequr edhe Emiratat e Bashkuara Arabe, Maqedoninë dhe Olimpiakosin. Sipas me-

diave të Lubjanës, Katanec është në rrugë të mirë për të shkuar në Botëror me Slloveninë dhe nëse dështon në këtë rrugëtim atëherë gjasat janë reale që ta marrë drejtimin e Kosovës. Mirëpo, Kosova tashmë e ka në dispozicion edhe një tjetër trajner në opsionet për ta përzgjedhur përzgjedhësin e ri.

Derisa Ardian Kozniku tash për tash nuk është në planet e FFK-së, kjo e fundit mund ta shohë si opsion një tjetër trajner shqiptar. Fjala është për ish-futbollistin e famshëm kosovar, Besnik Hasi, i cili konsiderohet si trajneri numër 1 shqiptar. Ish-

Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) është vënë në kërkim të një trajneri të ri për Përfaqësuesen e Kosovës, të cilin Albert Bunjaki do ta udhëheqë vetëm edhe në dy ndeshjet e fundit kualifikuese për botërorin "Rusia 2018" kundër Ukrainës dhe Islandës. Mësohet se Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina e Maqedonia janë tri pistat kryesore të kërkimit të një përzgjedhësi të ri për Kosovën, ndërsa për më larg.

kapiteni i Shqipërisë posa është ndarë me Olympiacosin, tek i cili klub qendroi vetëm pak muaj. Shkurtimisht kishte punuar edhe në Legia të Varshavës. Andaj, ish-trajneri i Anderlehtit do të mund të gjente goxha rehati në krye të shtabit teknik të Kosovës, për të cilin natyrishit se ka ndjenja të veçanta. Hasi i plotëson të gjitha anëtarët e profesionalëve për ta drejtuar Kosovën dhe jo rastësisht ka herë është përmendur si një kandidat për postin e trajnerit të Shqipërisë.



Prezantohet Elmas, ardhmëria e Fenerbahçes

Shkup, 28 shtator - Futbollisti i talentuar nga Maqedonia Elif Elmas dje edhe zyrtarisht ka pasur paraqitjen e tij të gjiganti turk Fenerbahçe. Ai është prezantuar si ardhmëria e klubit bashkë edhe me dy futbollist tjerë të cilët arrihen te Fenerbahçe, holandezi Vinsent Jansen dhe Luis Neto. Menjëherë pas prezantimit, Elmas ka folur për pershtypjet e tija të para dhe rruga se si ai arriti të transferohet te skuadra nga Stambolli. "Fenerbahçe është klub i madh dhe unë jam i lumtur që jam pjesë e saj. Nuk kam menduar aspak kur më erdh oferta që ti bashkohem Fenerbahçes. Familja ime, por edhe shumë shok të mi të fëmijërisë, anojnë për këtë klub, kështu që për mua kjo është realizimi i ëndrrës. Shpresoj se do të arrij sukses, edhe pse jam i vetëdijshëm se në ekip ka shumë lojtar kualitativ dhe me përvojë", u shpreh

Elmas, i cili të drejtë loje për Fenerbahçen do të ketë nga janari i vitit të ardhshëm. "Nuk është problem që duhet të pres deri në janar të debutojë, pasi gjatë kësaj periudhe do të kem mundësi që më mirë të adaptohem në futbollin turk. Në fund dëshiroj të përsëndes shokun tim Pero Antiq, i cili gjithashtu luajti rol të rëndësishëm rreth ardhjes time në Stamboll", përfundoi në pranimin e tij zyrtar Elf Elmas. Cekim, vetëm pas dita ditëve Elmas mbushi 18-vjeç, kur edhe zyrtarisht hyri në fuqi kontrata e tij pesëvjeçare me skuadrën turke Fenerbahçe. Mirëpo, për tu licencuar për pjesëmarrje në Superligën e Turqisë ai do të duhet të pret deri në janar. Derisa, mediat në Turqi pohojnë se ai do të merr licencën e futbollit të njohur holandez Robin Van Persi, i cili do të largohet nga klubi.

Kosova ka shënuar më pak gola se Beqiraj te Mali i Zi

Prej tre golave sa i ka gjithsej përfaqësuesja e Kosovës në futboll në eliminatorë, vetëm njëri mban firmën e një sulmuesi. Në humbjen 2:1 nga Islanda në Shkodër më 24 mars, golin e vetëm për Kosovën e shënoi sulmuesi shtatlartë, At-dhe Nuhiu. Ndërkohë një lojtar tjetër kosovar i sulmit, një lojtar të cilin e ka injoruar Kosova, ka shënuar katër gola në kualifikimet aktuale, ato për botërorin e futbollit "Rusia 2018". Është Fatos Beqiraj që ka realizuar katër herë, përkatësisht më shumë se përfaqësuesja e Kosovës. Ai katër golat i ka shënuar për Malin e Zi, përfaqësuesen që është në garë për kualifikim në botërorin e vitit tjetër.



Pas Inzagit edhe Dino Zof vlerëson portierin shqiptar Strakosha mund të bëjë gjëra të mëdha

Në historinë e futbollit botëror, janë të paktë emrat e portierëve që kanë lënë gjurmë të tilla aq sa kujtohen nga të gjithë. Një prej tyre është edhe legjenda italiane Dino Zof, një nga më të mëdhenjtë në këtë rol që është shpallur kampion bote me "të kaltrit" në vitin 1982. Ndaj një lëvdatë e tij, për një portier të ri, është

diçka që duhet vlerësuar jashtëzakonisht shumë. Portieri i ri në fjalë është Tomas Strakosha, i cili pak ditë më parë bëri vitin që nga momenti i debutimit me Lacion në Serinë A. Zof, si njohës i mirë i këtij klubi, ku ka qenë për disa vite trajner, ka dhënë mendimin e tij rreth paraqitjeve të deritanishme

të shqiptarit. "Që ai duhet të përmirësohet më shumë, kjo nuk ka dyshim.

Por po bën gjëra të rëndësishme, duke e parë edhe moshën e re që ka. Ai është një garanci dhe nëse do të vazhdojë kështu, do të bëjë gjëra të mëdha", ishin fjalët e Zof për mediat italiane. A mund të ketë më mirë se kaq...

Klubet kosovare shkarkojnë 5 pesë trajner për 7 javë!

Kur kanë kaluar 7 xhiro në Superligën e Kosovës, diferenca mes liderit Llapit dhe Vllaznisë së fundit në tabelë është 11 pikë. Duke pasur parasysh këtë fakt, që skuadrat janë shumë afër me njëra tjetrën, e ke të vështirë të gesh përgjigjen e pyetjes, pse gati gjysma e ekipeve kanë ndërruar trajner? Dorëheqja e Gani Sejdiut e ka çuar në 5 numrin e trajnerëve që janë larguar vetë apo shkarkuar nga kryesitë e klubeve. Ajo që e bën dramatikë situatën është se të gjitha këto ngjarje kanë ndodhur shumë



shpejtë. Nga 13 deri më 27 shtator, çdo 3-4 ditë është larguar nga një trajner. Numri mund të ishte edhe më i lartë sepse ka edhe tjerë

që kanë ofruar dorëheqjen, si Milaim Zuzaku i Dritës por që presidenti Valon Murseli ia kishte refuzuar. Shtrohet pyetja pse trajnerët


po dorëzohen kaq herët? A është në pyetje presioni që ushtrohet nga kryesitë e klubeve, apo pritshmëria e madhe që rezultatet e mira të vijnë menjëherë. Apo ndoshta nuk e kanë të qartë se në futboll dikush duhet të humb, s'mund të fitojnë të gjithë. Fillimisht ishte shkarkuar Zekirija Ramadani nga Trepça '89, më pas erdhën dorëheqjet e Valdet Shoshit nga Besa, Arsim Thaçit nga Prishtina, Agron Selmanit nga Flamurtari dhe së fundi Gani Sejdiu nga Feronikeli. Mbetet të shihet se kush e ka radhën!



Leonardo është trajner i ri i Antaliaspor. Pas tri edicioneve si drejtor sportiv i PSZH, Leonardo i është kthyer rolit të trajnerit. Leonardo do ta drejtojë ekipin turk Antaliaspor, që është në kërkim të rezultateve pozitive pas një fillimi të vështirë të sezonit në Superligën e Turqisë

Reklama e madhe që i ka bërë këtij sporti Konor MekGregor nga përballja e fundit me Flojd Mejveder, por edhe mjaft ikona të tjera të këtij sporti, mund ta bëjnë edhe më të lehtë pranimin e këtij sporti në familjen olimpike

Artet marcialle mikse në Lojërat Olimpike të vitit 2024



Zëvendës presidenti i UFC-së, Xho Karr, ka konfirmuar idenë se disiplina e arteve marcialle mikse (MMA) mund të debutojë në Lojërat Olimpike që do të zhvillohen në vitin 2024. Reklama e madhe që i ka bërë këtij sporti Konor MekGregor nga përballja e fundit me Flojd Mejveder, por edhe mjaft ikona të tjera të këtij sporti, mund ta bëjnë edhe më të lehtë pranimin e këtij sporti në familjen olimpike

kufij në të ardhmen, duke e bërë më popullore, më të praktikueshëm dhe eventualisht hyrja e tij në familjen olimpike do të jetë më e lehtë. “Është thjesht çështje kohe, që ky sport të kthehet në një fenomen olimpik. Sot, në botë, janë 60 federata të MMA-së, që i dedikohen tërësisht këtij sporti. Ne kemi ndërtuar bazat e forta për ta bërë këtë sport të dashur, tërheqës dhe fitimprurës. Së shpejti presim që edhe Komiteti

Olimpik Ndërkombëtar (IOC) të na njohë si disiplinë sportive”, tha zv.presidenti i UFC. Numri 2 i UFC-së pranon se do të synojnë që disiplina e arteve marcialle mikse të aplikohet që në Olimpiadën e vitit 2024. Në rast se kjo gjë nuk ndodh, atëherë objektivi do të jetë viti 2028. “Sot Olimpiadat synojnë të bëhen gjithnjë e më të “reja”, duke iu dedikuar të rinjve dhe kohët e fundit janë pranuar shumë

sporte të reja. Dhe në epokën që po jetojmë, MMA po bëhet edhe më popullore. Ndaj ne mund të jemi shumë shpejt në familjen olimpike”, tha Karr. Janë të shumtë sportistët që sot praktikojnë MMA-në dhe që kanë garuar më parë në Olimpiada, në disiplina të ndryshme (boks, mundje, xhudo, karate, taekwondo), por tashmë të gjitha këto disiplina mund t'i shohim së bashku në Lojërat Olimpike.

Jamaha i jep urdhra Valentino Rossit

Duhet të ndihmohet Vinales për titullin

Tek Jamaha kanë mbetur të mahnitur nga rikuperimi “flash” i Valentino Rossit, që u rikthye në pistë 24 ditë pas operacionit, por njëkohësisht kanë mbetur edhe të kënaqur nga rezultati i pilotit italian, që në pistën e Aragon u rendit i pesti, pas shokut të tij të skuadrës Maverik Vinales. Pas kësaj gare, Rossi ka 58 pikë disavantazh karshi kryesuesit të Moto GP, spanjollit MarK MarKuez, ndërsa Vinales është 28 pikë pas patriotit të tij, duke qenë ende në garë për titull. Sipas Mattero Meregalli,

një prej drejtuesve të Jamaha, piloti italian nuk ka shumë shanse të fitojë titullin kampion, ndërsa Vinales po. Ndaj ai beson se italiani do të bëjë një lojë skuadre për ta ndihmuar spanjollin të fitojë titullin. “Nuk e kemi bërë kurrë në të shkuarën që njëri pilot të ndihmojë tjetrin, por gjithçka mund të ndodhë. Rossi ka përvojë dhe do të dijë si të sillet në pistë nëse Vinales është në garë për titullin. Do t'i themi Rossit të mos e pengojë Vinales dhe të ngadalësojë rivalët e tij”, tha Meregalli.



Publicitet

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 187/2015, 94/16 dhe 158/16) dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup, publikon:

THIRRJE PUBLIKE

Për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit

Shoqëria aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup bën shitjen e materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i Lumit Vardar pjesa f. Miravc në pajtim me Pëlqimin për ekonomi të ujërave për rregullimin e një pjese të shtratit të Lumit Vardar në pjesën në f. Miravc nr. 11-1976/2 të datës 26.06.2012 të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimi fillestar i materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 150,00 denarë plus 7 % kompensim për ujërat plus 18 % TVSH, ndërsa sasia nuk guxon të kalojë më shumë se 34.894 m³.

Ngarkimi i materialit të lumit bie në barrë të blerësit. Shpallja zgjatë 3 (tri) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur me shenjë “OFERTË – MOS HAP”, për Komisionin për ankand publik pozitiv, pa adresë, vulë dhe shenja të tjera në të.

Oferta duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e firmës, numër tatimor, personi përgjegjës, kontakt telefon, llogari dhe bankë deponuse, me theksim të saktë shumës së ofruar në ofertë të mbyllur.

Së bashku me ofertën parashtrihen dokumentet në vijim për dëshmim të:

1. Gjendjes personale:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent,
- Vërtetim nga Regjistrimi i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik privat,
- Vërtetim nga Regjistrimi i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarive të veçanta,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë
- Vërtetim për tatime të paguara.

2. Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale:

- Dokument për veprimtari të regjistruar – si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik,

Dokumentet e kërkuara nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuara nga ofertuesi.

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihet dëshmi për depozitë të paguar në shumë prej 150.000,00 denarë. Ofertuesve që nuk janë të zgjedhur u kthehet depozita e paguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit.

Depozita duhet të paguhet në llogarinë me numër 200002947890520 deponent Stopanska Banka SHA Shkup.

Hapjen e ofertave do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik, emëruar nga Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup më datë 02.10.2017 në ora 12.00 në lokalet e SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup në rr. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 10a Shkup.

Shitja e materialit shkarkues bëhet përmes ankandit publik me gojë.

Procedura për ankandin publik realizohet në tri faza:

Faza e parë – përcaktimi i kandidatëve që përmbushin kushtet për pjesëmarrje në ankand

Faza e dytë – identifikim të regjistrimit të pjesëmarrësve

Faza e tretë – ankand publik

Në ankandin publik mund të marr pjesë vetëm personi përgjegjës i ofertuesit ose personi i autorizuar nga ai.

Pas zgjedhjes së realizuar, SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të lidhë marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur për rregullim të të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, që është i obliguar që të parashtrijë garanci bankare në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Informacione më të detajuara mund të merren në numrin e telefonit 078-440-515 – Andrea Najdenovski.



FORUMI RINOR ISLAM
ИСЛАМСКИ МЛАДИНСКИ ФОРУМ
ISLAMIC YOUTH FORUM

Rr. Krste Misirkov, nr. 57a, lok. 3
1000 Shkup, Maqedoni
Tel./Fax: + 389 2 3233 659
www.fri.org.mk
info@fri.org.mk

Forum Rinor Islam, me rastin e manifestimit të Vitit të Ri të Hixhrit 1439/2017, shpall:

KONKURS

Për ndarjen e çmimit SHKENCËTARI I RI I VITIT

Çmimi “Shkencëtari i ri i vitit” ndahet si mirënjohje shoqërore për të arritura të veçanta në çfarëdo lëmi shoqërore apo shkencore.

Ndarja e këtij çmimi ka për qëllim përzgjedhjen e një kandidati me epitetin e shkencëtarit të ri të vitit për vitin 2017, për sukseset e realizuara në një fushë të caktuar, duke shërbyer në këtë mënyrë si një nxitje shtesë për të gjithë shkencëtarët dhe hulumtuesit e rinj në Republikën e Maqedonisë.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- Të jenë nën moshën 33 vjeçare;
- Të kenë të kryer arsimin sipëror-fakultetin;
- Të kenë të arritura të veçanta në shkencë.

Me rastin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin vijues:

- Fletë aplikimin;
- Letër motivacionin;
- CV personale;
- Kopje të certifikatave, punimeve, botimeve apo ndonjë materiali tjetër që vërteton arritjet e tyre.

Përzgjedhjen e kandidatëve e bën Komisioni pesë anëtarësh i përbërë nga profesorë universitarë, i emëruar nga Kryesia e Forumit Rinor Islam. Komisioni në fjalë do ta bëjë përzgjedhjen në mënyrë transparente, në prani të kandidatëve, duke respektuar udhëzuesin për zgjedhjen e Shkencëtarit të ri të vitit. Udhëzuesin në fjalë kandidatët mund ta marrin në adresën elektronike: www.fri.org.mk

Informata shtesë lidhur me konkursin, kandidatët mund të marrin përmes emailit: info@fri.org.mk

Ose në numrin e telefonit: (02) 3233 659

Aplikimet duhet të dërgohen më së voni deri më 18.10.2017, në adresën e Forumit Rinor Islam:

Rr. Krste Misirkov nr. 57a lok.2

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Ose përmes emailit: info@fri.org.mk

Komisioni për ndarjen e çmimit “Shkencëtari i ri i vitit”

Është humbur diploma e SHM "Arsenie Jovkov" - Shkup, të personit Emra Abduramani dhe njëkohësisht shpallen të pavlefshme.



Nëse nuk luaj mirë, atëherë trajneri ka të drejtë të më zëvendësojë. Guardiola po bën një punë shumë të mirë, duke përdorur shumë lojtarë dhe secili prej tyre po e ndihmon ekipin e Siti të përmirësohet

“Nuk nuk di asgjë. Askush nuk më ka folur për këtë temë. Drejtuesit e Siti nuk më kanë thënë asgjë dhe as menaxheri im. Nuk ka ndodhur asgjë e re dhe përqendrimi im është maksimal për të dhënë më të mirën në fushën e lojës për Mançester Siti”, pohon Jesus

Gabriel Jesus deklaroi se nuk di asgjë në lidhje me zërat që flasim për një kontratë të re me Mançester Siti. Sulmuesi nga Brazili, i cili ka lënë një përshtypje shumë të mirë, që pas mbërritjes në “Etihad Stadium” në janar, është shumë pranë një marrëveshje të re me ekipin e Pep Guardiola, sipas asaj që shkruan shtypi britanik. 20-vjeçari, i cili ka shënuar 12 gola në 19 ndeshje me fanellën e Siti, ka edhe katër vite kontratë të mbetur nga marrëveshja aktuale. “Nuk nuk di asgjë. Askush nuk më ka folur për këtë temë. Drejtuesit e Siti nuk më kanë thënë asgjë dhe as menaxheri im. Nuk ka ndodhur

Jesus mohon rinovimin me Mançester Siten



asgjë e re dhe përqendrimi im është maksimal për të dhënë më të mirën në fushën e lojës për Mançester Siti”, thotë Jesus në pyetjen në lidhje me rinovimin e mundshëm. Jesus ka

luajtur shumë mirë në krah të Sergio Agueros, por gjithashtu i jep trajnerit Guardiola një alternativë të rëndësishme, kur një prej qendërsulmuesve do të pushojë. Derisa, Jesus nuk luajti në fitoren 5-0 që Mançester Siti arriti kundër Kristall Pallas dhe u zëvendësua pas 54 minutash lojë në fitoren 2-0 kundër Shakhtar Donetsk në Çampion. “Nëse një futbollist luan më mirë se unë në rolin tim, atëherë më duhet ta pranojë dhe të qëndrojë në stol. Nëse nuk luaj mirë, atëherë trajneri ka të drejtë të më zëvendësojë. Guardiola po bën një punë shumë të mirë, duke përdorur shumë lojtarë dhe secili prej tyre po e ndihmon ekipin e Siti të përmirësohet. Kjo është kryesorja”, deklaroi Jesus.

Gati kontratat e reja për Kielinin dhe Sandron

Opsione rinovimi te Juventusit, pasi bisedimet kanë filluar me Aleks Sandron, ndërsa do të fillojnë edhe me Gjorgjio Kielini. Mbrojtësi i majtë brazilian ka qenë në radarin e Çellsit, por klubi italian refuzoi çdo ofertë për të. Juventusit pritet ta blindojë Sandron deri në vitin 2022. Beppe Marotta dhe Fabio Paratici, janë të lumtur me lojtarin dhe pritet edhe një rritje page për të. Paga e re e tij pritet të jetë pesë milionë euro, në rang me pagat më të larta në Juventus. Vetëm Gonzalo Higuain dhe Paulo Dybala, do të përfitonin më shumë se Sandro pe pagën e re. Në anën tjetër vazhdimi i kontratës së Kielinit shihet një formalitet pasi lojtari vazhdon të tregojë formë të mirë sa herë është në fushë.



Interi e do Goretzkan, por Bajerni është në mes



Interi është futu në garë për Leon Goretzkan, por mesfushori më shumë e pëlqen kalimin te Bayern Munihi. Gjermani aktualisht është lojtar i Schalke 04, por në fund të sezonit mbetet pa kontratë. Juven-

tusi kishte shfaqur interesim në për të gjatë verës, por “calciomercato.com” shkruan se bisedimet u ndërpreën kur e kuptuan dëshirën e lojtarit për tu bashkuar me Bayernin. Bavarezët kanë bërë ofertë konkrete për lojtarin dhe klubi gjerman shihet në avantazh. Derisa, “Bianconerët” kanë marrëdhënie të mira me Bayernin dhe nuk kanë dashur të futen në mes. Por, kjo ueb faqe shkruan se Interi është i hapur për transferimin e lojtarit dhe janë të gatshëm të bëjnë ofertë. “Nerazzurët” mund të përfitojnë nga situata e Karlo Ançelotit me klubin.

Real dhe Arsenali nisin garën për Drakslerin

Real Madrid do të lëvizë në merkaton e janarit për të marrë sulmuesin e Paris Sen Zhermen, Julian Draksler. Arsenali ishte i gatshëm të merrte futbollistin gjerman gjatë verës, por dështoi në arritjen e marrëveshjes sepse u kujtua vetëm në ditët e fundit të verës. Draksler ka qenë gjithmonë i preferuar nga Wenger, por ai zgjodhi të shkojë në Paris, kur u largua nga Bundesliga. Shanset e Arsenalit janë shtuar nga fakti që Draksler ka përfunduar në stolin e PSZH, pas blerjeve të Neymar dhe Mbappe. Ndërkohë, sipas “Bild” edhe Real ka nisur të interesohet për Draksler dhe do të ishte gati për huazimin e tij në janar 2018.



Siti futet në mes të dy gjigantëve për Grizmanin

Trajneri i Mançester Sinit, Pep Guardiola, do të tentojë që të arrijë marrëveshje për yllin e Atletiko Madridit, Antoine Griezman. Francezi ka qenë i lidhur me një kalim te Mançester J. gjatë verës, por lojtari nuk ndryshoi mjedis pasi FIFA i kishte dënuar spanjollët për vitin 2017 dhe zëvendësimi i tij ishte i pamundur. Prioritet i Grizmanit tani është largimi në verë dhe vitit 2018 dhe klauzola e kontratës së tij do të bije nga 200 milionë euro në 100

milionë euro. Junajted pritet ta tentojë përsëri, por do të përballlet me konkurrencën e fortë të Sinit, shkruan “Diario Gol”. Guardiola është një fans i madh i francezit Grizman dhe i ka dhënë klubit dritën e gjelbër që t’i bëjë ofertë sa fiton Sergio Agueros. Gjërat mund të komplikohen nëse në luftë futet edhe Real Madrid, pasi Florentino ka kohë që e pëlqen shumë lojtarin. Të tria klubet janë të gatshme ta paguajnë klauzolën prej 100 milionë euro.



Shkurt

Arsenali në garë për Pulisiç

Arsenal është skuadra më e fundit që ka shfaqur interes për të firmosur me Kristian Pulisiç të Borussia Dortmund, raporton tabloidi anglez “The Sun”. 19-vjeçari ka tërhequr edhe vëmendjen e Real Madridit, Liverpulit dhe Totenemit, pas paraqitjeve me ekipin verdhezi. Megjithatë asnjë nga ekipet s’do ta ketë të lehtë, pasi Dortmund e konsideron pjesë të rëndësishme të skuadrës amerikane.

Mançini kandidat për postin e Milanit

Trajneri italian, Vincenzo Montella nuk guxon të gaboj në ndeshjet e radhës nëse dëshiron të mbetet trajner i Milanit. Sipas mediave italiane nëse Rossonerët nuk arrijnë rezultate pozitive në dy ndeshjet e radhës, ndaj Romës dhe Interit, Montella do të shkarkohet. Nëse ndodh kjo, drejtimin e Rossonerëve mund ta marrë Roberto Mançini, i cili aktualisht është trajneri i Zenitit në Rusi, shkruan “Sport Italia”. Kandidat për ta marrë drejtimin e Milanit janë edhe: Antonio Conte, Karlo Ançeloti, Paulo Sousa, Valter Mazzarri dhe Tomas Tuçel.

Interi vendos për Mustafin

Sipas Calciomercato.com, Interi nuk do të tentojë që ta transferoj Shkodran Mustafin nga Arsenal, gjatë janarit. Nerazzurët ishin shumë të interesuar që ta transferonin mbrojtësin shqiptar gjatë verës, por nuk arritën ta bëjnë një gjë të tillë. Thuhet se Arsenali ka qenë i gatshëm ta shes, por Mustafi nuk ka dashur që të transferohet në Itali. Mustafi është pjesë e Arsenalit që nga vera e kaluar, ku ishte transferuar nga Valencia.

Ajestaran, trajneri ri i Las Palmas

Klubi spanjoll i Las Palmas konfirmuan si trajner të ri Pako Ajestaran. Lajmin e bëri të ditur vet skuadra në faqen zyrtare, duke bërë të ditur gjetjen e akordit me 54-vjeçarin për një sezon, i cili zëvendëson në këtë mënyrë të larguarin Manolo Markuez. Ajestaran nuk drejton asnjë klub që pas shkarkimit nga Valencia vitin e kaluar. Ndeshja e radhës do të jetë e vështirë për Las Palmas, që të dielën do të përballlet me Barcelonën.

Teikseira te Interi në janar?

Interi raportohet se do të huazojë Aleks Teixerian në janar. Kjo pritet të ndodhë në mënyrë që të lihet buxhet shtesë për një qendërmbrojtës. Ishte komunikuar se Nerazzurët kanë gjenë humbje prej 24 milionë euro prej sezonit të kaluar, por kjo nuk i sheh ata të rrezikuar nga “Financial Fair Play”. Megjithatë, kjo pritet të pengojë Nerazzurët që të shpenzojnë siç dëshirojnë në janar dhe duhet të blejnë lojtarë me mençuri. Kështu, zikaltrit kanë në plan që të transferojnë një qendërmbrojtës. Por, në plane është edhe Teikseira nga Jiangsu Suning, që sipas “Tuttosport” do të transferohet si huazim në janar në mënyrë që të lihet buxhet për një mbrojtës. Klubi kinez Jiangsu dhe Interi janë në pronësi të Suning Group dhe kjo marrëveshje mund të kryhet lehtësisht dhe me pak para. Kjo do të shtonte buxhetin menjëherë për një qendërmbrojtës i cili shihet si alternativë e Milan Shkriarit.



Ka qenë një paraqitje e madhe nga ana e futbollistëve të mi. Jam shumë i lumtur dhe duhet të jemi të gjithë të lumtur pas asaj mbrëmje ku treguam shpirtin dhe përkushtimin e duhur

U kompletua xhiroja e dytë e Ligës së kampionëve

Nejmar, Kavani e Higuain në qendër të vëmendjes

Pas polemikave që u krijuan ditët e fundit mes brazilianit dhe uruguaiianit, në ndeshjen kundër Bajernit të dytë dhanë sinjal se mes tyre ka një paqe gjë që u vërejt kur Nejmar shënoi golin dhe më pas festuan bashkë me Kavanin. Derisa, numri 9-të i Juventusit Gonzalo Higuain me golin ndaj Olimpiakosit, jo vetëm që i kurseu "Zonjës së Vjetër" komplikimin e situatës në grupe, por u mbylli gojë edhe atyre që nisën ta etiketojnë si një dështim



SHPËRTHEJNË KRITIKAT KUNDËR ANÇELOTIT

Humbja ndaj PSZH (3-0) e lë Karlo Ançelotin në një pozicion të brishtë si trajner i Bajernit. Ai që u ngrit në rolin e zëdhënësit, ishte Karl-Hainz Rummenigge, që njoftoi se do të ketë pasoja. "Mendoj se ajo që pamë mbrëmë nuk ishte Bajern, është e rëndësishme që pas kësaj ndeshjeje të kthehemi shpejt dhe do të jemi përsëri Bajerni. Ishte një humbje për të folur, për të bërë analizë. Ne duhet të flasim në mënyrë të qartë dhe të nxjerrim konkluzione", - tha shefi ekzekutiv i klubit bavarez. Nuk munguan kritikak edhe nga "Bild", gazeta më me influencë e Gjermanisë, sidomos nga kolumnisti Matias Brugelman. "Klopp do të jetë pasardhësi ideal për Ançelotin", - titullohet artikulli i tij. "Si pasardhësi i Ançelotit në vitin 2018 apo 2019, Bajerni ka nevojë për një personalitet, që mund të trajtojë vjet dhe talentet e reja me pasion dhe të ketë një lojë me ide", - shkruan Brugelman.



edhe për përçarje në dhomat e zhveshjes të skuadrës parisienë. Megjithatë pas fitores 3-0 ndaj Bajernit, Kavani theksoi se atmosfera në klub është pozitive. "Ne jemi të gjithë të ndryshëm, kemi mënyra të ndryshme për t'i parë dhe kuptuar gjërat", shpjegoi ai për "Mediaset Premium". "Por kur jemi në fushë, duhet të punojmë të gjithë së bashku si një familje për të arritur të njëjtin objektiv,

që është fitorja", deklaroi uruguaiiani. Ndërkohë, Bavarezët nuk u dukën në lartësinë e pritshmërive dhe vazhdojnë të qarkullojnë zërat për një "thyerje" marrëdhëniesh mes futbollistëve dhe Ançelotit. Arjen Robben nuk përgënjeshtron asgjë dhe fshihet pas "no comment". "A mbështesim trajnerin? Nuk do t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Nuk do të them asnjë fjalë sepse mund të jenë të tepërta. E rëndë-

sishme është që tani të sillemi si skuadër. Duhet të gjejmë paqen dhe të gjithë ata që shprehin pakënaqësitë e tyre duke e ndihmuar ekipin", - deklaroi holandezi, i cili u aktivizua në pjesën e dytë. Takimi tjetër që ka nxitur debate ka qenë ai mes Juventusit dhe Olimpiakosit, ku "Zonja" triumfoi me rezultatin 2-0. E gjithë për faktin se pas dy ndeshjeve si rezervë, ka ardhur goli më në fund për numrin 9-

Tifozët e Bajernit protestuan për çmimin e biletave



Tifozët e Bajernit kanë protestuar për çmimet e biletave në ndeshjen PSZH-Bajern Muni. Bileta më e lirë në stadium ka qenë 75 euro, ndërsa çmimet kanë shkuar deri në 2 mijë euro për një biletë. Tifozët bavarez kanë nxjerr një pankartë ku shkruhej: "75 euro një biletë? Ne nuk jemi Nejmar. Çmimet duhet të jenë më të arsyeshme". Ndryshe, tifozët e Bajernit njihen për protesta të tilla, pasi biletat në shumë stadione në Ligën e Kampionëve janë shumë të shtrenjta. PSZH me blerjen e yjeve të mëdha është kthyer në një atraksion për tifozët të cilët brenda disa ditëve blen të gjitha biletat për këtë ndeshje.

të të Juves, Gonzalo Higuain. Argjentinasit i janë dashur vetëm 497 sekonda për të lënë shenjën e tij të pashlyeshme në ndeshjen kundër Olimpiakos, që ishte e vështirë për t'u fituar. Ngazëllimi tregon një mijë fjalë vuajtjeje të një lojtari që dëshiron ta lërë prapa momentin e vështirë. "Unë kam qenë gjithnjë i qetë, gjëja më e rëndësishme është që gjithmonë të punoj me qetësi dhe heshtje. Nuk shqetësohem as nga kritikak pozitive dhe as ato negative. Ky gol është për të gjithë ata, që kanë qenë gjithnjë afër meje. Merita është ajo që më ka shoqëruar gjithmonë. Sot kam jetuar një nga momentet më të bukura të karrierës sime. Nuk është një rikthim, por jam shumë i lumtur që jam kthyer te goli",

deklaroi Higuain, i cili edhe në "Instagram" ka lënë mesazhin e tij menjëherë pas ndeshjes. "Faleminderit të gjithë atyre që kanë qenë gjithmonë aty. Është një sukses për familjen, për miqtë, shokët, tifozët. Fitore e madhe". Ndryshe, elozhe argjentinasit i ka thurur edhe trajneri Masimiliano Alegri, i cili ka thënë se Higuain do të vazhdojë të bëjë ndryshimin te Juventusit. "Kam bërë një zgjedhje, duke e aktivizuar në pjesën e dytë Gonzalo. Kjo ndeshje ishte më e shpejtë, por ai është një lojtar që kurrë nuk do të jetë problem. Ai di të bëjë ndryshimin dhe do të na ndihmojë të fitojmë ndeshje të tjera. Ky është një sezon i rëndësishëm për Gonzalo dhe shokët e tij, që duhet të konfirmohen", tha Alegri.

Dashuria për Herri Kinin

Poketino: Gruaja ime është xheloze



Maurisio Poketino pranoi pas fitores 0-3 në Nikosia se ai e dashuron Herri Kinin aq shumë sa gruaja e tij ka nisur të bëhet xheloze. Sulmuesi i Totenhemit shënoi tripletën që vulosi fitoren e dytë të anglezëve në grupet e Çampionit. Tre golat e shënuar me të majtën, të djathtë dhe me kokë nga sulmuesi 24-vjeçar, regjistruan tregolëshin e parë të tij në Çampionit dhe të 9-in me Sparsat që komandojnë Grupin H bashkë me Realin. Anglezi vjen në një formë të shkël-

qyer (11 gola në 7 ndeshjet e fundit) ka shënuar më shumë se çdo sulmues tjetër në Evropë në vitin 2017 (34 gola në 30 ndeshje). Trajneri argjentinas ia shprehu dashurinë e tij yllit të skuadrës fillimisht pas dopietës që ai shënoi në derbin ndaj Uest Hemit, por në Nikosia e përsëriti: "Tani gruaja ime është xheloze, por edhe gruaja e tij. Mendoj se është i pabesueshëm. Ai është një vrasës serial përpara porte. Ka diçka speciale, prandaj është një prej më të mirëve".

Serie A kalon Bundesligën në Çampion!

Tre fitore, në tre ndeshje dhe nëntë pikë të mbledhura. Java e dytë e "Champions League" ka dhuruar kënaqësi për Juventusin, Roman dhe Napolin, skuadrat italiane të përfshira në veprimtarinë elitare. Ky sukses i trefishtë, pas një fillimi jo të mirë, e ngjiti futbollin e Serie A në vendin e tretë të klasifikimit të UEFA për klube, në dëm të Gjermanisë. Italia kishte



qenë për herë të fundit mes "Top 3" në vitin 2010, kur Interi realizoi "tripletën" me Hoze Murinon në stol. Me reformimin e "Champions League", e rëndësishme është një vend mes katër të parave dhe faktikisht Serie A e ka siguruar. Megjithatë, rikthimi në podiumin e kampionateve më të forta, pas Spanjës dhe Anglisë është një prestigj për skuadra e Se-

rie A. Parakalimi ndaj Bundesligës ka ardhur edhe nga fakti që tre skuadrat gjermane, Bajern, Dortmund e Leipzig u mposhtën përkatësisht nga PSZH, Real dhe Beshiktash, ndërsa Hofenhaim u eliminua në plej of. Koeficientet e UEFA: 1. Spanja (92.71), 2. Anglia (66.03), 3. Italia (64.08), 4. Gjermania (63.99), 5. Franca (48.74), Rusia (45.58)

Vlerësime pozitive për shqiptarët në Ligën e kampionëve

Futbollistët shqiptarë që kanë zbritur në fushën e lojës në ndeshjet e mesjavës në Ligën e Kampionëve kanë merituar nota pozitive për atë që kanë dhënë në fushë, pavarësisht faktit nëse skuadrat e tyre fituan apo u mundën në duelet përkatëse. Në vijim janë notat e portalit "TMW" për katër lojtarë e përfaqësueses shqiptare që luajtën në këto dy ditë: Valon Ahmedi, Elseid Hysaj, Ansi Agolli dhe Taulant



Xhaka.
Valon Ahmedi (Sevilja-Maribor 3-0) - 6,5 - Luan një ndeshje shumë të mirë, kur Maribori sulmon, mbështetet gjithmonë te këmbët e tij. Me shumë personalitet numri 7 i skuadrës slovene.

Elseid Hysaj (Napoli-Fejenord 3-1) - 6,5 - Ndeshje me rregull, duke i lënë shumë pak kundërshtarëve në krahun e tij. Bie në sy me disa dalje duke arritur në mënyrë të rrezikshme në fundore.
Ansi Agolli (Karabak-

Roma 1-2) - 6 - Kujdeset sidomos për fazën mbrojtëse, duke kontrolluar me sy Defrel. Në pjesën e dytë shtyn më shumë dhe arrin shpesh në fundore. I tiji, në minutën e 90, pasimi për thujase barazimin e Ndllovu.
Taulant Xhaka (Bazel-Benfika 5-0) - 6 - Shumë punë në fazën e mbulimit të hapësirave. Mundohet të shfrytëzojë një goditje dënimi në kufijtë e zonës, por nuk gjen portën.

DASHI (20/III-20/IV)



Çdo gjë që prisni nga sfera profesionale do të keni mundësi ta realizoni sot. Në qoftë se do ju duhet të përballoni një provë të vështirë, keni të gjitha energjitë e duhura për t'i bërë ballë. Në qoftë se jeni çift, do të gjeni mënyrën për të çuditur partnerin.

DEMI (21/IV-20/V)



Mbani lart moralin! Duhet të mësoheni të respektoni ritmin natyral të punëve në jetën e përditshme. Nuk mund të pretendoni të veproni sipas nevojave tuaja personale. Mos i sforconi situatat, sepse nuk do të arrini rezultatet e kërkuara. Mbrëmje mjaft argëtuese, e mbushur me surpriza për shumëllojshmëri nga ju.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Fizikisht nuk do të ndiheni në formën e duhur, kështu që ju nevojitet pushim dhe kura e duhur që do t'ju ndihmojë të ndiheni më mirë. Mbajini sytë hapur në ambientin e punës, sepse dikush mund t'ju vërë kastile në siklet para superiorëve tuaj.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Ditë e mirë. Do të dini të veproni me zgjuarsiri, intuitë dhe imagjinatë dhe në këtë mënyrë do të dini të gjeni zgjidhjet e duhura në çdo situatë. Hëna do ju ndihmojë të rrisni të ardhurat tuaja dhe të plotësoni çdo dëshirë në dashuri, duke ju dhuruar lumturi me njeriun e zemrës.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Ditë mjaft nervoze kjo e sotmja. Evitoni ndërhyrjet në një çështje që do kohë për t'u zgjidhur, sidomos në qoftë se janë në lojë para dhe persona të tjerë. Hëna kundërshtuese të shenja e Ujorit sjell malinkoni e të papritura në ndjenja dhe dikush nga ju mund të përfitojë për t'u arratisur në vetmi, ose për të kërkuar mbështetjen e një personi të afërm.

VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)



Mundohuni të zgjidhni ndonjë çështje të rëndësishme gjatë orëve të para të mëngjesit, sepse më vonë Hëna do të kalojë në kundërshtim me shenjën tuaj, duke ju krijuar ndonjë keqkuptim me të tjerët. Ka ardhur momenti të ekuilibroni disa marrëdhënie si sentimentale, ashtu edhe profesionale.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Sot do të keni mundësi të zgjidhni një problem pune në mënyrë të papritur, gjithashtu do të zhduken të gjitha pengesat që ju pengonin për të arritur objektivat tuaja. Një marrëdhënie sentimentale do të jetë motiv reflektimi. Do të jetë i pashmangshëm një sqarim ose një zgjedhje vendimtare.

AKREPI (22/X-21/XII)



Do të jeni në harmoni me personat më të moshuar të familjes suaj. Ju pëlqen të shikoni se jeta e tyre është e shëndetshme dhe ka shumë gjëra mbi të cilat keni një mendim. Ndeshmëria dhe sakrificat tuaja karshi tyre do të do të shpërblehen me dashurinë që do ju dhurojnë.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Edhe pse do të arrini ndonjë objektiv ambicioz, mos u tregoni të pakujdesshëm, sepse gjendet gjithmonë ndonjë gjë e papritur. Në qoftë se jeni vetëm, do të ndiheni mjaft mirë afër personave që do ta vlerësojnë shumë interesin tuaj. Në qoftë se jeni çift, ju pret një mbrëmje eksplozive.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Sot jeni të mbushur me energji dhe optimizëm. Keni shpirt iniciative dhe një nuhatje të shkëlqyer, të cilat duhet t'i përdorni me kujdes, sidomos në qoftë se doni të rrisni të ardhurat tuaja, ose të zgjeroni aktivitetin tuaj. Hëna të shenja e Ujorit do ta bëjë më dinamike jetën tuaj sociale.

UJORI (20/I-19/II)



Siç thotë edhe proverbi: dita e mirë duket që në mëngjes. Edhe për ju kështu do të jetë kjo ditë e shkëlqyer. Entuziazëm, qartësi, ide dhe mjaft simpati do të jenë armët tuaja fituese, që ju lejojnë të bëni për vete këdo që ju intereson. Në kohën e lirë dëgjoni muzikë, shikoni një film ose lexoni një libër tërheqës.

PESHQIT (20/II-19/III)



Këto ditë Hëna në kundërshtim ju sugjeron të mos bëni debate të ashpra në familje. Duhet të mësoni njëherë e mirë të harroni ato që janë thënë kundër jush. Vini në përdorim memorien për të kujtuar ngjarjet pozitive dhe pjekurinë tuaj për të harruar ato negative.



NE KETE DATE

29 SHTATOR 1936

Mensur Mamuti	FUTBOLLISTE SUEDEZE	POLITIKANI ITALIAN NE FOTO	MBRËMJE VALLEZIMI		B
			KOMPANIA E POLITIKANIT NE FOTO		
AKTORJA SHQIPTARE, AGOLLI					
PRODHIM DRITHI					
ISH POLITIKANI ITALIAN, MORO (ATENTAT)					
ANSAMBLI VOKALO-INSTRUMENTAL					QENDËR DIMERORE NË NORVEGJI
SHTRESA E SIPËRME E KORES SË TOKES (SILIC - ALUMIN)					
PO, PATJETËR, SIGURISHT					
VEGËL BUJQËSORE (SHQ.)	MES, MIDIS TRAJTË E PËREMIRIT PRONOR 'JOTE'				
KOHA	PATOLOGJIK, I SEMURË	DRE VERIOR (SH. PASHQ.)	NDIOC CEFA	VEND ME LËJË NË MES TË SHKRETTETIRËS	NUËSI TERRITORIALE, VENDE DRIDHJE
PËRBINDËSH ME TRUP TË NJERIJUT DHE KOKË TË DEMIT					
PARTIA E POLITIKANTIT NE FOTO					HIDROGJENI QYTEZË NË GJERMANI (L.T..)
F					
RUDOLF VALENTINO			ZERO-TIME INTERFACE E BËJ TË VAKËT		QYTET NË GJERMANI REVISTË MUZIKO-REHOLANDEZE (O..)
BANOR I BAVARISË, BAVAREZ					NAFORË (NË KISHËN KATOLIKE) PEJA
REGJISORI QOSJA				POKER ONLINE (NË INTERNET) AUSTRIA	
VEPRËR E XHOVANI BOKAÇOS					

ZGJIDHJET: B, ESMA, MIELL, ALDO, AVI, SIAL, POSI, BEL, SHTEFE, MINOTAUR, H, FORCA ITALIA, RV, ZTI, ULM, BAVAR, OSTF, ISA, I POKER, DEKAMERONI.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

5	3		8				6	9											1
			4	3	6														5
8				9	1					3								4	
1	5									3								1	
			8						9										2
	6									4	7			2					4
6				8	4												1		7
			6	2	9								2		4		3		5
4	8		3							9	2			6			5	9	

Shumë i lehtë: 534872169, 291436578, 876591423, 152947836, 748263915, 963158247, 629784351, 315629784, 487315692. Mesatar: 765348921, 948721356, 132965478, 456237189, 387194562, 219586743, 594612837, 821473695, 673859214.



Qëndrimi në natyrë mbron shikimin e fëmijëve

Teknologjia e kohës moderne i bën fëmijët më të aftë që të përdorin një telefon të mençur, mirëpo a po ndikon në zhvillimin e syve të tyre? Përderisa gjithmonë janë dhënë këshilla që fëmijët të shohin TV nga larg, të mos qëndrojnë pranë ekranit të kompjuterit gjatë etj. Së fundmi disa studime kanë gjetur që fëmijët kanë nevojë që të



qëndrojnë më gjatë jashtë shtëpisë, nën dritën natyrale. Qëndrimi jashtë në natyrë i fëmijëve ka një efekt mbrojtës dhe ulë gjasat që një fëmijë të ketë nevojë për korrigjim në të pamurit dritëshkurtër në të ardhmen. Problemet me të pamurit dritëshkurtër nënkuptojnë kur nuk i shihni gjërat qartë larg, përderisa afër e keni shikimin normal.

KALENDARI HISTORIK 29 SHTATOR

480 BC - Beteja e Salmasit: Flota Greke nën Themistoklin mund flotën persiane nën Kseresin I.
1187 - Ushtria e Saladinit marshon drejt Jerusalemit.
1678 - Franca dhe Brandenburgu nënshkruajnë marrëveshje të paqes.
1793 - Për herë të parë fjala Tennis përmendet në magazinat sportive të Anglisë.
1911 - Italia i shpall luftë Turqisë, duke filluar luftën Italo-turke.
1916 - John D. Rockefeller shpallet miliarderi i parë.
1924 - Santo Domingo u bashkohet Lidhjes së Kombeve.
1944 - Trupat sovjetike pushtojnë Jugosllavinë.
1953 - Qeveria amerikane jep Francës 385 milion dollarë amerikan për luftën në Indo-Kinë.
1964 - Greqia e Bullgaria mbyllin kufijtë.
1972 - Japonia dhe Republika Popullore e Kinës fillojnë marrëdhëniet diplomatike.
1976 - Siria dëbon guerilët palestinez nga Libani.
1988 - Trupat paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara fitojnë Çmimin Nobel për paqe.

A E DINI SE...



Rreth 90% të filxhanëve të kafesë nëpër zyrë kanë përplot me baktere që shkaktojnë sëmundje, madje 20% prej tyre mund të jenë të prekur nga materie fekale. Bakteret e kolegëve shpërndahen nëpër filxhanët e kafesë përmes shpuzës me të cilën pastrohen të gjitha enët e një zyre. Profesori i mikrobiologjisë, Charles Gerba, nga Universiteti i Arizonës, i cili ka zhvilluar disa studime për këtë çështje, ka thënë që 20% e filxhanëve të kafesë janë të mbushur me baktere koliforme. Përveç shpuzës që përdoret për pastrimin e tyre, duhet t'i kushtohet rëndësi edhe ambientit ku përgatitet kafeja.



Njeriu me më së shumti dhëmbë



Vijay Kumar nga India ka 37 dhëmbë në gojën e tij. Kumar llogaritet të ketë dhëmbë në gojën e tij pesë më shumë se personi mesatar dhe në përgjithësi më shumë se kushdo tjetër në botë. Vijay thotë se ai aplikoi për titullin e Rekorderve të Guinness, për shumicën e dhëmbëve në gojën e tij, pasi zbuloi rekordin e mëparshëm të 36 dhëmbëve të Chassidar Danabalan dhe ishte i sigurt se ai do ta sfidonte atë.

Një mini-dron personal për të marrë fotografi selfie

Një ditë ndoshta do të keni me vete dronin tuaj kudo që shkoni. Është shpikur tashmë një dron me përmasa të përshtatshme për ta mbajtur në xhep. I emërtuar "The Selfly", droni i bashkëngjitet celularit. "The Selfly" kombinon celularin me një dron autonom që ka kamerën e tij. "Pajisja është pjesë integrale e celularit me gjerësi 9 milimetra. Ka kamerën e saj HD. E heq dhe është gati të fluturojë", shpjegon krijuesi i "Selfly", Hagay Klein. Droni përdor teknologji të lartë për stabilizimin e imazheve fotografike. Ai drejtohet nëpërmjet një aplikacioni në celular, që ka edhe opsionin e pilotit. "Ruan stabilitetin në ajër



dhe mund të përdoret gjithkund me lehtësi", thotë zoti Klein. Imazhet nga kamera e dronit lidhen me celularin nëpërmjet Wifi. "E shikon xhirimin në celular dhe mund ta përpunosh sipas dëshirës. Mund t'i ndryshosh mad-

hësinë dhe fokusin. Thjesht e zmadhon me gishta. Telefoni e përkthen menjëherë në urdhëra të rinj fluturimi për dronin, i cili zhvendoset automatikisht", thotë zoti Klein. Bateria e dronit mundëson fluturimin në ajër për

vetëm 5 minuta, ose mjaftueshëm për të marrë rreth 20 fotografi selfie. "Deri më tani, njerëzit kishin një kamera në pjesën e mbrapme të telefonit dhe një të dytë në pjesën ballore. Tashmë të gjithë do të kenë edhe këtë kamera të tretë, por që mund ta shkëpusësh nga telefoni. Nuk të jep ndjesinë se po drejton një dron, por se vetëm kontrollon fotografitë e vetes", thotë zoti Klein. Droni "Selfly" mendohet të dalë në treg brenda këtij viti, me një çmim prej rreth 140 dollarësh. Dërgimi i tij brenda SHBA-së do të jetë falas, ndërsa drejt të gjitha vendeve të tjera të botës do të kushtojë 20 dollarë.

BARSOLETA



CILI ËSHTË...

- Mësuesja: Beni, cili është presidenti i SHBA-ve?
- Beni: Nuk e di mësuese.
- Mësuesja: Beni, duhet të kujdesesh më shumë për mësimet.
- Beni: Po ti mësuese, e di cila është Maria?
- Mësuesja: Jo.
- Beni: Duhet të kujdesesh më shumë për burrin tënd.

THËNIA E DITËS

Një mbret, duke e ditur pafuqinë e tij, nuk mund as t'i delegojë as të heqë dorë nga detyrat e tij. As një baba nuk mundet. Vetëm nëse djemtë do ta shikonin paradoksin, do ta kuptonin dilemën.

